



**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I EDUKIMIT
QENDRA PËR EDUKIM NË VAZHDIM**

**KONFERENCA E DYTË STUDENTORE
E FAKULTETIT TË EDUKIMIT**

“Studentët dhe kërkimi shkencor”

30 maj 2019

Publikuar më Maj 2019
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
Fakulteti i Edukimit
Qendra për Edukim në Vazhdim

Libri i Astrakteve për Konferencën e II-të Studentore

“Studentët dhe kërkimi shkencor”

Komiteti shkencor:

Kryetar:	Prof.dr.Kseanela	SOTIROFSKI
Anëtarë:	1 Prof.as.dr. Griselda	ABAZAJ
	2 Dr. Klodiana	LEKA
	3 Prof.as.dr. Blerina	XHAKOLLI
	4 Prof.as.dr. Suela	KASTRATI
	5 Prof.as.dr Doreta	TARTARI
	6 Prof.as.dr Sokol	PACUKAJ
	7 Dr. Marisa	KËRBIZI
	8 Dr. Katerina	CYCJA
	9 Dr. Anita	MUHO
	10 Dr. Zenel	SINA

BORDI ORGANIZATIV

Kryetar:	Dr. Zenel	SINA
Anëtarë	1 Dr. Ornedë	GEGA
	2 Dr. Ilir	SALLATA
	3 Dr. Rita	LOLOÇI
	4 Dr. Menada	PETRO
	5 Dr. Matilda	MEMAJ
	6 MSc. Helena	HALILAJ
	7 Dr. Helena	GRILLO
	8 Dr. Shqipe	SHYTI
	9 Dr.Enkelejda	CENAJ
	10 Arkid	ABDULLAJ
	11 Kristila	ANELLI
	12 Ermir	ÇELA
	13 Megi	KULLESI
	14 Denada	QUKU
	15 Brunilda	LAÇI

FËMIJËT ME AFTËSI NDRYSHE DHE GJUHA E HUAJ NË SHKOLLAT E ARSIMIT FILLOR NË QYTETIN E DURRËSIT

**Anxhela Vrioni & Rudina Hoda
Antonela Hasrama & Antonela Hsrama**

Universiteti i Tiranës

E-mail: anxhela.vrioni@gmail.com

E-mail: dajana_lumi@yahoo.com

E-mail: rudinahoda12@gmail.com

Email: antonela.hasrama@hotmail.com

Abstrakti: Shkolla është institucioni që edukon nxënësit me dije e vlera të larta qytetarie. Me shtimin e numrit të fëmijëve me aftësi ndryshe në shkollat publike, puna e mësuesit vështirësohet duke qenë se nevojat e tyre janë më të mëdha. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojmë ndikimin e gjuhës së huaj te këta fëmijë. Integrimi i çdo individi me aftësi ndryshe është i rëndësishëm, por mbetet një sfidë për mësuesin. Përmes një praktike pasive në klasa vumë re se gjuha e huaj me anë të kulturës dhe tingujve të rinj që ofron, tërheq vëmendjen e mundëson integrimin e këtyre fëmijëve në procesin mësimor. Ky studim, i shtrirë në disa nga shkollat e arsimit fillor në Durrës, trajton mjedisin, strategjitë dhe teknikat efektive të mësimdhënies te këta fëmijë.

Fjalë kyçe: fëmijët me aftësi ndryshe, strategji, teknika, integrim

NDIKIMI I NUMRIT TË FËMIJËVE NË ARRITJET E TYRE NË GRUPET E ARSIMIT PARASHKOLLOR

Aida Prence

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *prenceaida@yahoo.com*

Numri i fëmijëve në një grup të arsimit fillor përcaktohet sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve në udhëzimet përkatëse të MASR. Ky numër minimal dhe maksimal lidhet me kostot, mundësitë dhe efektivitetin e realizimit të programeve mësimore, po dhe me standarte të higjenës dhe karakteristikave të grupmoshave.

Kushtet dhe mundësitë fizike bëjnë që këto standarte të shkelen apo të neglizhohen. Kurrikula e re ka sjellë rikonceptime jo vetëm të përmbajtjes mësimore po dhe të asaj menaxheriale. Për këtë arsye bëhet evidente jo vetëm numri maksimal, po dhe ai minimal i fëmijëve brenda grupit.

Në këtë hulumtim trajtohet ndikimi i numrit të fëmijëve në organizimin e procesit mësimor dhe efektet në arritjet e fëmijëve sipas planifikimit në programet mësimore.

Studimi është zbatuar në kopshtin Nr. 2 në qytetin e Ballshit. Baza metodologjike e punimit janë vëzhgimet gjatë orëve të mësimin, analiza e veprimtarive në kriteret e udhëzimeve metododike për zbatimin e programit, intervista me edukatorët, drejtuesit dhe ekspertët.

Studimi provon se numri i lartë i fëmijëve konfuzon punën e mësuesit dhe minimizon përkujdesjen e tij individuale ndaj nxënësve. Numri i ulët humb interaktivitetin, larminë dhe gjallërinë e veprimtarive të fëmijë gjatë zhvillimit të lojërave.

Fjalë kyç: *numri i fëmijëve, grup, lojëra, interaktivitet, arritje*

RËNDËSIA QË MERR GJUHA AMTARE, NË KLASËN E KATËR-T, TË ARSIMIT FILLOR.

Albina Hoxha

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E- mail: *albina.hoxha97@yahoo.com*

Abstrakt: Roli i mësimimit dhe zotërimi i gjuhës amtare në shkollë është parësore dhe qendër e edukimit të nxënësve për të ardhmen, jetën dhe veprimtarinë e tyre. Lënda “Gjuha Amtare” bën të mundur zhvillimin e aftësive komunikative për qëllime të gjithanshme, ajo jep mundësi për zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të nxënësve.

Qëllimi i mësimimit të gjuhës amtare është formimi i përgjithshëm intelektual dhe komunikues i çdo individi për realizimin e marrëdhënieve shoqërore.

Studimi mbështetet mbi kërkimet nëpërmjet pyetësorëve të bërë me mësues, prindër dhe nxënës si dhe një kërkim cilësor nëpërmjet fushës “gjuhët dhe komunikimi”. Ky studim u realizua në shkollën 9– vjeçare “A. Rustemi” Kukës.

Në studim u vu re se lënda e gjuhës amtare luan një rol të rëndësishëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Ndërmjet leximit të teksteve zhvillojnë botën e tyre emocionale pasurojnë imagjinatën. Zotërimi i gjuhës amtare nga nxënësit e klasave të katër-ta arrihet nëpërmjet alternimit dhe njohjes së strukturave gjuhësore me shprehitë komunikative. Duhet të jenë të aftë të dëgjojnë, flasin lexojnë dhe shkruajnë mirë.

Studimet kurrikulare përcaktojnë si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyçe që çdo individ duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Nxënësit duhet të njihen me kompetencat e fushës dhe situatat e të nxënësve ku të dallojnë cilësitë e zërit si psh: intonacionin, ritmin, theksin, duhet të përdorin drejt gjuhën standarte, kuptimin dhe karakteristikat e gjuhës së folur. Studimi paraqet disa rekomandime: të rritet cilësia e mësimdhënies në gjuhën amtare dhe të forcohet bashkëpunimi shkollë-familje, sepse pesha më e rëndësishme është familja e cila luan dhe rolin më të rëndësishme në studimin e fëmijëve.

Fjalë kyçe: *gjuhë amtare, kurrikul, situatë e të nxënësve, program mësimor.*

TEKNOLOGJIA BASHKËKOHORE MËSIMORE

Alketa Meraj

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *alketameraj2@gmail.com*

Abstrakt: Mjetet mësimore qofshin ato të thjeshta apo të përbëra luajnë një rol të rëndësishëm në procesin mësimor. Larmia e tyre ndihmon në përvetësimin e njohurive. Konkretizimi ndihmon së tepërmi në formimin e koncepteve dhe mban larg të mësuarin përmendësh. Së fundmi ka filluar të përdoret gjerësisht teknologjia bashkëkohore. Teknologjia ndihmon si nxënësit ashtu edhe mësuesit në një organizim më të mirë të orës së mësimin.

Ky studim është realizuar nëpërmjet pyetësorëve të bërë me nxënës, prindër, psikologë si dhe nëpërmjet intervistave me mësues që japin lëndë të ndryshme ku mund të përdoret teknologjia.

Gjatë intervistave u vu re që vlerësohet jo vetëm lënda e TIK-ut por edhe përdorimi i teknologjisë pothuajse në çdo fushë të përfshirë në kurrikulën mësimore. Orientimi që mësuesit japin në përdorimin e drejtë dhe me kriter të teknologjisë luan një rol të rëndësishëm në edukimin qytetar dhe formimin e personalitetit të nxënësit. Nxënës dhe prindër janë deri diku të kënaqur me bazën materiale që shkolla ofron por gjithmonë ka nevojë për përmirësim. Psikologët janë ata të cilët shprehin shqetësim për shtimin e ekraneve elektronike.

Disa rekomandime që ofron studimi: Të rinjtë duhet të ndërgjegjësohen kundrejt përdorimit me kriter të teknologjisë dhe mënyrës së komunikimit. Prindërit duhet të jenë të kujdesshëm që të kontrollojnë fëmijët për kohën që harxhojnë dhe faqet që ata vizitojnë. Nga ana tjetër edhe shkolla duhet të zhvillojë sa më shumë veprimtari ku nxënësit të njihen me rreziqet që ju kanosen nga përdorimi pa kriter të teknologjisë.

Fjalët kyçe: *teknologji, mjete mësimore, shkollë, edukim qytetar.*

PORTOFOLI I TË NXËNIT, MËNYRA E VLERËSIMIT ME ANË TË PIKËZIMIT

Alketa Pjetri

E-mail: *alketapjetri@Icloud.com*

Abstrakt: Portofoli është koleksion sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të demonstruar zhvillimin e kompetencave. Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra hulumtuese, krijuese ose zbatime të ndryshme, projekte të nxënësve që zhvillojnë kompetencat kryesore dhe mendore. Për një periudhë, detyrat që vlerësohen në portofol janë: Projektin ose një fazë të tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë dhe 1-2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese.

Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për [do nxënës]. Ato mund të jenë punime të kryera në klasë ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues si: punë praktike individuale, produkte të krijuara nga nxënësit, punime audio-vizuale, aktivitete në grup ose individuale, projekte individuale ose në grup. Në fillim të periudhës mësojësi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përshijne në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës. Mësojësi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit dhe u prezanton nxënësve piket për secilin detyrë.

Mësojësi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kritere vlerësimi duke argumentuar notën e tij. Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen. Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet si orë e vecante në planifikimin e periudhës. Vlerësimi i portofolit jodomosdoshmerisht bëhet në fund të periudhës. Mësojësi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit. Në përfundim të vlerësimit të portofolit mësojësi i vendos notat në regjister. Mësojësi udhëzon nxënësit që të ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor. Prezantova përpara departamentit mësojësi në mënyrë të përcaktimit të detyrave në portofol dhe vlerësimin e tij me anë të pikezimit.

Fjalë kyçe: *portofoli i të nxënësve, mënyra e vlerësimit, pikezim, detyra portofoli, kualifikim i brendshëm në shkollë, departament mësojësi.*

ZHVILLIMIT DEMOGRAFIK NË SHQIPËRI NDËR SHEKUJ. PERIUDHA NGA ANTIKITETI DERI NË DITËT E SOTME

Anajada Shyti

E-mail: anajadashyti@gmail.com

Abstrakt: Ky studim ka për qëllim të analizojë historinë e hershme të popullimit të trevave shqiptare ndër vite. Trevat shqiptare vlerësohen ndër trevat me gjurmët më të lashta në Ballkan dhe Europë. Këtë fakt e dëshmojnë mjaft qartë objektet e gjetura dhe gjurmë arkeologjike anembanë trevave shqiptare.

Rezultatet: Sipas të dhënave mendohet që popullsia shqiptare në periudhën e Msjetë, të ketë arritur në 1.5 milionë banorë. Për këto periudha nuk kemi të dhëna të sakta statistikore por mund të mbështetemi tek të dhënat arkeologjike që dëshmojnë lashtësinë vazhdimësinë e zhvillimit etnik dhe kulturor të popullsisë shqiptare.

Pas pushtimit osman deri në shpalljen e pavarësisë 1912 janë bërë regjistrimet e popullsisë shqiptare Regjistrimi i parë i përgjithshëm i popullsisë në vendin tonë është realizuar në vitin 1943 me rreth 814 mijë banorë dhe një dendësi 30 b / km².

Rezultatet e studimit: Nëse nuk do të kishim këto ritme në rënien e numrit të popullsisë nëpërmjet emigracionit të jashtëm do të ishin rreth 4 milion banorë. Kjo rënie e numrit të popullsisë nga viti 1990 e deri më sot tregon që faktorë të ndryshëm socialë, ekonomikë dhe politik kanë sjellë tkurrje të popullsisë shqiptare. Duke na renditur ne tashmë në listën e vendeve që kanë hyrë në plakjen e popullsisë. Nga një popullsi vitale me moshë mesatare 29 vjeç jemi aktualisht me një moshë mesatare 31- vjeç. Ritme të cilat po ecin frikshëm në popullsinë e vendit tonë.

Një dukuri e tillë në ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë sonë parashikohet të vazhdojë edhe në të ardhmen kjo për një sere arsyesh si emigracioni ekonomik social, planifikimi familjar dhe ajo që është për të adhur keq duke sjellë edhe një rezultat të frikshëm abortimin e fetusve femra, duke sjellë mbizotërim të elemntit mashkull me 51% dhe atij femër me 49 %.

Rekomandime: Në këto kushte kërkohet hartimi i politikave dhe i strategjive të sakta rret ecurisë së zhvillimeve demografike të vendit tonë.

Fjalët kyç: *zhvillim demografik, periudhë, antikitet, treva shqiptare, histori e popullit.*

DISABILITIES AND THEIR INTEGRATION INTO INCLUSIVE EDUCATION IN ALBANIAN SCHOOLS. PROBLEMS AND CHALLENGES

AnilaAlliu

Regional Directory of Education Tirana

E-mail: *anilaalliu@yahoo.com*

Klotilda Jaupi

Regional Directory of Education Tirana

E - mail: *klotilda.jaupi@yahoo.com*

Abstract: The purpose of this study is to identify how teachers recognize standard "care to children with special needs" and what is the extent of their applicability in our educational institutions.

The methodology followed: quantitative and qualitative methods will provide us with concrete information on the quality and applicability of this standard by teachers. Theoretical information, quantitative analysis conducted through questionnaires to teachers who exercise their profession in undergraduate education, tables of discussion with colleagues and parents of children with special needs, will provide us with a clearer picture on the applicability of this standard in the context of Albanian schools, which are challenging to work with, and as such, there's a greater need for more progress, findings and suggestions to be made.

Results: Results of the study show that 30% of teachers do not recognize these standards, namely standard "care for children with learning difficulties" and "Attention to gifted students". 80% of teachers in public schools admit to the difficulty of the implementation of these standards compared with 20% of teachers in private schools. 60% of teachers in public schools compared with 50% of teachers in private schools apply the theory of multiple intelligences during classes, which are conducted in this way to increase the inclusion of students. In the calculation of daily plans, teachers take little to no account of the specificities of students. Difficulties can be encountered in the design of PEI plan, student assessment and therefore parental involvement in school which is necessary for communication and closer cooperation in order to increase the quality of the active participation of these children.

Keywords: standard of the teachers, care for children with special needs, PEI, students with cultural diversity, students with linguistic diversity, support of all students

LOJA SI TEKNIKË E MËSIMDHËNIES INTERAKTIVE NË ARSIMIN PARASHKOLLOR.

Anila Mezja

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E- mail: *anila.mezja@gmail.com*

Abstrakt: Loja është veprimtaria kryesore e fëmijëve parashkollorë. Synimi i këtij studimi lidhet me nivelin e aplikimit të lojës si teknikë mësimdhënie në arsimin parashkollor. Studimi trajton jo vetëm sasinë dhe mënyrën e organizimit të lojrave, por edhe të përzgjedhjes dhe përshtatjes së lojës me tematikën mësimore dhe pritshmërisë së saj.

Metoda e përdorur në studim është ajo cilësore. Intervistat me edukatorët, vëzhgimi i fëmijëve dhe studimi i rastit janë teknikat kryesore të përdorura për marrjen e rezultateve.

Paradigmat kryesore të përdorura janë: Loja mënyra më e mirë për të nxënë fëmijët; Nëpërmjet lojës fëmijët shprehin temperamentin, talentet dhe kufizimet e tyre zhvillimore; Loja ka karakter gjithëpërfshirës; Ka fëmijë që ju mungojnë aftësitë për të luajtur; Fëmija edukohet për të luajtur; etj.

Studimi u zhvillua në kopshtin “Met Hasa” në qytetin e Durrësit.

Në fund, studimi arriti në konkluzionet se: loja është veprimtari gjithëpërfshirëse, interaktive, afektive dhe shumë e rëndësishme në procesin e zhvillimit të mësimin. Mësuesit kanë nevojë jo vetëm për ta kuptuar e vlerësuar impaktin e lojës, por edhe për trajnime me paketa lojërash didaktike, lojëra lëvizore dhe aplikative.

Lojërat me subjekte dhe të hatuara me kreativitetin e fëmijëve janë më efektive se sa lojërat e imponuara nga edukatorët.

Fjalë kyç: *lojë, aftësi për të luajtur, parashkollor, trajnim.*

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM

Anila Trashaj

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: anilatrashaj@gmail.com

Abstrakt: Përdorimi i teknologjisë në shkolla deri para pak viteve ka qenë një ëndërr e largët. Tashmë, përveç kompjuterave, në shkollat tona janë futur edhe tabletat. Brenda një kohe të shkurtër, përdorimi i tyre po sjellin një ndryshim të madh në shkolla dhe, si rezultat, edhe në zhvillimin e nxënësve dhe të rinjve. Zhvillimi i të nxënësve elektronik është sot zgjidhja për motivimin e nxënësve, për të përmirësuar arritjet e tyre, shpejtësinë në veprim, bashkëpunimin, ndërveprimin dhe pavarësinë.

Studimi është mbështetur mbi metodën sasiore, të realizuar nëpërmjet pyetësorëve dhe bisedave të bëra me nxënës, mësues dhe prindër. Një tjetër instrument i përdorur për mbledhjen e të dhënave është vëzhgimi i orëve digjitale. Gjithashtu është përdorur edhe metoda cilësore, e realizuar nëpërmjet intervistave me mësues që aplikojnë këto orë digjitale, por edhe me dy drejtueset e shkollave që u përfshinë në studim. Ky studim u realizua në shkollat e mesme “Perikli Ikonomi” dhe “Jakov Xoxa” në Fier.

Në studim u vu re se përdorimi i teknologjisë në edukim siguron rrugë më të shumta për të nxënës, lejon më shumë fleksibilitet, siguron mënyra më të thjeshta për të nxitur dhe zhvilluar të menduarit, krijon hapësira personale për të nxënës online. Por me gjithë përparësitë që ka për t'i bërë nxënësit më të zotë me përballjen me detyra të shumta e të njëkohshme, nga ana tjetër ata bëhen më pak të zotë për të patur një panoramë më të gjerë dhe për të kuptuar problemet e ndryshme. Pra, nxënësit vërtet mësojnë të bëjnë disa gjëra njëherësh, por kanë një kuptim më sipërfaqësor për atë çfarë bëjnë. Nga ana tjetër, në studim u vunë re edhe probleme të konsiderueshme në drejtim të vlerësimit të nxënësve. Mësuesit kanë nevojë për një bazë më të fortë mbi të cilën të vlerësojnë të kuptuarit e nxënësve dhe në këtë mënyrë të identifikojnë ecurinë e përparimit të nxënësve në procesin e edukimit.

Fjalë kyçe: *edukim, teknologji, të nxënës elektronik, përparësi, probleme.*

NDIKIMI I ARSIMIT, FESË, BINDJEVE POLITIKE DHE MOSHËS NË PRANIMIN E TEORISË SË EVOLUCIONIT NË SHQIPËRI

Antonela Çobanaj & Aurora Kastrati

Universiteti i Tiranës

E-mail: *antonela.cobanaj@fshnstudent.info*

Abstrakt: Ekziton një marrdhënie negative mes shkollimit dhe të qenurit fetarë si dhe një marrdhënie pozitive mes arsimimit dhe pranimin të evolucionit. Gjithashtu në Amerikë demokratët e pranojnë më shumë evolucionin se republikanët. Është përdorur pyetësi MATE (Measure of the Acceptance of the Theory of Evolution) duke i shtuar edhe disa pyetje vetë për të parë ndikimin që ka feja, arsimit, bindja politike dhe mosha në pranimin e evolucionit. Studimi është shtrirë në të gjithë Shqipërinë dhe ka përfshirë 10,436 individë. Ne gjetëm se edhe në Shqipëri ekziston lidhja negative mes arsimit dhe fesë si edhe lidhja pozitive mes arsimit dhe pranimin të evolucionit, e vërtetuar kjo nga koeficientët e korrelacionit. Ndryshe nga Amerika në Shqipëri janë individët me bindje politike të majtë që mbështesin më shumë teorinë e evolucionit. Siç pritej grupmosha e parë (14-24 vjeç) janë ata që pranojnë më shumë teorinë e evolucionit. Në total shqiptarët kanë një pranim të ulët të evolucionit me një mesatare prej 53,9 bazuar në pyetësin MATE. Brenda Shqipërisë është bashkia e Selenicës, pjesë e rrethit të Vlorës që shfaq pranimin më të lartë të evolucionit, ndërsa qyteti i Korçës paraqet shkallën më të ulët të pranimin të evolucionit.

Fjalët kyçe: *evolucion, pranim, fe, arsim, politikë, MATE.*

MENAXHIMI I KLASËS DHE I KONFLIKTEVE

Anxhela Noka

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Email: *shaqe.noka@gmail.com*

Abstrakt: Qëllimi i studimit: Nëpërmjet këtij studimi synohet të identifikohet impakti që ka mësuesi në menaxhimin e klasës dhe në zgjidhjen e konflikteve që mund të krijohen gjatë procesit mësimor. Një rëndësi shumë e veçantë do ti kushtohet marrëdhënies mësues-nxënës, komunikimit të tyre si një pikë kyçe për mbarëvajtjen e mësimin si dhe për të evidentuar nivelin e të nxënësit dhe formimit cilësor të nxënësit, ku mësuesit luajnë rolin më të rëndësishëm dhe vendimtar në këtë formim.

Metodologjia e studimit: Një kombinim i metodave cilësore me ato sasiore siguruan informacion mbi shkallën e ndikimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët ndikojnë në menaxhimin e klasës dhe konflikteve. Metodatat sasiore ndihmuan në zhvillimin e një pyetësori të strukturuar për mësuesit mbi mënyrën sesi ato veprojnë në situata të tilla konfliktuale në klasë. Ndërsa metodatat cilësore siguruan informacion teorik mbi tipologji të ndryshme teknikash menaxhimi, si dhe ndikimi që ka pasur tek nxënësit.

Rezultatet: Rezultatet e tregimit tregojnë mënyrat dhe teknikat që duhet të përdoren nga mësuesit për të menaxhuar klasën në situata të ndryshme të të nxënësit. Raporti që nxënësi krijon me mësuesin, roli i pashmangshëm i mësuesit ndikon drejtpërdrejtë në formimin e personalitetit të nxënësit. Gjithashtu rezulton se edhe ndikimi kulturor është mjaft vendimtar në menaxhimin e sjelljeve të nxënësve. Mënyrat sesi duhet të organizohet klasa, rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur nga një mësues janë një tjetër pikë kyçe e këtij studimi. Një menaxhim i mirë i klasës vjen si rezultat i disa aktiviteteve të ndryshme të cilat mësuesi mund ti zhvillojë duke organizuar punë të ndryshme në grup për të nxitur të mësuarin bashkëpunues.

Fjalë kyçe: *menaxhim, klasë, sjellje, konflikte, nxënës, mësues.*

EFEKTET BASHKËPUNIMIT SHKOLLË-FAMILJE-KOMUNITET NË FUSHËN E EDUKIMIT

Arjana Keshi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *keshi.arjana@gmail.com*

Abstrakt: Në këtë studim është trajtuar prezenca e bashkëpunimit familje-shkollë-komunitet dhe ndikimi i këtij bashkëpunimi në edukimin e fëmijëve. Për të pasur një bashkëpunim produktiv midis shkollës, familjes dhe shoqërisë, që në fillim, të dyja palët duhet t'i bëjnë të ditura njëra-tjetrës pritshmëritë e tyre. Thelbi qëndron në faktin se prindërit në fillim të vitit duhet të bëjnë të qartë se çfarë presin prej shkollës por nga ana tjetër edhe shkolla ka si detyrim t'i orientojë prindërit në rolin që do të luajnë, dhe llojin e ndihmës që ajo kërkon nga prindërit si partner në edukim.

Nxënësit, me gjithë tiparet e përbashkëta, kanë veçoritë e tyre tipike, individuale në rrafshin e të menduarit e të sjelljes. Këto veçori burojnë nga shumë faktorë, si për shembull: fizikë, psikikë, të lidhur me temperamentin dhe me trashëgiminë genetike, mjedisin ku jetojnë.

Rëndësi ka gjithashtu të njihet fakti se si janë paraqitur fëmijët në klasë të parë.

Metodologjia përfshin metodën sasiore dhe cilësore. Mbledhja e informacionit u realizua nëpërmjet pyetsorëve të ndryshëm të zhvilluar me mësuesit, nxënësit, prindërit dhe bashkëmoshatarët. Të gjitha studimet e bëra janë realizuar në shkollën 9-vjeçare “Hamdi Lleshi” Majtar. Vëzhgimi u realizua nga unë dhe disa nxënës të klasës së nëntë të cilët më ndihmuan me punën e tyre të mirë realizuar.

Rezultatet e arritura janë: moskonsiderata e nevojshme e familjes ult nivelin e edukimit të nxënësve, shoqëria ka një ndikim shumë të ulët, shkolla nuk arrin në nivelin e duhur të punës me nxënësit.

Studimi jep disa rekomandime. Detyra e secilit subjekt është të marrë pjesë rregullisht gjatë procesit të edukimit, të realizojë aktivitete të ndryshme, të mbështesë fëmijën, nxënësin ose bashkëmoshatarin në mbledhje, organizime, veprimtari të ndryshme shkollore. Një përkushtim nga secila palë është një angazhim dhe mbështetje personale e fëmijës për tu vetedukuar më mirë.

Fjalë kyç: *bashkëpunim produktiv, bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet, edukim, pjesëmarrje.*

TË MËSUARIT BAZUAR NË PROJEKTE NË KONTEKSTIN E ZHVILLIMIT TË MENDIMIT KRITIK

Armanda Xhani (Baça)

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *aarmi98@gmail.com*

Abstrakt: Të mësuarit e bazuar në projekt (MBP) është një model i veprimtarisë mësimore, i cili zhvendoset nga praktikatat e mësimdhënies se izoluar brenda klasës e te përqëndruara te mësuesi, në veprimtari të nxënësve në qendër të nxënësve. Këto veprimtari janë afatgjata, ndërdisiplinore dhe të integruara me problemet dhe praktikatat e botës reale.

Një nga përfitimet e menjëhershme të kësaj metode të mësuarit mund të quhet shkalla e lartë dhe e përveçme e pjesëmarrjes dhe e motivimit të nxënësve nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e të nxënësve.

Fokusi i këtij punimi është të studiojë punën me projekt në mësimdhënie. Si ndikon ajo? Cili është feedback-u i tij? Sa të prirur janë nxënësve për të qenë të përfshirë në punën me projekt? Janë pikërisht këto pyetjet në të cilat fokusohet studimi.

Studimi ka karakter cilësor dhe sasior njëkohësisht. Është realizuar duke zgjedhur një kampion prej 30 nxënësish për çdo shkollë, nga 5 shkollat e qytetit të Durrësit të marra në studim. Instrumentat e përdorura janë pyetësori dhe intervista. Nëpërmjet pyetësorit u mat se çfarë qëndrimi mbajnë nxënësve ndaj përdorimit të metodës (MBP) në mësimdhënie. Të dhënat grafike u paraqitën përmes paketës Microsoft Office (Excel), si dhe u intervistuan 10 mësues në lidhje me perceptimin e tyre për mënyrën ofrimit të përdorimit të kësaj metode, intervistat e të cilëve më pas janë koduar dhe janë nxjerrë konkluzionet përkatëse.

Konkluzionet e studimit treguan që të mësuarit bazuar në projekte u ofron nxënësve mundësitë e duhura për të thelluar interesat e tyre njohëse, për të zhvilluar e ndjekur ato. Gjithashtu u re se kjo mënyrë e të mësuarit u ofron nxënësve afëritet, bashkëpunim mes tyre, për një marrëdhënie të shëndetshme e korrekte. Si dhe u ofron mundësinë nxënësve të të gjitha niveleve të paraqesin rezultate të larta.

Fjalë kyçe: *projekt, nxënës, mendim, përfshirje, metodë.*

LEGJISLACIONI SHQIPTAR DHE MBËSHTETJA PSIKO - SOCIALE NË SHKOLLË

Armida Dyrmishi,
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Email: *armida.dyrmishi1@yahoo.com*

Abstrakt: Ky punim ka si qëllim të konstatojë mbështetjen psiko-sociale të legjislacionit shqiptar. Kjo mbështetje ka një rol të rëndësishëm për të nxitur nxënësit që të evulojnë në procesin e mësimdhënies. Synimi i punimit hedh dritë mbi punën e Ministrisë së Arsimit mbi mbështetjen psiko-sociale të nxënësve duke hartuar një legjislacion të gjërë dhe duke fuqizuar rolin e psikologut në institucionet arsimore.

Shërbimi psiko-social në vetvete është një shërbim i nevojshëm për cdo strukturë arsimore duke dhënë në këtë sektor një suport direkt dhe indirekt në marrëdhënie mes nxënësve.

Objektivat kryesore të këtij punimi janë fokusuar në ndërtimin e një pasqyre të gjërë e legjislacionit shqiptar, në analizimin e rolit të psikologut dhe i mësuesve ndihmës në rastet kur konfliktet dhe situatat e pakëndëshme janë prezente në shkollë.

Metodat kryesore për realizimin e këtij punimi është shqyrtimi i literaturës. Një analizë të detajuar për legjislacionin shqiptar mbi strategjitë, dispozitat normative, ndër vite për mbështetjen psiko- sociale në shkollë. U realizuan disa pyetësor me nxënës të shkollave 9 - vjecare në zonën e Durrësit.

Rezultatet e këtij punimi nxorrën në përfundim që të gjithë institucionet arsimore, kanë mbështetur me anën e legjislacionit dhe dispozitat normative duke i realizuar paralelisht me temat në planin vjetor të punës së shërbimit psiko-social në shkolla, punohet dhe me një grup strategjish të tilla si: barazia gjinore- mosdiskriminimi për shkak të orientimit seksual; plan veprimi për fëmijët me aftësi të kufizuar AK; plan veprimi për projektin antitrafik; plan veprimi për luftën kundër alkoolit, duhanit dhe drogës; plan veprimi për edukimin mjedisor; plan veprimi për minoritetin rom dhe egjiptian në shkollë-integrimi në shkollë i këtyre fëmijëve; plan veprimi për ushqimin dhe ushqyerjen.

Fjalë kyçe: *mbështetje, shërbime, psikolog, mësimdhënie, legjislacion.*

AVANTAZHET E PËRFSHIRJES SË GJUHËVE TË HUAJA NË MËSIMDHËNIE

Armida Zijaj

E-mail: zijajarmida@yahoo.com

Abstrakt: Shkolla është baza e formimit të një shoqërie të shëndetshme. Duke rritur kontributin e rëndësishëm në rrugën e edukimit në shkolla është shtuar edhe elementi aq i rëndësishëm i gjuhës së huaj. Gjuha e huaj është mjaft e rëndësishme në ditët e sotme e në fakt gjithnjë ka qenë. Në ditët e sotme studentët janë drejtuar drejt gjuhës së huaj si një mjet komunikimi me botën e jashtme. Kërkesat për një jetë më të mirë dhe për të rritur nivelin kulturor të tyre jashtë vendit dhe nevoja për të zbuluar më shumë nga të mirat që bota demokratike ofron, kanë sjellë nevojën që gjuhët e huaja të përfshihen në programin mësimor.

Ky studim synon të zbulojë ngjashmëritë e gjuhës së huajme gjuhën e nënës dhe e ardhmja që shteti përkatës ofron, orientojnë nxënësit drejt zgjedhjes së një gjuhe të huaj. Në një botë ku mbizotëron gjuha angleze është e vështirë që të rritet dëshira a iniciativa për rritjen e vendimentit të punës në një gjuhë tjetër.

Në përfundim të studimit rezultoi se kontributi më i madh në dhënien e njohurive të nxënësve përkundrejt një gjuhe të huaj i takon mësuesit. Kohët e fundit është rritur interesi i studentëve për zoterimin e gjuhës italiane. Studentët megjithatë nuk kanë ende një model të vetëm gjuhësor. Përpjekjet apo situatat e shprehura në orën e mësimin shpeshherë nuk janë të mjaftueshme.

Rekomandime: Tek nxënësit që studijnë një gjuhë të huaj duhet rritur aftësia e të menduarit në një formë tjetër komunikimi sic është edhe gjuha e huaj. Zotërimi i një gjuhe të huaj fiton peshë në momentin kur nxënësi mëson të mendojë një gjuhë të huaj. Komunikimi mësues-nxënës është shumë i rëndësishëm në edukim. Mënyra e trajtimit të problematikave gjuhësore dhe komunikimi ofruar studentëve i mundëson atyre zhvillimin kompetencave gjuhësore që zotërojnë.

Fjalë kyç: *mësimdhënie, gjuhë e huaj, nivel kulturor, komunikim.*

ROLI DHE RËNDËSIA E TIK-UT NË PROCESIN E EDUKIMIT

Arta Kocopaj

Universiteti “Aleksander Moisiu” Durrës

E-mail: *artakocopaj@gmail.com*

Abstrakt: Ky punim trajton rolin e TIK në procesin e mësimdhënies dhe në veçanti atë të edukimit. Ai tregon domosdoshmërinë dhe rolin që zë Tik në kuadër të ndryshimeve në sistemin tonë arsimor. Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë avantazhet e përdorimit të TIK-ut në orë të ndryshme mësimore dhe në veçanti sa efikas ka qënë ai në lëndët e profilit shkencor si fizika, matematika, kimi, biologji. Mësimi me kompetenca sot është një nga risitë në sistemin tonë arsimor, ku kompetenca digjitale zë një rol të rëndësishëm në procesin mësimor. Kësaj i shërben dhe paisja e shkollave me një infrastrukturë e cila mundëson integrimin e teknologjisë në procesin mësimor dhe të edukimit gjithashtu. Kjo mundëson çnë një të menduarit të nxënësit në një stad më të lartë, rrit aftësinë e përpunimit të informacionit të marrë, përmirëson të kuptuarit duke e lidhur me elementë konkretë, si dhe transferon informacionin e përcjellë në një memorie më afatgjatë.

Për të parë ndikimin e TIK në procesin e mësimdhënies, janë marë në studim 2 shkolla të mesme të qytetit të Elbasanit. Për të pasur rezultate sa më të matshme dhe reale janë organizuar pyetësorë, intervista dhe vëzhgime. Nga studimi doli që: nxënësit janë të interesuar për përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor pasi ajo i lejon ata jo vetëm të jenë më pranë asaj që studiojnë por u jep mundësi që të angazhohen më mirë në shoqërinë bashkohore, të jenë të mirë informuar për atë se çfarë ndodh rreth tyre si dhe të kenë informacion për çdo të re të shkencës.

Rezultatet e studimit janë rrjedhojë e një analize të kujdesshme profesionale. Ato tregojnë se teknologjia pavarësisht mangësive që ekzistojnë në shkollat tona siç është mungesa në bazë materiale, gjithashtu zë një vend shumë të rëndësishëm në formimin profesional dhe edukimin e të rinjve.

Fjalë kyç: *TIK, edukim, mësimdhënie, informacion, standart, kompetenca.*

TE MËSUARIT ME PROJEKTE NJË METODË E MIRË PËR TË NXËNËT E NXËNËSVE

Aurora Nicka

E-mail: auroranicka@gmail.com

Abstrakt: Të mësuarit e bazuar në projekte është një model i veprimtarisë mësimore, i cili zhvendoset nga brenda klasës në veprimtari të të nxënësve me në qendër nxënësin. Këto veprimtari janë afatgjata, ndërdisiplinore dhe të integruara me problemet dhe problematikat e botës reale. Ai lehtëson procesin e përdorimit të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve nga ana e nxënësve, duke bërë të mundur zbatimin dhe integrimin e njëkohshëm të përmbajtjes së fushave të ndryshme të nxënies gjatë procesit të realizimit të produktit përfundimtar, në vend të praktikave tradicionale në kontekstin përkatës lëndor të orës mësimore. Mësimi bazuar në projekte jep mundësi unike të pazevëndësueshme për ndërtimin brenda klasës të marrëdhënieve korrekte të mësuesve me nxënësit. Në këtë kontekst, mësuesi mund të luajë role nga më të ndryshmet: atë të lehtësuesit, orientuesit të procesit të të nxënësve. Produktet e përfunduara, planifikimi i kryer, draftet, materialet dhe gjithë tjetër të realizuar, përbëjnë një arsenal të rëndësishëm mësimor, rreth të cilit mësuesit dhe nxënësit mund të organizojnë një diskutim të zgjeruar mbi njohuritë që janë shfrytëzuar në realizimin e këtij produkti përfundimtar. Duke u bazuar në këtë sfond teorik, të mësuarit me projekte është aplikuar si strategji praktike në mësimnxënje dhe në disiplina të tjera, duke i kthyer kështu përgjigje pyetjeve të shekullit të XXI për të mësuarit e nxënësve.

Fjalet kyçe: *të mësuarit me projekte, veprimtari ndërdisiplinore, bashkëveprim, bashkëpunim.*

NDIKIMI I LOJËS NË TË NXËNËT E FËMIJËVE PARASHKOLLORË

Brigjilda Arapi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Email: brigjildaarapi@gmail.com

Abstrakt: Loja është një element mjaft i rëndësishëm në të nxënët e fëmijëve parashkollorë dhe si rrjedhojë e këtij konstatimi i duhet kushtuar një vëmendje më e madhe me qëllim vënien në dukje të rëndësisë që ka loja në vetvete si pjesë integrative në procesin e të nxënit. Kjo kumtesë shërben për të sjellë në vëmendje rëndësinë që ka loja si një element kyç në dorën e mësimdhënësit në procesin e mësimdhënies – nxënies. Metodologjia e përdorur është shfletimi i literaturës, vëzhgimi i 30 fëmijëve të grupmoshës 3 – 4 vjeç të kopshtit 1 Qershori Durrës, si dhe intervietimi i edukatoreve lidhur me mënyrën e organizimit të orës mësimore nëpërmjet lojës. Kështu nxirren në pah benefitet që vijnë si rezultat i këtij aktiviteti dhe në fund vijmë me një bllok strategjish e rekomandimesh sesi të arrijmë një mësimdhënie – nxënie të suksesshme me në fokus kryesor veprimtaritë që realizohen përmes lojës.

Fjalët kyçe: *lojë, parashkollor, mësimdhënie, mësimnxënie.*

KURRIKULA E RE. SFIDAT DHE AVANTAZHET

Denada Quku

Brunilda Laçi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *denada.quku@hotmail.com*

E-mail: *laci_brunilda@yahoo.com*

Abstrakt: Kurrikula e arsimit parauniversitar merr përsipër të zhvillojë dhe të edukojë tek nxënësi personalitetin, inteligjencën dhe në përgjithësi zhvillimin tërësor të tij si një individ unik. Ajo ka skicuar brenda saj rritjen dhe edukimin e nxënësve, të parë në të gjitha dimensionet e jetës së tyre, të tilla si: shpirtëror, morale, njohëse, emocionale, imagjinuese, estetike, shoqërore dhe fizike. Arsimi shihet si faktor kryesor i zhvillimit të qendrueshëm të burimeve njerëzore, mirëqenies ekonomike, krijimit të paqes dhe sigurisë, zhvillimit të vlerave universale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës në nivelin individual, familjar, shoqëror e global.

Qëllimi i këtij punimi është informimi mbi rëndësinë e të kuptuarit të kurrikulës, zbatimit sa më efikas të saj, dallimeve midis kurrikulave dhe zhvillimeve kurrikulare, pasi një shoqëri e bazuar në dije, një shoqëri e teknologjisë së informacionit kërkon njerëz me aftësi të ndryshme nga shoqëria industriale. Kështu në kontekstin e shekullit të 21-të, konceptimi i ri i kurrikulës duhet të jetë fokusi kryesor i arsimit. Në këtë studim metodat e përdorura për të siguruar mbledhjen e të dhënave janë cilësore. Instrumentat e përdorura janë intervista gjysëm të strukturuar të thelluara, me 2 mësues të filozofisë, dhe nëndrejtoreshën e shkollës jo- publike ‘Pavarësia’, Durrës.

Në fund studimi arriti në përfundimin se: zhvillimi i kurrikulës bëhet një proces me vlerë duke përcaktuar se çfarë "duhet" të mësohet në kuadër të institucioneve të shkollave, duke pasur parasysh ndikimet sociale, kulturore, politike dhe mjedisore që dalin nga ky proces i zhvillimit të kurrikulës. Natyrisht, kurrikula ndryshon për të pasqyruar tendencat e zhvillimit në arsim, trajnim dhe tregun e punës. Nevoja për një kurrikul bashkëkohore është jo vetëm një kërkesë në rrafsh global, por edhe një kërkesë në nivel kombëtar. Studimi jep edhe disa rekomandime: shkollat duhet të strukturohen me synimin e parë për të mbështetur ndërveprimin e nxënësve, mësuesve dhe teknologjisë së të gjitha llojeve, përfshirë tekstet që janë zemra e tij.

Fjalët kyç: *kurrikul, filozofi, mësues, nxënës, shkollë.*

PËRZGJEDHIA PROFESIONALE E MATURANTËVE TË SHKOLLËS “LEONIK TOMEO” DURRËS NGA KENDËVËSHTRIMI GJINOR

Denis Xhani

E-mail: cezmi aferes@gmail.com

Abstrakti: Studimi “Zgjedhja profesionale e maturantëve në shkollën “Leonik Tomeo”, Durrës u realizua me qëllim që të zbulojë diferencat dhe dallimet në zgjedhjet universitare të rinjëve vajza dhe djemë duke përcaktuar dhe faktorët real që në gjenezën e tyre, se si kanë ndikuar në zgjedhjet e tanishme të të rinjve maturantë. Në thelb të këtij studimi është zbulimi, nëse maturantët janë më të predispozuar të ndjekin fushat e studimit ku femrat dhe meshkujt janë më të mirepërafqësuar në tregun e punës, bazuar në ndarjen gjinore të punës.

Ky studim u realizua me pjesmarrjen e 210 maturantëve që ndiqnin studimet e mesme në Shkollën e Mesme të qytetit të Durrësit “Leonik Tomeo”. Tek ky studim u aplikua metoda e pyëtësorit të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar i cili u realizua në ambjentet e gjimnazit “Leonik Tomeo”, dhe të dhënat u përpunuan nëpërmjet metodës së shpërndarjes së përqindjeve (dendurive relative).

Nga ky studim rezultoi se: Maturantët e shkollës së mesme “Leonik Tomeo” Durrës pas plotësimit të formularit A1, kishin bërë përzgjedhje të gjinizuara të degëve që dëshironin të studionin, bazuar në ndarjen gjinore të punës. Vajzat preferonin të studionin më së shumti në profilet shoqërore ndërsa djemtë në ato shkencore.

Fjalët kyç: *orinetimi për karrierën, profesioni, barazi, ndarja gjinore e punës, diskriminim.*

SFIDAT E EDUKIMIT NËPËRMJET GJITHËPËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME AUTIZËM NË PROGRAMIN PARASHKOLLOR

Dhurata Rika

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *dhuratarika11@gmail.com*

Abstrakt: Qëllimi i këtij studimi është nxerrja në pah, se sa ndikon ndërgjegjësimi i prindërve për të bashkëpunuar me institucionet e edukimit në zbutjen e vështirësive dhe pengesave, në integrimin e fëmijëve autikë, si dhe për të analizuar rolin dhe rëndësinë e planit PEI. Sa ndikon ky plan në zbutjen e vështirësive për një integrim sa më të mirë të këtyre fëmijëve. Duke ditur se diagnostikimi i fëmijëve me autizëm që në fëmijërinë e hershme dhe integrimi i tij që në programet e parashkollorit, është një domosdoshmëri i cili zbut sadopak “problematikat” që shfaqin këta fëmijë.

Për mbledhjen e të dhënave u përdorën pyetësorët për prindërit, edukatorët dhe intervista për trajnuesit dhe psikologun e shkollës.

Rezultatet e studimit treguan se plani PEI është shumë i domosdoshëm dhe i ndihmon kurdoherë, shumë për t’u integruar. Ndërgjegjësimi i prindërve për të bashkëpunuar me edukatorët është konkret dhe i vazhdueshëm. Prindërit japin mbështetje konkrete për realizimin e objektivave. Prindërit e fshehin autizmin e fëmijëve të detyruar nga rrethanat. Edukatorët kanë shqetësim dhe përgjegjësi kur në grup kanë fëmijë autik.

Nga intervistat e marra nga dy terapistët e qendrës së trajnimit dolëm në konkluzionin se bashkëpunimi prind-terapist është i nevojshëm në të gjitha rastet e fëmijëve në përgjithësi. Bashkëpunimi me prindërit në disiplinimin e fëmijës ka ndikuar shumë dhe ka ndikuar në ulje të simptomave autike. Aktorët që ndikojnë në trajtimin e fëmijëve autik për veç prindërve janë edukatorja, terapistja, logopedistja, anëtarë të tjerë të familjes. Rekomandim nga ky studim: nëse ky ekip tregon vlera në bashkëpunim, vështirësitë edhe mund të zvogëlohen.

Fjalët kyç: *autizëm, PEI, integrim, prindër, edukator.*

SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLEN MËSUESIT E ARSIMIT FILLOR NË APLIKIMIN E VLERËSIMIT NË LËNDËN E EDUKIMIT FIZIK

Elena Kodra

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *elenaakodra@gmail.com*

Abstrakt: Kjo kumtesë diskuton konceptin e vlerësimit të arritjeve sipas kurrikulës me bazë kompetenca, i cili është më shumë i orientuar në ekzaminim. Këtu prezantohen mirëkuptimi, përgatitja dhe përvoja e mësuesëve të arsimit fillor që zhvillojnë edhe lëndën Edukim fizik në lidhje me ndryshimin në qasjen e vlerësimit dhe mënyrën se si ato e kanë zbatuar në këtë lëndë. Arsyeja e hulumtimit ndodh për shkak se kjo lëndë mbulon aspekte teorike të zbatuara teorikisht dhe praktikisht. Studimi ka një qasje cilësore dhe është kryer muajt e fundit me qëllim që të ekzaminojë sfidat me të cilat ballafaqohen mësuesit e arsimit fillor gjatë vlerësimit të EF. Kumtesa thekson sfidat dhe mënyra se si mund të kapërcehen ato. Të dhënat tregojnë se tri sfidat kryesore me të cilat përballen mësuesit janë: njohuritë bazë lëndore, lehtësitë dhe objektet vlerësuese dhe menaxhimi i klasës në EF. Kumtesa kontribuon në njohjen e organizimit të mësuesëve në lëndën EF si dhe realizimin e udhëzuesëve në klasë brenda kontekstit të vlerësimit.

Fjalë kyçe: *vlerësim, edukim fizik, sfida, mësuesit e arsimit fillor*

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM

Elisabeta Gozhita

E-mail: *elisagozhita@gmail.com*

Abstrakt: Në tema të ndryshme mësimore e ndiejmë të rëndësishme përdorimin e teknologjisë, sidomos në rastet kur vetë tema e trajton këtë si fenomen. Në lëndën e gjuhës shqipe në klasën e tetë, një nga temat mësimore që kemi hasur ka qenë “Lojërat elektronike”. Për këtë temë është i rëndësishëm përdorimi i teknologjisë sepse ndihmon në demonstrimin e video- lojërave të ndryshme dhe imazheve që kanë rëndësi për trajtimin e temës. Prindërit pyesin shpesh se përse fëmijët duhet të shkojnë në qendra interneti për të realizuar detyrat e tyre, kur këto të fundit duhet të kryhen brenda ambientit edukativ, shkolles, ku duhet të ekzistojnë kabinetet e informatikës dhe siguria e shpërndarjes së informacionit është më e madhe dhe e kontrolluar posaçërisht nga filtrat e për moshapjen e faqeve të pakontrolluara dhe të jashtëligjshme për moshën minorene.

Gjatë hulumtimit është përdorur metoda sasiore. Instrumentat e përdorur janë pyetësorë të shpërndarë në mënyrë rastësore. Në këtë studim janë përfshirë prindër, mësues të arsimit fillor dhe nxënësit e klasave të treta.

Në këtë studim u evidentua se pengesa më e madhe në zhvillimin e kësaj metode edukimi është, mungesa e internetit dhe kabineteve të informatikës. Mësimdhënia bashkëkohore në ditët e sotme i jep rëndësi përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor nëse e shfrytëzojmë për kërkimet shkencore, por

Disa rekomandime si rezultat i studimit: Pajisja e shkollave me TIK është zakonisht hapi i parë në agjendën e hartuesve të politikave. Politikat duhet të sigurojnë një vision afatgjatë, të shpjeguara në objektiva të detajuara në një shkallë të gjërë veprimi. Lidhur me këtë çështje duhet të përcaktohet një program. Nxënësit, *së pari* duhet të përpunojnë informacionin që marrin, dhe pastaj ta lidhin atë me përvojat që ata njohin nga jeta e tyre: pra lidhja e teknikës me jetën reale dhe me natyrën. *Së dyti*, pavarësia, puna në grupe, shprehitë si baza të nevojshme (të lexuarit, të shkruarit, skicimi) dhe shprehi të tjera të nivelit të lartë të njohjes janë kushte paraprake për një përdorim të suksesshëm të TIK-ut.

Fjalët kyçe: *teknologji ,edukim, informatike, hulumtim, pune ne grupe, program, internet, demonstrim.*

ZHVILLIMET DEMOGRAFIKE TË BASHKISË KOLONJË

Enea Rushiti

Eglenta Liçi

Universiteti Tiranës

E-mail: *enea.rushiti@hotmail.com*

E-mail: *eglentalici@gmail.com*

Abstrakt: Studimet rajonale, si ndërthurëse të analizave me natyrë fiziko-gjeografike me ato demografike, sociale dhe ekonomike, janë vënë gjithnjë e më shumë në qendër të vëmendjes së studiuesve në mbarë botën. Një tendencë e tillë vërehet edhe në vendin tonë. Kolonja me qytet Ersekën e ka zanafillën që në fillim të shek. XVII, duke u populluar dhe zhvilluar në vazhdimësi, në varësi të ngushtë nga kushtet fiziko-gjeografike. Sot, Kolonja përfaqëson një bashki të përbërë nga 6 njësi administrative, pjesë të qarkut të Korçës. Është një ndër bashkitë me numrin më të vogël të popullsisë, duke numëruar gjithsej 14318 banorë prej të cilëve rreth 10000 në zonat rurale. Numri i popullsisë ka ardhur vazhdimisht në rënie, sidomos pas viteve 1990, si rrjedhojë e ndryshimeve politike dhe ekonomike që ndodhën në vendin tonë. Zona ka njohur edhe lëvizjen më të madhe migruese, kryesisht sipas dy drejtimeve: nga fshatrat drejt Ersekës dhe Leskovikut, si dhe nga Erseka drejt qyteteve të tjera, në veçanti drejt Tiranës. Janë pikërisht këto dinamika interesante demografike, sidomos gjatë dekadave të fundit, që përbëjnë boshtin kërkimor të këtij punimi, duke synuar njëkohësisht nxjerrjen në pah të faktorëve që kanë ndikuar në lëvizjen migruese të popullsisë.

Fjalët kyç: *lëvizje hapësinore, emigrim, migrim, lindje, vdekje, shtesë natyrore.*

NDIKIMI I STILEVE TË PRINDËRIMIT MBI VETËVLERËSIMIN E NXËNËSVE

Enkela Manjani

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *enkelamanjani@yahoo.com*

Abstrakt: Stilet prindërore janë një temë e rëndësishme diskutimi në ditët e sotme. Kërkimet e mëparshme kanë raportuar një lidhje midis stileve të prindërimit dhe vetëvlerësimit në grupe të ndryshme etnike dhe në vende të ndryshme.

Ky studim ekzaminon lidhjen dhe marrëdhënien midis stileve të ndryshme të prindërimit dhe vetëvlerësimit në shkollën e mesme publike “Myslym Keta” në Kombinat, Tiranë.

Një kampion prej 100 subjektësh, nxënës të kësaj shkolle, plotësuan instrumentin që përcaktonte stilin e prindërimit (PAQ) dhe shkallën e vetëvlerësimit të Rosenberg-ut (RSE). Rezultatet treguan se stili i prindërimit autoritativ është stili i prindërimit mbizotërues për këtë kampion dhe ka një lidhje domethënëse midis stileve të ndryshme të prindërimit dhe vetëvlerësimit. Kështu, adoleshentët nga familje autoritative shfaqin nivel të lartë të vetëvlerësimit ndërsa adoleshentët nga familje tolerante shfaqin nivel mesatar vetëvlerësimi.

Në këtë mënyrë vërtetohen dy nga tre hipotezat e ngritura për këtë studim. Hiptoteza e dytë e studimit nuk u vërtetua. Kjo hipotezë përmbante lidhjen mes stilit të prindërimit autoritarian dhe nivelit të ulët të vetëvlerësimit. Kufizimet e studimit janë përfshirë në pjesën e diskutimit rreth tij ndërsa rekomandimet përfshihen në përfundimet e studimit.

Si përfundim, ky studim thekson rolin kritik të prindërve dhe të stilit të tyre të prindërimit në vetëvlerësimin e fëmijëve të tyre.

Fjalët kyçe: *prindërim, vetëvlerësimi, eksplorim, adoleshencë.*

TIPOLOGJIA E MËSIMIT DHE ÇERTIFIKIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA

Enkeleda Hoxha

Adriatik Hoxha

E-mail: *delilajenkeleda@gmail.com*

Abstrakt: Në punimin tonë do të trajtojmë problematika të mësimdhënies e nxënies në qendrat e mësimit të gjuhëve të huaja. Si përfaqësues të një qendre japim përvojën tone në menaxhimin e rezultateve të nxënies për fëmijët e Arsimit të mesëm të Ulët e të mesëm të Lartë të regjistruar pranë qendrave të gjuhëve të huaja në qytetin e Fierit.

Mbështetur në kuadrin e përbashkët europian të referencave për gjuhët, programet e mësimit dhe çertifikimit të gjuhëve mund të jenë: *Globalë*, duke e bërë nxënësin të përparojë në të gjitha fushat e aftësitë gjuhësore e komunikative;

I adaptueshëm, duke zhvilluar aftësitë e nxëniesit në një sektor të kufizuar;

I ekuilibruar, duke dhënë rëndësi të veçantë një aspekti të mësimdhënies;

I pjeshëm, duke marrë përsipër vetëm disa shprehje e shkathtësi;

Duke u mbështetur në Analiza të ndryshme pranë qendrës sonë ,mes metodës statistikore do rendisim rëndësinë e secilit program, përmësimin e përvetësimin e gjuhëve të huaja, kryesisht anglisht, italisht e gjermanisht.

Fjalë kyçe: *Programe mësimi, gjuhë e huaj, çertifikim.*

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM

Eriola Tahmazi (Llanaj)

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *eriolatahmazi@gmail.com*

Abstrakt: Ndyshimet e shumta dhe të njëpasnjëshme që po ndodhin në sistemin tonë arsimor sjellin domosdoshmerinë e gërshetimit të vazhdueshëm të njohurive të reja me teknologjinë dhe pse pengesat janë të shumta pasi në shkollat publike ende ka probleme me mjetet mesimore (laborator informatike). Shkollat tona janë ende larg digjitalizimit dhe procesit të përvetësimit të njohurive të reja nëpërmjet hulumtimit, është ende në hapat e para . Sa të aftë janë mësuesit tanë, jo vetëm në nivelin shkencor, por dhe më tej. Mos ndoshta reformimi duhet të fillojë në nivelet arsimore dhe pastaj të kalojë në tekstet dhe programe mesimore?!

Synimi i këtij studimi është të evidentojë domosdoshmërinë e digjitalizimit të të gjitha shkollave, minimalisht me një sallë kompjuterash ku nxënësit të marrin njohuritë minimale kompjuterike. Metoda e përdorur në studim është cilësore, ku u aplikua vëzhgimi në orë të ndryshme mesimore, biseda me mësues, nxënës , drejtues dhe pyetësorë të cilët shtojnë pyetje se sa shpesh mësuesit përdorin teknologjinë në orët e mësimit. Përzgjedhja me kampionim ka qënë rastësore (në shkolla brenda qytetit të Fierit). Të gjitha të dhënat e mbledhura u analizuan në formë statistikore dhe u bë paraqitja grafike e tyre.

Nga ky studim jepen disa rekomandime. Ndyshimet në kurrikulën e re kërkojnë përdorimin i metodave bashkëkohore për nxitjen e mendimit kritik të nxënësve dhe përgatitjen e individit me aftësi për jetën. Gjithashtu kërkohet edhe trajnimi i mësuesve në informimin dhe zbatimin e kurrikulës së re.

Fjalët kyçe: *teknologji, edukim, digjitale, kurrikul, formë statistikore .*

RRITJA E VLEFSHMERISË NË VLERËSIM NËPËRMJET NJOHJES DHE ZBATIMIT TË NIVELEVE TË ARRITJES PER REZULTATET E TË NXËNIT

Erisa Dorzi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *Erisaosmani0@Gmail.Com*

Abstrakt: Kurrikula bazuar në kompetenca dhe të vlerësuarit nëpërmjet niveleve të arritjes operojnë tashmë prej disa vitesh në arsimin fillor shqiptar. Kjo kurrikul synon që të ndikojë drejtpërsëdrejti në rezultatet e nxënësve të arsimin fillor në fusha të ndryshme.

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë qëndrimet e mësuesve, të drejtuesve dhe të nxënësve të arsimin fillor, në lidhje me vlerësimin me anë të niveleve të arritjes të rezultateve të të nxënësve, si një risi në Arsimin Fillor. Ky studim synon të tregojë se cilat janë qëndrimet e mësuesve në lidhje me zhvillimin profesional për vlerësimin me anë të niveleve të arritjes; qëndrimet e mësuesve në lidhje me efektshmërinë e vlerësimit me anë të niveleve të arritjes; qëndrimet e mësuesve në lidhje me barazpeshën mes elementëve të vlerësimit në mënyrë që të sjellë produktivitet në rezultatet e nxënësve; qëndrimet e nxënësve në lidhje me vlerësimin nëpërmjet niveleve të arritjes; qëndrimet e drejtuesve të shkollave në lidhje me punën e mësuesve në të vlerësuarit nëpërmjet niveleve të arritjes. Kampioni janë mësuesit, nxënësit e klasave të para, të dyta e të treta si dhe drejtuesit e shkollave që mbulojnë arsimin fillor, në qytetin e Tiranës dhe Durrësit. Instrumentat e përdorur janë pyetësorët për mësuesit, nxënësit, Drejtuesit, si dhe vëzhgim i dokumentacionit të vlerësimit. Përpunimi i të dhënave u bë nëpërmjet programit kompjuterit “Microsoft Excel”.

Rezultatet e studimit treguan që mësuesit janë të mirë informuar dhe pothuajse janë adaptuar me të vlerësuarit nëpërmjet niveleve të arritjes. Ata tashmë operojnë me këtë mënyrë të re vlerësimi, por gjithsesi hasin vështirësi përse i përket plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit. Përse i përket qëndrimeve të nxënësve ata tashmë janë mësuar me vlerësimin nga 1-5 dhe pëlqejnë të punojnë e të vlerësohen në grup. Ndërsa drejtuesit e shkollave janë në gatishmëri për çdo paqartësi që mësuesit kanë në lidhje me këtë formë vlerësimi. Mbështetur në rezultatet e studimit rekomandojmë që mësuesit të nxisin më tepër punën në grupe në klasë, të vlerësojnë nga 1-5 në mënyrë objective dhe drejtuesit e shkollave të kenë një frymë bashkëpunimi me mësuesit e tyre për përsosjen e procesit mësimor.

Fjalë kyçe: *vlerësimi me kompetenca, nivelet e arritjeve, rezultatet e të nxënësve, drejtues shkollave, mësues, nxënës i arsimin fillor.*

STUDIMI I TREGUT TË PUNËS DHE ORIENTIMET DREJT SË ARDHMES

Erland Llanaj

Abstrakt: Studimi i tregut në ditët e sotme është i rëndësisë së veçantë pasi informon në mënyrë të drejtëpërdrejtë maturantët, por edhe nxënësit e klasave të nënta që të marrin drejtimin e duhur në jetë. Mungesa e informacionit për llojet e ndryshme të arsimit fillon që nga klasa e nëntë me edukimin për karrierën ku nxënësit mund të ndjekin gjimnazin sipas prirjeve që kanë profesional ,i përgjithshëm ose artistik. Në maturë bëhen orë të veçanta për edukim për karrirën në të cilën nxënësit orientohen drejt së ardhmen në formën e duhur në mënyrë të tillë që të rinjtë të mos përballen më vonë me vështirësitë për të hyrë në tregun e punës. Për informimin e nxënësve duhet të luajnë rolin e tyre të gjithë aktorët si familja dhe shkolla për të bërë të mundur zgjedhjen e drejtë për një të ardhme më të sigurtë. Është i rëndësishëm adresimi njëherazi i kërkësës dhe ofertës njëkohësisht . Në periudhën 2003 – 2008 shkalla e çarsimit për popullsinë shqiptare të moshës 15 vjeç e lart ishte 99%. Psikologët janë kategorikë se zgjedhja duhet të jetë në përputhje edhe me veçoritë individuale të çdo individi. Këshillimi i karrierës ende është në hapat e para në Shqipëri dhe kjo vjen si pasojë e mosvlerësimit si duhet nga grupet e interesit dhe kompanitë e punësimit. Këshilluesi i karrierës në këtë treg të vështirë dhe kaotik është i domosdoshëm, pasi gjuetia e çdo pune mund të rezultojë një dështim që ka rrjedhimisht pasoja të pallogaritshme në jetët e tyre familjare dhe sociale. Në disa raste, këto dështime kanë sjellë pasoja të rënda ekonomike dhe psikologjike për kandidatë të ndryshëm. Për të marrë një informacion më të plotë, janë marrë kampione të ndryshme dhe është bërë një analizë statistikore me nxënës te moshave 14 -15 vjeç dhe 17 -18 vjeç,biseda me drejtues shkollash dhe mësues të ndryshëm në zonat rurale të qytetit të Fierit.

Fjalë kyçe: kompani punësimi, orientim, treg pune, mundësi, këkesë, ofertë.

RËNDËSIA E NXITJES SË MENDIMIT KRITIK TE NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE.

(Rast studimor i shkollës “Pinellopi Piro” Fier)

Evelina Delvina

E-mail: evelinadelvina1@gmail.com

Abstrakt: Ndër studiues të ndryshëm, sa herë në konsideratë merret modeli arsimor fillor i Lindjes, dy ndër problematikat thelbësore të vërejtura janë mungesa e rrugëve kreative drejt ushtrimit shkollor për zgjidhje problemesh dhe, më kryesori në bindjen tonë, mungesa e sprovave që nxisin të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve shkollore nga nxënësit. Ky punim, më së shumti, duke e konsideruar si një sfidë të shekullit bashkëkohës mësimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore, do të ndalet e thellohet pikërisht këtu.

Nëpërmjet një kërkimi të miksuar, sasior dhe cilësor, do të paraqesim në dritën e një trajtесе teorike mësimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore të nxënësve sipas një studimi të ndërmarrë nga British Council dhe qeveria britanike, rëndësinë dhe hapat e ndërtimit të një strategjie të tillë si edhe, në anën tjetër, do të paraqesim gjetje prej të dhënave sasiore të mbledhura nga anketat e një shkolle fillore në qytetin e Fierit, “Pinellopi Piro” në katër nivele : drejtues, mësimdhënës, prindër dhe nxënës, ku fokusin kryesor e kanë këta të fundit.

Nisur edhe nga studimi i referuar më sipër, që do të përbëjë bazën e të dhënave teorike, në boshtin kryesor të trajtës tonë do të jenë konteksti i mësimin kritik dhe zgjidhjes së problemeve, përshtatja e koncepteve komplekse me përvojat e nxënësve, ndërtimi i strategjive të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve si dhe pesha e ushtrimit praktik të vazhdueshëm të nxënësit, duke bërë më pas, në një hap të dytë, përmes anketave në shërbim të rastit studimor, vëzhgimin e rastit në fjalë.

Të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve është një ndër sfidat e shekullit XXI, që ndikon në brezat pasardhës. Ushtrimi i mendimit kritik në brezat e nxënësve të shkollave fillore nxit breza të rinjsh me bazament të shëndetshëm për studime më të thelluara.

Fjalët kyçe: *mendim kritik, zgjidhje problemesh, konteksti i mësimin, përshtatja e koncepteve komplekse, strategjitë e punës dhe ushtrimi praktik.*

ROLI I MËSUESIT NË NXITJEN E MOTIVIMIN NË ARSIMIN FILLOR

Flavja Goseni

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Email: *flavjagoseni@gmail.com*

Abstrakti: Nëpërmjet këtij punimi synohet të tregohet puna e mësuesit, metodat, teknikat, strategjitë e mësimëdhënies që mësuesi ve në përdorim të një klase, për të motivuar nxënësit. Por dhe ajo që mund të bëhet për të nxitur nxënësit që të jenë sa më të qetë, të motivuar dhe aktiv në mësimëdhënie dhe mësimënxënie. Dihet se çdo aktivitet është i kushtëzuar nga motivimi i individit, i cili të gjallëron, drejton dhe mbështet sjelljen e çdo njeriu. Motivimi përfaqësohet nga forcat që veprojnë mbi ose brenda një personi dhe e detyrojnë atë të sillet në një mënyra të caktuar sepse njerëzit janë të ndryshëm dhe nuk mund të motivohen nga e njëjta gjë. Prandaj puna e mësuesit është të dijë të motivojë nxënësit e tij në mënyrë sa më efektive.

Mbledhja e informacionit u realizua nëpërmjet intervistave të zhvilluara me 20 mësues të klasave fillore në shkollën “Sh. Mazreku” në zonën urbane dhe “N. Babameto” në zonën urale dhe me 64 nxënës të po këtyre shkollave të klasave të, treta, të katërta, të pesta. Një instrument tjetër i përdorur për studimin e temës është dhe vëzhgimi, për të parë metodat, strategjitë, mënyrat që përdorin mësuesit për të motivuar nxënësit në klasë. Vëzhgimi është kryer në dy shkollat e qytetit të Tiranës. Në vëzhgim janë marrë nxënës nga klasat e treta të shkollave urbane dhe rurale. Në një studim rasti në shkollën “14 Nentori” tregohet se si mungesa e motivimit ka sjellë uljen e të nxënësve tek nxënësi si dhe mos paturit më dëshirën për të frekuentuar shkollën. Pra pasojat të shumta që sjell mungesa e motivimit tek fëmijet e arsimit fillor.

Ky studim identifikoi mungesën e motivimit në përvetësimin e veprimtarive shkollore, mënyrën se si ndikon ambjenti që i rrethon në nxitjen e motivimit të nxënësve, mjetet ndihmëse që ndihmojnë në procesin e të nxënësve.

Fjalet Kyçe: *mësues, nxënës, shkollë, motivim, komunikim, vlerësim.*

MËSIMDHËNIA ME NË BAZË KOMPETENCAT

Igli Lami

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *igilami@yahoo.com*

Abstrakt: Korniza kurrikulare e arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë përbën një risi me vlera të mëdha për arsimin shqiptar. Ky dokument i hartuar në vitin 2014 mund të thuhet se përbën një revolucion në arsimimin e fëmijëve apo rinisë shkollore. Kjo kurrikul jetëson kalimin nga kurrikula që synonte në përvetësimin e përmbajtjeve lëndore, në një kurrikul që krijon kushte dhe mbështet zhvillimin e kompetencave.

Nga ana tjetër dhe vetë pajisja me dije e nxënësve ndryshon me ato që ofronin kurrikulat e mëparshme tradicionale, ku dijet transmetoheshin nga mësuesi sipas një radhe të përcaktuar në synimet apo objektivat e orës së mësimin. me reformën e re kurrikulare, që bazohet në filozofinë konstruktiviste, dija ndërtohet nga vetë nxënësit.

Ky punim synon të paraqesë njohuri dhe informacion më të thelluar në lidhje me sistemin e ri arsimor parauniversitar. Konceptet dhe praktikat e këtij sistemi synojnë një nxënie më efektive, të larguar nga monotonia e arritjes së objektivave dhe që udhëheq nxënësit drejt suksesit në të nxënë. Këtu gjithashtu do të paraqiten disa opinione të disa mësuesve (njëkohësisht kolegëve të mi) që po praktikojnë këtë sistem. Janë shfrytëzuar dhe punuar një larmishmëri metodash dhe mjetesh (duke përfshirë informacione, dokumente, libra, intervista, biseda etj), ku synohet arritja e një punimi atraktiv, i larmishëm dhe jo monoton.

Fjalë kyçe: *Mësimdhënie, kompetenca, nxënës, kurrikul, sistem.*

TË NXËNËT SI REZULTAT I PËRVETËSIMIT TË KURRIKULËS NË ARSIMIN FILLOR

Jonida Albra

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Abstrakt: Kompetenca “Të mësuarit për të nxënë”, është një nga kompetencat kyçe që përmban kurrikula e re e Arsimit fillor. Përvetësimi i kurrikulës është një nga tre elementët e kurrikulës krahas planifikimit dhe zbatimit të saj. Përvetësimi i kurrikulës reflektohet te të nxënërit e nxënësve.

Ky studim sjell refleksionet e kësaj çështjeje në shkollën “Vasil Ziu” në Durrës.

Metodologjia e ndjekur është cilësore bazuar në intervista gjysëm të strukturuar. Intervistat me mësuesit, vëzhgimet e orientuara dhe perceptimet mbi rezultatet e përvetësimit të kurrikulës janë teknikat kryesore të përdorura.

Studimi arrin në përfundimin se përvetësimi i kurrikulës me bazë kompetencat nuk ka rezultate të larta në nivelin e njohjes dhe formimit në përgjithësi. Mësuesi has më shumë vështirësi teknike dhe shprehi kualitative për mësimdhënien e parashikuar. Nxënësve shpesh i mungojnë përvojat e nevojshme. Mësuesit ndjehen më të ngarkuar dhe prindërit më të paqartë.

Fjalë kyçe: *nxënës, mësues, kompetenca të mësuarit për të nxënë, përvetësim i kurrikulës*

METODAT EFEKTIVE TË MËSIMDHËNIES NË NDIHMË TË PËRVETËSIMIT TË KURRIKULËS SË RE NË ARSIMIN FILLOR

Kristila Anelli

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E- mail: *anellikristila@gmail.com*

Abstrakt: Ky studim synon të identifikojë metodat efektive të mësimdhënies gjatë zbatimit të kurrikulës së re në arsimin fillor. Hulumtimi u realizua në shkollat 9-vjeçare “Nënë Tereza” dhe “Bedrie Bebeziqi”, në qytetin e Durrësit.

Në studim u përfshinë 20 mësues (8 prej tyre me një përvojë 20- vjeçare në arsim fillor, dhe 12 nga mësuesit me një përvojë 10- 15 vjeçare) dhe nxënës të klasave të para, të dyta dhe të treta.

Metodat e përdorura janë cilësore. Intervistat me mësuesit, vëzhgimet në klasë, analiza e punës përgatitore, analiza e protofoleve të nxënësve dhe dokumentacionit shkollor, janë disa nga instrument e përdorura.

Punimi bën një krahasim të metodave më efektive të mësimdhënies të përdorura nga mësuesit gjatë zbatimit të kurrikulës së re me ato të kurrikulës së mëparshme. Sipas rezultateve të këtij studimi, qasja më e mirë e mësimdhënies është ndërthurja e shumë metodave me në qendër nxënësin, duke u bazuar në kompetenca dhe ndërthurjen e tyre, në funksion të një mësimdhënie sa më shumë efektive. Me studimin konkret, po kërkohet një metodë mësimore që veç të tjerash, ndihmon nxënësin që të luftojë pasiguritë e tij gjatë procesit të mësimdhënies. Studimi provon se mësuesit kanë nevojë për trajnime të metodave, për një mësimdhënie efektive.

Fjalë kyçe: *metoda, mësimdhënie, kurrikula e vjetër, kurrikula e re, kompetenca.*

NDIKIMI I TEKNOLOGJISË PËR NJË MËSIMDHËNIE EFEKTIVE

Kristjana Janko
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
E-mail: *kristijana.janko@gmail.com*

Drilona Ramaj
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
E-mail: *drilona.ramaj97@gmail.com*

Abstrakt: Ky studim do të fokusohet në integrimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Duke dashur të argumentojmë se integrimi i teknologjisë në këtë proces është një domosdoshmëri, do të rëndësisht disa nga arsyet që e bëjnë si të tillë këtë proces: bumi informativ për shumë çështje, jetojmë në një botë të teknologjisë, menaxhimi i informacionit në kohë reale, shpejtësia e informimit, shumëllojshmëria e informacionit, selektimi i informacionit sipas qëllimit, sipas rëndësisë, sipas besueshmërisë së burimit etj

Studimi është bërë në katër shkolla 9-vjecare të DAR Durrës përkatësisht: shkolla 9-vjecare “14 Nëntori”, “Vasil Ziu”, “Bajram Curri” dhe “Qemal Mici”. Nxënësit dhe mësuesit janë anketuar përmes pyetësorëve përkatësisht për zbatimin e teknologjisë gjatë procesit të mësimdhënies, si dhe mënyrat e përdorimit të tij në realizimin e detyrave të ndryshme.

Përmes pyetësorëve janë anketuar nxënës të klasave të nënta. Në këto klasa mësimi zhvillohet me metodën bashkëkohore, por jo në të gjitha klasat e këtyre shkollave përdoret teknologjia. Për realizimin e studimit ne kemi bërë pyetësorë me 16 mësues dhe 480 nxënës në të katër shkollat.

Në shkollat e DAR Durrës, situata e sotme e pajisjeve me teknologji, në shkollat e marra si monstra studimi, flet për një përsosje më të mirë të teknologjisë në këto shkolla si dhe lidhjen e tyre me internet nëpër klasa.

Përdorimi i teknologjisë në procesin e mësimdhënies ka sjellë disa ndryshime të rëndësishme në procesin e edukimit, ndër më të rëndësishmet janë:

- Kompetenca digjitale u bë domosdoshmëri, ndaj ajo është pjesë jetike e formimit shkencor të nxënësve.
- U zhvillua mësimdhënia në distancë si një mundësi joformale, por zyrtare e edukimit.
- Pati një impakt të jashtëzakonshëm në mësimdhënien e gjuhëve të huaja.

Fjalë kyçe: *teknologji, mësimdhënie, mësimnxënie, efektivitet, metodologji edukative.*

MËSIMDHËNIA NË KONTEKSTIN BASHKOHOR NËPËRMJET TË NXËNIT INTERAKTIV NË ARSIMIN FILLOR

Luan Hima

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *luanhima@yahoo.com*

Abstrakt: Mësimdhënia bashkëkohore synon aktivizimin dhe angazhimin interaktiv të nxënësit, mësuesit dhe komunitetit. Ta përfshish nxënësin më shumë se sa një dëshirë është një strategji metodike e mësuesit për përvetësimin e kurrikulës.

Objekti i këtij punimi është përfshirja interaktive e nxënësve në veprimtaritë mësimore gjatë orës së mësimin.

Modeli i punimit ndjek metodat clësore të hulumtimit. Vëzhgimi, intervistat, metanaliza janë disa nga teknikat e përdorura për qartësimin e ideve dhe konkluzioneve.

Punimi arrin në përfundimin se interaktiviteti është motivues në aktivizimin e nxënësve për t'u bërë faktor në të nxënët e tyre. Interaktiviteti është një mundësi e mirë në formimin e kompetencave kyç, kryesisht tek ato që lidhen me zhvillimin gjuhësor, zhvillimin e të menduarit kritik, zhvillimin psikosocial, qytetar e personal, etj.

Nxënësit që përfshihen lirshëm në aktivitete interaktive reflektojnë rezultate më të larta në arritjet e tyre.

Fjalët kyç: *përfshirje interaktive, socializim, kompetenca, arritje.*

PERCEPTIMET E PRINDËRVE DHE MËSUESVE MBI EFEKTIVITETIN E DETYRAVE TË SHTËPISË NË ARSIMIN FILLOR

Luljeta Plaka

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: luljetaplaka@hotmail.com

Abstrakt: Politikat e ngurta në shkollat shqiptare, mënyra e organizimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të drejtojnë gjithnjë e më shumë drejt nevojës që mësuesit t’u japin nxënësve detyra shtëpie. Koha që disponon një mësues në klasë për të arritur objektivat dhe një mësimdhënie të efektshme për nxënësit e tij, nuk është e mjaftueshme, prandaj ai është i detyruar që një pjesë të detyrave t’ua japë nxënësve për t’i zgjidhur në shtëpi. Angazhimi i madh për detyrat e shtëpisë nuk i takon vetëm fëmijës. Janë prindërit, atyre që në rastet më të shpeshta, detyrimisht iu bie të kujdesen për nxënësin dhe performancën e tyre, duke luajtur kështu një rol mjaft të rëndësishëm në mësimnxënien e fëmijës.

Qëllimi i këtij studimi cilësor është shqyrtimi i perceptimeve të prindërve dhe mësimdhënësve të nxënësve të shkollave fillore në lidhje me detyrat e shtëpisë. Në mënyrë të veçantë, për nxënësit e arsimit fillor. Përveç kësaj, qëllimi është të mësohet si mësuesit me vite të ndryshme të përvojës së tyre kanë parë detyrat e shtëpisë dhe si i përcaktojnë ato. Prindërit vënë në dukje se mungojnë format kreative të vlerësimit dhe të mësimdhënies, nëpërmjet së cilave fëmijët i pranojnë më lehtë detyrat e tyre shkollore, rrisin interesimin për të nxënë dhe mbahen të motivuar që të pajisen me njohuri të reja.

Në këtë studim cilësor, analizohen reagimet e marra nga dy fokus grupe: një grup prej 35 prindërve dhe një grup prej 25 mësuesish në një shkollë në Tiranë. Në këtë studim u përdor metoda e pyetjeve të hapura me anë të intervistës. Pyetjet e hapura sollën një larmishmëri mendimesh. Të dhënat cilësore janë të bollshme dhe ofrojnë për studimin të dhëna të mjaftueshme për të arritur në përfundime. Këto intervista u zhvilluan në mjediset e zgjedhura nga pjesëmarrësit. Të gjitha intervistat u regjistruan, u shkruajtën fjalë për fjalë dhe u shqyrtuan nga pjesëmarrësit për të vërtetuar saktësinë para fillimit të kodimit. Përveç kësaj, të dhënat e diskutueshme nga pjesëmarrësit u dokumentuan. Gjetjet e studimit dolën nga analiza e të intervistuarve pjesëmarrës: detyrat e shtëpisë mund të çojnë në stres; detyrat e shtëpisë duhet të jenë të diferencuara; detyrat e shtëpisë duhet të jenë të shkurtra; detyrat e shtëpisë zbulojnë sukseset dhe fushat e interesit të nxënësve.

Fjalë kyç: *vlerësim, mësimdhënie efektive, detyra, diferencim, sukses.*

TIK DHE MËSIMDHENIA INTERAKTIVE SI ZGJIDHJE BASHKËKOHORE NËN KOMPETENCAT E MËSUESIT.

Lytfi Alliu

Ky studim ka për qëllim të sjellë në vëmendje situatën reale në të cilën gjenden shkollat tona, mes së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes, mes formave standarte dhe bashkekohore të mësimdhënies nën influencën e bumit teknologjik. Arsimi është një nga fushat më të rëndësishme të cdo shoqërie dhe si i tillë ai ndikohet nga vetë ndryshimet e saj. Kjo është arsyeja që sistemi ynë arsimor ne 20 vitet e fundit ka qenë në proces ndryshimi te vazhdueshëm duke ju përshtatur kështu ndryshimeve sociale.

Duke qenë gjithashtu truri i cdo shoqërie Arsimi ka për detyrë të përgatisë për një jetë më të mire individin duke i dhënë atij aftësitë e nevojshme për përshtatje në ndryshime dhe kontribum në zhvillimin tërësor te saj. Ky qëllim realizohet më së miri nëpërmjet edukimit në mjediset arsimore, aty ku në bashkeveprim kemi një sërë faktorësh. Mësuesi, nxënësi, metodat në mësimdhënie, mësimnxënia, TIK (mjeti medial me i fuqishëm I edukimit). Mësuesi i cili është i lidhur ngushtë me procesin e të mësuarit dhe luan një rol shumë të rëndësishëm. Ndryshe nga 10 vjecaret e mëparshëm mësuesi nuk është më një burim informacioni por një udhëheqës dhe organizues i mire i mësimdhënies me në qendër nxënësin. Ky i fundit tashmë nxitet për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe me ndihmën e mësuesit arrin të zgjidhë problemin. Mësimdhënia ashtu si te gjithë elementet e lartë përmendur është duke ndryshuar në një evoluim te fuqishëm, përdorimi i metodave dhe metodikave të shumta janë duke e shndërruar atë në një sfidë të vërtetë.

Përballë saj ngrihen pyetje të shumta: Cili është roli i mësuesit në procesin e të mësuarit? Cili quhet mësues i sukseshëm? Cfarë cilësish mëshiron ai? Si mund të bëhemi mësues të sukseshëm? Si mund të arrijmë të kemi në klasa nxënës të vëmendshëm, dëshirën e tyre për frekuentim të rregullt, rezultate të kënaqshme të njohurive, të sjelljes së tyre? Dikush fajëson ditët në të cilat jemi sot ku cdo gjë ashtu si dhe arsimi është drejtuar rreth modernizimit, emancipimit, përditësimit me format më bashkekohore me ritme shumë te shpejta aq sa ndonjëhere ne nuk jemi në gjendje as ti perthithim në kohën dhe mënyrën e duhur. Përgjigjet e këtyre pyetjeve, gjetja e rrugëve nëpër të cilat do kaloje reformimi i sistemit arsimor, puna dhe përditësimi i mësuesve me mjetet mënyrat dhe format e reja teknologjike duket sikur do të jenë zgjidhje e shpëjtë që do të na vijë në ndihmë të edukimit te fëmijëve tanë.

Fjalë Kyce: *TIK, arsimi, metoda interaktive, mësimdhënie.*

METODAT E MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Manushaqe Noka
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
E-mail: *shaqe.noka@gmail.com*

Abstrakt: Ky studim ka si qëllim që të evidentojë metodat kryesore që duhet të përdoren sot nga mësuesit për të përfshirë në procesin mësimor nxënësit me nevoja të veçanta. Arsimi është një nga sferat me perspektivë të jetës dhe, si i tillë, duhet t’u ofrojë mundësinë pjesëtarëve të shoqërisë që të edukohen pa përjashtime.

Punimi nuk synon vetëm evidentimin e këtyre metodave të mësimdhënies, por synon edhe të hulumtojë mbi rëndësinë që kanë metodat bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë grup nxënësish.

Në këtë studim do të kemi një kombinim të metodave cilësore me ato sasiore, të cilat do të na sigurojnë informacion mbi shkallën e rezultateve që jep përdorimi i këtyre metodave. Shkalla e bashkëpunimit Mësues-Prind-Nxënës është një pikë kyçe e këtij studimi, që do të vlerësohet nëpërmjet metodave sasiore (Pyetsorë). Metodat cilësore do të na sigurojnë material teorik mbi metodat e mësimdhënies dhe ndikimet që kanë ato te nxënësit me nevoja të veçanta.

Nga ky kërkim synojmë të arrijmë në rezultate, të cilat do të tregojnë se cilat janë disa nga metodat që mësuesit duhet të përdorin, në mënyrë që të sigurojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në orën mësimore.

Një nga format më të mira për të plotësuar nevojat e këtij grupi nxënësish, është bashkëpunimi, jo vetëm me mësuesin, por edhe me bashkëmoshatarët apo prindërit. Për këtë grup nxënësish duhet të ofrohet më shumë mundësi për ndërveprim social.

Studimet tregojnë se nxënësit me nevoja të veçanta mund të përfitojnë në dy drejtime, si në shkollë ashtu edhe në shoqëri, si rrjedhojë e arsimimit të tyre në klasa të zakonshme. Nxënësit me nevoja të veçanta paraqesin sfidë fizike, shoqërore edhe akademike për mësuesit. Këta nxënës kanë nevojë për programe mësimore të veçanta, në mënyrë që të arrihet barazia arsimore.

Fjalë Kyçe: *edukim, mësimdhënie, metoda, nxënës me nevoja të veçanta, bashkëpunim.*

SHKRIMTARËT SHQIPTARË NGA BUZUKU TEK ARBËRESHËT E GREQISË

Marcela Zyka

E-Mail: *marsela.zyka1@gmail.com*

Abstrakt: Në librin që kemi marrë në studim pasqyrohet krijimtaria e penave të ndritura të Letërsisë Shqipe që nga fillesat e saj, nga viti 1462 deri në vitin 1878, përfshirë në përmbledhjen e I, të vitit 1941, titulluar "Shkrimtarët Shqiptarë" të autorit Namik Ressuli nën kujdesin e nestorit të letrave Ernest Koliqi. Në këtë përmbledhje njihemi me historinë e letërsisë shqipe, duke filluar nga "Formula e Pagzimit" (1462) e deri tek arbëreshët e Greqisë. Nga vetë emërtimi Historia e Letërsisë Shqipe kuptohet se, objekti i saj është studimi i historisë së shkrimit shqip. Këtë libër autori e ka ndarë në shtatë kapituj. Në secilin nga këto kapituj ai është ndihmuar nga disa bashkëautorë si: Aleksandër Xhuvani, Filip Fishta, Justin Rrota, Karl Gurakuqi, Lumo Skendo, Rosolin Petrotta dhe Zef Valentini.

Për të përcaktuar metodën që është përdorur në këtë punim përmbledhës, nuk është shume e vështirë, pasi vetë shkrimet të gjenden në të, të cojnë drejt përdorimit të metodës strukturaliste. Ressuli na jep një përmbledhje në planin diakronik të gjuhës, pasi ai na paraqet historinë e gjuhës që nga fillesat e saj nga viti 1462 deri në vitin 1878. Kjo përmbledhje e krijuar nga studiuesi për arsye të nevojave shoqërore dhe detyrimit kombëtar. Ne mendojmë se autori na e sjell këtë tekst me qëllimin që të na njoh me historinë e letërsisë sonë shqipe ndër vite, duke dashur të shmang humbjen e tyre. Këtë pasqyrim Ressuli e bën në mënyrë kronologjike. Ky studim që nga momenti i krijimit u mendua të shërbejë si tekst shkollor.

Fjalët kyç: *shkrimtarët shqiptarë, arbëreshët e Greqisë, letërsia shqipe, analizë.*

KËRKIMI SHKENCOR I VËRTETË APO NJË MIT

Markeljana Laska (Sulaj)

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

E-mail: *markela.sulaj@gmail.com*

Abstrakt: Me kërkim shkencor kuptojmë një proces të kujdesshëm dhe sistematik i hetimit për të gjetur përgjigjet për një problem të caktuar. Duke pasur parasysh se një kërkim shkencor përcaktohet si bazë e arsimit të lartë dhe i cilësisë në mësimdhënie atëherë universitetet konsiderohen si institucione më të përshtatshme për zhvillimin e një kërkimi shkencor. Punimi im synon të hulumtojë për termin "kërkim shkencor". Qëllimi I këtij studimi është të paraqesnjohjen e kërkimit shkencor në universitetet tona. Mirëpo në vendin tonë, në një pjesë të madhe të universiteteve nuk zhvillohen kërkimet shkencore sepse mungojnë materialet nuk ka fonde për të sponsorizuar një kërkim shkencor. Rast konkret të një punimi shkencor kemi temën e diplomës, e cila që të quhet 100% një kërkim shkencor duhet të plotësojë kriteret kryesore të tij siç janë: origjinaliteti, risia, metodologjia dhe rëndësia. Shpesh ndodh që punimet e studentëve mos t'i kenë respektuar këto kriteret. Në studim është përdorur metoda cilësore me instrumentin e vëzhgimit, në universitetin "Aleksandër Moisiu" gjithashtu është përdorur edhe Intervista. Janë intervistuar dhjetë student të kualifikuar. Dy pyetjet kryesore të intervistës ishin rreth origjinalitetit të temës së diplomës dhe sa në ndihmë ju vinte biblioteka dhe teknologjia për punimin e tyre. Konkluzionet e studimit janë: Studentët u përgjigjën që në punimin e tyre nuk respektoheshin disa kriteret sidomos sjellja e risisë, që për ta ishte shumë e vështirë pasi shumë gjëra janë thënë tashmë. Në punimin e tyre bënë citimet përkatëse për të respektuar të drejtat e autorit. Në ndihmë ju vinte dhe biblioteka e universitetit si dhe teknologjia ku shpesh njiheshin me shembuj të ndryshëm të punimeve të diplomës. Nga konkluzionet del që në rast se një universitet ka mjetet ndihmëse ka fondet përkatëse në një të ardhme mund të kemi kërkime shkencore mjaft të mira.

Fjalët kyçe: *punim, kërkim shkencor, universitet, diplomë, problem, student.*

RËNDËSIA E MËSUESIT MOTIVUES NË KLASAT FILLORE

Mine Mali

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

E-mail: *mine.mici@hotmail.com*

Abstrakt: Nëpërmjet këtij punimi synohet të tregohet puna e mësuesit për metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimit që mësuesi vë në përdorim në klasë për të motivuar nxënësit. Në këtë studim m'u mundësua të shoh nga afër realitetin në shkollat tona. Mësuesi ka qenë dhe mbetet figura qendrore në shkollë. Puna e mësuesit është përcaktuar si një nga detyrat më të vështira dhe më me përgjegjësi. Ajo që mund të bëhet për të nxitur nxënësit që të jenë sa më të qetë duhen motivuar dhe të jenë aktivë në mësimit dhe mësimit.

Edukimi është mënyra më e mirë për të mbajtur gjallë brezat e demokracisë në shkollë, jetë, shoqëri e familje. Dihet se çdo aktivitet është i kushtëzuar nga motivimi i individit, motivimi është ai i cili të gjallëron, drejton dhe mbështetet sjellja e njeriut. Mungesa e motivimit lind shumë probleme në lidhje me ecurinë e nxënësve në shkollë. Motivimi përfaqësohet nga forcat që veprojnë mbi ose Brenda një personi. Prandaj puna e mësuesit është të dojë e të motivojë nxënësit e tij në mënyrë sa më efektive.

Nxënësit të cilët motivohen, stimulohen nga mësuesit arrijnë rezultate të kënaqshme në mësimit dhe nxënie. Mbledhja e informacionit u realizua nëpërmjet intervistave me qasje cilësore të zhvilluara me 20 mësues të klasave fillore në shkollat e Tiranës si: "Bashkim Berisha", "Pezë Helmës", "Pezë e vogël". Në intervistim morën pjesë 50 nxënës të po këtyre shkollave të klasave fillore. Një instrument tjetër i përdorur për studimin e temës është vëzhgimi, për të parë metodat, strategjitë dhe mënyrat që përdorin mësuesit për të motivuar nxënësit në klasë. Vëzhgimi është kryer në 3 shkollat e fshatrave të Tiranës.

Ky studim identifikon mungesën e motivimit në përvetësimin e nxënësit, mjetet ndihmëse që ndihmojnë procesin e të nxënit, përdorimin e dhunës psikologjike dhe mosmarrjes parasysh të kërkesave individuale, nevojave sociale, emocionale të secilit nxënës.

Fjalë kyçe: motivim, nxënës, mësimit, mësimit.

MOTIVIMI I NXËNËSVE NËPËRMJET PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË NË KLASAT E ARSIMIT FILLOR

Nevila Domi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *neviladomi96@gmail.com*

Abstrakt :Në epokën e kohës moderne, ku pasuria e informacionit mund të arrihet përmes një sere pajisjeve dhe teknologjia po evoluon gjithnjë e më shumë, lind nevoja që mësuesit të shfrytëzojnë më së miri atë. Teknologjia që dikur ishte e shtrenjtë dhe e kufizuar, tani ka përparuar dhe po bëhet mjeti kryesor i gjetjes së informacionit për nxënësit. Nxënësit janë rritur me teknologji rreth tyre, dhe mësuesit duhet të përshtaten me këtë mënyrë të nxënies, duke shfrytëzuar të gjitha format e saj në dobitë të procesit të mësimit, por dhe në aspektin motivues. Megjithatë për integrimin e teknologjisë flitet shumë, pak mësues kanë një vizion apo filozofi të qartë për mënyrën e integrimit të saj në kurrikul me qëllim rritjen e cilësisë së mësimit dhe të nxënies. Teknologjia e ndihmon nxënësin të zhvillojë të gjitha llojet e aftësive, nga ato më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat. Megjithatë, që teknologjia të jetë e suksesshme, mësuesi duhet të bëjë zgjedhje të informuara në lidhje me qasjen pedagogjike, nevojat e nxënies dhe rezultatet e të nxënies.

Qëllimi i këtij studimi është të zbulojë perceptimet e nxënësve për përdorimin e teknologjisë në mësimin e tyre në klasë dhe të tregojë se teknologjia ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve pasi ata ndjehen më të suksesshëm, më të motivuar për të mësuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim. Të kuptohet nevoja dhe rëndësia për përdorimin e teknologjisë në klasa, në lidhje me motivimin dhe gjithëpërfshirjen, dhe për të inkurajuar krijimin e një metode mësimit bazuar në të.

Studimi është bazuar në studime dhe teori të ndryshme. Metodologjia e përdorur në këtë punim është gërmimesh i asaj cilësore dhe sasimore. Në punim studiohet një shkollë e rrethit Tiranë. Subjekt i studimit janë 16 mësues dhe 43 nxënës të klasave fillore.

Nga ky studim rezulton se duke përdorur teknologjinë, mësuesit e kanë më të lehtë të përfshijnë nxënësit në aktivitetet mësimore. Dhe t'i motivojnë ata. Mësuesit mund të krijojnë aktivitete për nivele dhe stile të ndryshme të të nxënies si dhe mund të zgjerojnë gamën e informacioneve që janë në dispozicion të nxënies.

Fjalë kyçe: *teknologji, mësimit, motivim, sukses.*

VIZIONI DHE FILOZOFIA IME RRETH MODELIT TË NJË MËSIMDHËNIEJE PRODUKTIVE DHE EFIKASE.

Nina Pashako

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Email: *nina.pashako@univlora.edu.al*

Abstrakt: Punimi paraqet vizionin tim rreth një mësimdhënieje të suksesshme e frytdhënëse shihet gjerësisht, si fillim si art, si shkencë por edhe si mision. Ajo çfarë mësuesi përçon te nxënësi nuk ngelet vetëm në mendjen e një individi të caktuar, por në një të ardhme të familjes së tij, të komunitetit ku jeton dhe gjithë shoqërisë në përgjithësi. Duhet një kujdes dhe përgjegjshmëri shumë e madhe, e cila ose dëmton breza me radhë ose edukon dhe lartëson mendje të ndritura që të ecin përpara dhe t'i shërbejnë pse jo njerëzimit. Zgjedhja e modeleve të caktuara prej mësuesve është vendimtare për arritjet e nxënësve. Është me rëndësi që modelet të jenë të ndërtuara qartë. Me një strukturë të caktuar, kriteret të cilat duhet të përmbushen, objektiva të qarta dhe funksionale. Mësimdhënia duhet të përshtatet me mjedisin ku bëhet mësim, institucionin dhe të krijojë politikën që ndërtojnë një sistem të caktuar. Dalim në konkluzion se në bazë të këtij sistemi arrihet të nxënëti, dija e cila është universale dhe e pakufizuar. Mësuesi duhet të jetë vigjilent, përvojën e tij ta përcjellë me përgjigjësi te nxënësi.

Fjalët kyçe: *modele, mësimdhënie, përgjegjshmëri, arritje, nxënës.*

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM

Rainer Trashaj

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

E-mail: *rainertrashaj@gmail.com*

Abstrakt: Sot ka shumë nga ata që i ngrenë lart virtytet e përfshirjes së kompjuterave në veprimtaritë mësimore d.m.th. të mësimdhënies së përshkruar në teknologji. Multimedia, në të vërtetë krijon mjedise të pasura të të nxënësve. Studimi u përqëndrua në dy drejtime: te nxënësit dhe te mësuesit, dhe u mbështet mbi kërkimin sasior të realizuar nëpërmjet pyetësorëve me nxënës dhe mësues. Gjithashtu u përdor edhe metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë të orëve konkrete digjitale duke u përqëndruar jo vetëm te nxënësit, por sidomos te aftësitë e mësuesve në përgatitjen e orëve të tilla. Ky studim u realizua në shkollën 9-vjecare "Andon Xoxa" dhe në shkollën e mesme "Janaq Kilica" në Fier. Në studim u vu re se teknologjia digjitale ofron fleksibilitet për të plotësuar nevojat individuale të së cilit nxënës, i nxiste ata të provonin ide të reja për të zgjidhur probleme, motivonte dhe nxiste të nxënës, por sidomos nxiste nxënësit të punonin me projekte. Megjithatë, me gjithë investimet e mëdha të bëra në shkolla për instalimin e pajisjeve elektronike dhe të programeve, nxënësit e kalonin shumicën e ditëve të tyre në shkollë, sikur këto burime informacioni të mos ishin prezente. U evidentuan disa arsye se pse teknologjia shfrytëzohet pak në programet shkollore. Nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të ofruar numrin e duhur të kompjuterave personalë, për të blerë programe dhe për të ofruar asistencë për rrjetin. Nga ana tjetër jo të gjithë mësuesit i njohin mirë pajisjet elektronike dhe kanë përgatitje të mjaftueshme paraprake për t'i përdorur ato dhe tregojnë ankth në përdorimin e tyre. Prandaj, mendoj se nuk ka prova bindëse-hulumtuese se mësuesit mund të jenë më efikasë në mësimdhënien teknologjike. Nevojiten trajnime të gjithanshme dhe të vazhdueshme për ta.

Fjalë kyçe: *teknologji, edukim, nxënës, mësues, problem, trajnime.*

ROLI I MËSUESIT NË MOTIVIMIN E NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR

Remzie Capa

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë rolin kryesor që ka mësuesi në motivimin e nxënësit. çdo aktivitet në klasë është i lidhur me motivimin. Motivimi është ai i cili drejton, mbështet dhe nxit sjelljen e nxënësve, gjithashtu mbështet dhe përmirëson edhe arritjet akademike të tyre. Dhe është pikërisht mësuesi ai i cili me strategjitë, teknikat dhe aftësitë e tij arrin të realizojë motivimin e nxënësve. çdo nxënës ka aftësi për të mësuar, por është mësuesi ai i cili u jep atyre nxitjen dhe drejtimin e duhur në procesin e të nxënësit. Metoda e përdorur për të kryer këtë studim është ajo e një hulumtimi cilësor si dhe është shfrytëzuar literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë kam aplikuar intervistat dhe pyetësorët e mi drejtuar mësuesve dhe nxënësve në një shkollë publike të Durrësit, në shkollën “14 Nëntori”.

Nga analiza e të dhënave, rezultoi se ka përpjekje të vazhdueshme nga ana e mësuesve për të motivuar nxënësit, por jo në nivelin e dëshiruar. Po ashtu, nxënësit shprehen se ndihen të përfshirë në procesin e mësimnxënies.

Ky studim nxorri në pah mungesën e motivimit në disa veprimtari të caktuara të kryera në shkollë, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e mësuesit. Kjo për shkak edhe të mungesës së infrastrukturës e mjeteve të nevojshme që rrisin nivelin e motivimit të nxënësve.

Fjalë kyçe: *motivim, mësues, nxënës, klasë, arritje akademike.*

TË NXËNËT SI REZULTAT I PËRVETËSIMIT TË KURRIKULËS NË ARSIMIN FILLOR

Rezarta Torozhina Sefedini
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Abstrakt: Kompetenca “Të mësuarit për të nxënë”, është një nga kompetencat kyçe që përmban kurrikula e re e Arsimit fillor. Përvetësimi i kurrikulës është një nga tre elementët e kurrikulës krahas planifikimit dhe zbatimit të saj. Përvetësimi i kurrikulës reflektohet te të nxënërit e nxënësve.

Ky studim sjell refleksionet e kësaj çështjeje në shkollën “Vasil Ziu” në Durrës.

Metodologjia e ndjekur është cilësore. Intervistat me mësuesit, vëzhgimet e orientuara dhe perceptimet mbi rezultatet e përvetësimit të kurrikulës janë teknikat kryesore të përdorura.

Studimi arrin në përfundimin se përvetësimi i kurrikulës me bazë kompetencat nuk ka rezultate të larta në nivelin e njohjes dhe formimit në përgjithësi. Mësuesi has me shumë vështirësi teknike dhe shprehi kualitative për mësimdhënien e parashikuar. Nxënësit shpesh i mungojnë përvojat e nevojshme.

Mësuesit ndjehen më të ngarkuar dhe prindërit më të paqartë.

Fjalë kyç: *nxënës, mësues, kompetenca të mësuarit për të nxënë, përvetësim i kurrikulës*

TEKNIKAT EFEKTIVE NË KLASË

Rolanda Kadiu

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *rolandakadiu@gamil.com*

Abstakt: Menaxhimi i klasës është një temë shumë e gjerë dhe interesante për t’u studiuar. Menaxhimi është mënyra se si organizohet klasa dhe ai ndikon në të gjithë klimën e klasës dhe sjelljen e nxënësve. Ky trajtim teorik në këtë punim ,përfshin kriteret më themelore që ndërlidhen me menaxhimin e klasës, atribute të cilat duhet t’i posedojë dhe zbatojë cdo mësimsdhënës në shkollën e sotme. Studimi i tillë ka të bëjë me drejtimin e klasës formimin e grupeve, fillimin dhe përfundimin e mësimit, ekologjinë e klasave, klimën e klasës, motivimin e nxënësve, vetitë e mësimsdhënësit, komunikimi me nxënësit, mbajtja e disiplinës në klasë dhe trajtesa të tjera që të kuptojmë se çdo të thotë një menaxhimin efektiv i klasës dhe të identifikojmë se cilat janë teknikat që e bëjnë efektive organizimin e orës së mësimit.

Fjalë kyçe: *Menaxhim, mësimsdhënie, menaxhim efektiv, proces mësues, klima në klasë, disiplinë.*

NEW MEDIA IN TEACHING ENGLISH

Sajmir Ndrecaj

“Aleksandër Moisiu” University, Durrës

Abstract: This thesis aims to show the importance of the new media in teaching. Lately, new media is becoming a must in education. Virtual learning is known and accepted by almost everyone. Not only the students, pupils, or the teachers, but the government itself has given a strong focus to it.

However, we all know or proved as well that the new media has disfunctionalities as well. In order to prevent the later we have to optimize the learning process and to improve it.

To do so, it is important to analyze how people learn with computers and with the help of other technological devices. Another element that we should know from the use of new media in teaching is the expectations learners have from new media.

In Albania new media is used widely in teaching in different forms. This new media can be represented by CD-s, computer, head projector, or even interactive white - boards. For some years now in our country there are some pilot schools which use these “smart classes” where the lessons are done in digitalized books and each of the pupils has a computer in front of them.

In this context, we have to identify the importance of new media in learning process and how this “educational tool” helps students in developing the four skills of learning: speaking, listening, reading and writing.

Key words: *new media, technology, speaking, listening, read*

ZHVILLIMI I SHPREHIVE SOCIALE TË FËMIJËVE PARASHKOLLORË NËPËRMJET TEMATIKAVE MBI VENDLINDJEN

Sara Gjuzi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E- mail: *saragjuzi2@gmail.com*

Abstrakt: Arsimi parashkollor po përballet me zbatimin e kurrikulës së re. Formimi i kompetencave dhe shprehive sociale të fëmijëve të kësaj moshe, zhvillohen nëpërmjet veprimtarive interaktive. Ky punim trajton efektivitetin e veprimtarive me tematikë nga vendlindja në interaktivitetin, motivimin dhe përvetësimin e shprehive sociale.

Punimi u krye në kopshtin “28 Nëntori”, në Kavajë.

Metoda bazohet në vëzhgimin e orientuar sipas një chek-liste të parahartuar sipas treguesve të zhvillimit të shprehive sociale si bashkëveprimi, imitimi i modeleve kulturore, kujdesi për ambjentin dhe zbatimi i rregullave, etj. Intervistat me mësueset dhe drejtuesen e kopshtit plotësuan rezultatet e vëzhgimeve dhe interpretimeve të gjetjeve nga studimet shkencore.

Punimi provon se vendlindja përbën një material të pasur didaktik për sjelljen e përvojave jetësore të fëmijëve. Mbi këto tematika fëmijët bëhen më aktivë dhe performanca e mësuesit më efektive.

Punimi sjell edhe disa rekomandime për mësueset për organizimin e veprimtarive mësimore me fëmijët parashkollorë.

Fjalë kyç: *vendlindje, shprehi sociale, parashkollor, përvojë.*

NXËNËSI DHE MËSIMDHËNIA

Sonila Konomi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *sonilakonomi@gmail.com*

Abstrat: Mësuesi e ka shumë të qartë se mësime dhënë ndërvepruese dhe të nxënësve aktiv duhet të jenë pjesë përbërëse e punës së tij të përditshme. Mësime dhënë që i nxit nxënës të bëjnë pyetje e të kërkojnë përgjigje, t’i zbatojnë ato në zgjidhjen e problemeve, të dëgjojnë idetë e njëri-tjetrit, të debatojnë idetë është mësime dhënë më e frytshme. Është kjo lloj mësime dhënë që u shërben nxënësve në jetë. Shumë mësues po ndryshojnë praktikën e tyre të punës për të mbështetur zhvillimin e të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit. Dëshira është që nxënës të mos jetë një riprodhues i thjeshtë i materialit. Ai duhet të shqyrtojë, të krijojë, të interpretojë e të debatojë në lidhje me faktet, të dhënat, idetë e paraqitura në materialin përkatës. Kjo është një mësime dhënë gjatë të cilës nxënës është gjithë kohës aktiv e shumë i angazhuar për të bërë pyetje, për të kërkuar përgjigje e për të debatuar rreth ideve. Kjo quhet sot “mësime dhënë e mirë”. Mësimi aktiv qëndron në kundërshtim me mënyrat tradicionale të mësimit në të cilat nxënës janë përfitues pasivë të njohurive nga një mësues. Mësimi aktiv mund të ketë shumë forma dhe mund të zbatohet në çdo disiplinë. Zakonisht nxënës do të angazhohen në aktivitete të mëdha apo të vogla të lidhura me shkrimin, bisedën, zgjidhjen e problemeve të ndryshme ose me reflektimin. Të mësuarit aktiv është shumë tërheqës për nxënësin ndërkohë që të mësuarit tradicional, përveç të qenit jo interesant, i bën ata mekanikë, duke mësuar pasivisht ata nuk integrojnë mënyrat e tyre të të mësuarit që të ngulisin mirë në mendje atë që ata mësojnë. Nuk është e njëjtë dëshira e të mësuarit, ajo bie madje edhe mësuesi nuk merr reagimin e dëshiruar nga nxënës. Pra mësimi tradicional ku mësuesi thjesht referon njohuritë e reja pa përfshirë nxënësin nuk ka efektivitetin e një të mësuarit aktiv në themel të të cilit është bashkëpunimi mësues-nxënës.

Fjalë kyçe: *mësime dhënë ndërvepruese, të nxënësve aktiv, të menduarit kritik.*

RËNDËSIA E TRAJNIMEVE TË MËSUESVE PËR FËMIJËT ME AFTËSI NDRYSHE

Sonila Shena

Universiteti “ Aleksandër Mosiu” Durrës

E-mail: *sona_shena@hotmail.com*

Abstrakt: Ky studim trajton rëndësinë që kanë trajnimet për zhvillimin profesional të mësuesve që edukojnë nxënësit me aftësi ndryshe. Çdo fëmijë ka karakteristika, interesa, aftësi dhe nevoja specifike për të mësuar dhe fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën për të mësuar në shkolla të zakonshme, të cilat duhet t'i ofrojnë atyre një mësimdhënie bashkëkohore.

Qëllimi i këtij punimi është njohja me vendin që zënë trajnimet e mësuesve dhe rëndësinë që kanë ato në përmirësimin cilësor të mësimdhënies dhe zbatimit të kurrikulës së re me bazë kompetencat në procesin mësimor. Të zbulojë praktikat më të mira si dhe mangësitë që paraqesin mësuesit përball punës së tyre të përditshme me qëllim përmirësimin e tyre. Gjithashtu të nxjerrë në pah mangësitë ose nevojat të cilat shqetësojnë mësuesit, për t'ua paraqitur specialistëve, hartuesve të programeve dhe qendrave trajnuese, me qëllim marrjen parasysh të vështirësive dhe sfidave që kanë mësuesit e rinj dhe përgatitjen e tyre në përballimin e mësimdhënies me bazë kompetencat për nxënësit me aftësi ndryshe.

Kampioni i studimit përbëhet nga 40 mësues të arsimit 9-vjeçar në rrethin e Durrësit, të cilët u zgjodhën në mënyrë rastësore. Bëra një përpjekje përmes kërkimit sasior dhe cilësor, nëpërmjet intervistave, pyetësorë, vëzhgimeve me mësues e drejtues shkolle. Studimi nxorri në pah sfidat dhe vështirësitë e shumta me të cilat përballen mësuesit. Gjithashtu u vu theksi në mangësinë e trajnimeve të mësuesve në përmirësimin e edukimit tek nxënësit me aftësi ndryshe, numri i lartë i nxënësve në klasë, mungesa e infrastrukturës, mungesa e mjeteve didaktike etj.

Ky punim ka një rëndësi të veçantë pasi do t'ju shërbejë drejtuesve të institucioneve arsimore, mësuesve të shkollave, për rëndësinë e madhe që kanë trajnimet, për të lehtësuar dhe zbatuar sa më efektivisht planin PEI.

Fjalë kyçe: *trajtime, mësues, plani PEI, nxënës me AN.*

MENAXHIMI I SJELLJEVE PROBLEMATIKE TË NXËNËSVE NË KLASË

Sonja Likaj

Universiteti “ Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: sonjalikaj@outlook.com

Abstrakt: Për vite me rradhë, kuptimi i mësimdhënies mbi menaxhimin e klasës ishte rrënjësor në teoritë e mënyrës se si duhet të sillen dhe të mësojnë nxënësit në klasë. Theksi kryesor për menaxhimin e klasës ishin modelet pozitive, përdorimi i teknikave që sjellin kontrollin mbi veprimet e nxënësve, qoftë dhe duke i ndëshkuar ato në rast të sjelljes së gabuar. Këto qasje të sjelljes në menaxhimin e klasës janë në përputhje me një qasje "tradicionale", ku në qendër të mësimdhënies ishte mësuesi. Gjatë dekadës së fundit, pikëpamjet kanë ndryshuar. Tani mësuesit janë të inkurajuar të zbatojnë një qasje mësimore të bazuar në parimet konstruktiviste të të nxënësve, ku në qendër të mësimdhënies është nxënësi dhe të investosh në krijimin e një fëmije së pari si një individ më i mirë për shoqërinë, dhe si një e mirë që duhet pranuar nga të gjithë ne.

Qëllimi i këtij studimi është të kuptuarit e perceptimeve të mësuesve mbi sjelljen problematike të nxënësve dhe metodat të cilat përdorin për të menaxhuar klasën, për të arritur gjithëpërfshirjen e tyre, është e dobishme për të parë besimet dhe praktikën e menaxhimit të përdorura në klasë. Të kuptohet rëndësia e zbatimit të praktikave të larmishme, në bazë të situatës, pa e demotivuar nxënësin. Në këtë studim ka tre fokus grupe, grupin e mësuesve, grupin e prindërve dhe atë të nxënësve. Prindërit shpesh herë përfshihen në situata të pakëndshme që ndodhin mes mësuesit dhe nxënësit, duke e aprovuar ose jo mënyrën e menaxhimit nga ana e mësuesit. Prandaj përfshirja e tyre në studim do të jepte të dhëna të rëndësishme për mësuesit në përzgjedhjen e metodave sa më efektive për pakësimin dhe menaxhimin e sjelljeve të padëruara të nxënësve.

Shpjegimi i termave kryesorë është bazuar në një literaturë të larmishme dhe në teori e studime të ndryshme, kryesisht në teoritë që kanë mësimdhënien më në qendër nxënësit. Autorë të ndryshëm kanë përdorur strategji të ndryshme për të përshkruar sjelljet problematike të nxënësve dhe mënyrën si duhen menaxhuar ato, që të përmbushen të gjitha objektivat e vëna. Për realizimin e këtij studimi është përdorur metoda cilësore e përpunimit të të dhënave. Ky studim është realizuar nëpërmjet këtyre instrumentave matës: - intervista me mësuesit; - pyetësorë për prindërit dhe nxënësit; - vëzhgime të drejtëpërdrejta. Janë përfshirë 15 mësues, 12 nxënës dhe 11 prindër. Rezultatet e studimit tregojnë se angazhimi dhe ndërhyrja me kohë ndaj këtij qëndrimi, bën reduktimin e ndikimit të faktorit që prodhon stres dhe menjaherë drejt transformimit në një sjellje të mirë dhe pozitive.

Fjalë kyçe: *menaxhimi i klasës, metoda mësimdhënie, gjithëpërfshirje, mësimdhënie në qendër nxënësit.*

ROLI I DREJTUESIT TË SHKOLLËS DHE NDIKIMI I TIJ NË REZULTATET AKADEMIKE

Taulant Sula

Email : *taulantsula94@gmail.com*

Abstrakti: Shkollat Shqiptare kanë një traditë disa dhjetra-vjeçare. Që nga shkollat e para, deri në ditët e sotme, shkollat janë përballur me mjaftë sfida. Këto sfida kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rezultatet dhe ecurinë e shkollave. Jo pak herë këto sfida kanë qenë aq të vështira, sa zgjidhja duhej bërë me gjakun e pastër të bijëve të këtij populli. Më vonë deri në ditët e sotme kemi shumë probleme me kushtet e shkollave, mjetet logjistike edhe deri në mbërritjen dhe kthimin e stafit pedagogjik e nxënësve në shkolla nëpër rrugë të cilat nuk plotësojnë asnjë kriter për tu quajtur rrugë. Në këto sfida peshën më të madhe e kanë pasur dhe e kanë udhëheqësit e shkollave të cilët kanë në dorë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e këtij vendi. Për meritë dhe për gabimet e tyre, arsimit në Shqipëri ndodhet në këtë gjendje që disa i thurin elozhe duke e krahasuar me vendet e Europës Perëndimore por edhe më në perëndim, me SHBA-në. Por ka edhe të tjerë që mendojnë se shkolla shqiptare ka përënduar edhe është duke u përpëlitur, duke dhënë shpirt ose më saktë duke ja bllokuar frymën me eksperimente edhe pseudo-reforma të cilat kanë pasur vetëm qëllime klienteliste për tu pasuruar një grup njerëzish me vlera monetare edhe jo një shtet të tërë me dije. Ku akoma nuk është zhdukur kjo farë, jam i bindur se ka shpresë që arsimit do të shkojë aty ku i takon një shteti demokratik edhe të pavarur. Këtë punë duhet dhe mundë ta bëjnë drejtuesit e institucioneve të arsimit duke filluar nga drejtori i një kopshti ose çerdheje duke kaluar tek institucionet që prodhojnë mësimdhënës, te Ministria e Arsimit dhe e Sporteve deri tek Presidenti dhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë. Ka shumë njerëz që kanë aftësitë për të drejtuar këto institucione dhe ta dërgojnë arsimin aty ku i takon. Ky studim që unë kam përgatitur do ti vlejë sadopak të gjithë drejtuesve aktualë dhe atyre që kanë dëshirë të vijnë më vonë në Arsim, ku njëri prej tyre jam edhe unë, një ndër arsytet se përse zgjedha këtë temë. Ky studim është përgatitur duke studiuar e përzgjidhur studime bashkëkohore shqiptare dhe të huaja por edhe duke bashkëbiseduar me njerëz që punojnë apo kanë punuar në arsim. Në këtë studim është përdorur një pyetësor i përgatitur dhe është aplikuar për herë të parë nga unë.

Fjalë kyçe: *edukim, shkollë, drejtori i shkollës*

RËNDËSIA E GJUHËS ANGLEZE NË FUSHËN E EDUKIMIT

Urjola Bostani

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: olab2000@hotmail.com

Abstrakt: “Gjuha është burimi primar i komunikimit dhe nëse ke njohuri në Gjuhën Angleze mund t’ia dalësh mbanë në të gjithë botën” dëgjon kurdo dhe kudo. Gjuha angleze, gjuha e përmasave botërore dhe dominuese, përdoret si gjuhë e dytë dhe zyrtare në shumë shtete të botës. Në bazë të studimeve dhe kërkimeve të ndryshme të realizuara, ka rezultuar se ajo është gjuha që mësohet dhe kuptohet më shumë në botë, duke u cilësuar madje edhe si “gjuha e tregtisë, arsimit, shkencës dhe diplomacisë”. Është një gjuhë e pranuar globalisht dhe e ditur nga të gjithë.

Anglishtja është thelbësore në fushën e edukimit. Shkolla është mjedisi ideal ku fëmijët kanë përjasjen e parë me këtë gjuhë. Ashtu sikurse edhe në shumë shtete të ndryshme të botës edhe në Shqipëri, fëmijët mësohen dhe inkurajohen për të mësuar anglishten si gjuhë të dytë. Në shkollën 9-vjeçare publike “Kristaq Shtëmbari” në rrethin e Fierit, është bërë një studim mbështetur mbi kërkimin sasior dhe cilësor të realizuar mbi bazën e disa pyetësorëve të bërë me nxënës, prindër dhe mësues, dhe intervistave me mësues që japin lëndën e gjuhës angleze. Nga rezultatet e studimit u vu re se lënda e gjuhës së huaj angleze luan një rol bazik, esencial, zotërues në formimin e personalitetit dhe intelektit të fëmijëve. Kjo pasi çdo gjë që na rrethon lidhet shumë ngushtë me anglishten. Media, përdorimi gjithmonë e në masë i teknologjisë, muzika, disa nga dëfrimet e fëmijëve (badminton, tennis, board games, American football, Ludoking etc), shfaqje televizive, filma, dhe mbi të gjitha përdorimi i rrjeteve sociale janë favorizuesit më të mëdhenj të zhvillimit, absorbimit dhe përdorimit të kësaj gjuhe. Mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në përhapjen dhe përmirësimin e njohurive socio-linguistike. Prindërit janë një mbështetje shumë e madhe dhe japin kontributin e tyre të paçmuar në vijueshmërinë e studimeve nga ana e fëmijëve të tyre.

Shkolla i kushton një vëmendje shumë të veçantë zhvillimit cilësor të orëve mësimore dhe plotësimit të kushteve edukative-mësimore për një mbarëvajtje sa më efikase dhe produktive, pasi prekja e kësaj gjuhe të fuqishme është evidente në çdo fushë hulumtimi dhe studimi.

Të rinjtë tashmë janë ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e të mësuarit të gjuhës angleze si e vetmja gjuhë e përbashkët në ndërveprimin ndërkombëtar e cila do t’i ndihmojë ata për të kuptuar, shfrytëzuar mundësi dhe horizonte të reja në jetë dhe për të komunikuar me njerëzit e shteteve të ndryshme, e jo vetëm nga shtetet anglisht-folëse.

Duke folur ndërkombëtarisht, pa ditur, kuptuar dhe folur anglishten, do të ishte tepër e vështirë që të krijohej një botë e paqte, e qetë, e përgjegjshme në aspektin moral dhe etik, e barabartë dhe tolerante.

Fjale kyçe: *gjuha angleze, komunikim, globalizim, ndërkombëtarisht, esencial, dominues, formim i personalitetit*

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM

Valbona Peshku

Email: *bona.peshku1@gmail.com*

Abstrakt: Në shoqërinë e sotme, një evoluim të madh e të zgjeruar ka marrë përdorimi i teknologjisë në edukim e mësimdhënie. Përdorimi i këtyre metodave nxit të menduarit kritik, rrit nivelin e përqëndrimit të nxënësit dhe e bën më efikase orën e mësimi. Komunikimi dhe bashkëpunimi është mjaft i rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Në kryerjen e detyrave të ndryshme ku lind nevoja e përdorimit të TIK-ut, nxënësit punojnë në grupe me njëri-tjetrin, por edhe me faktorët e jashtëm si prindërit apo ekspertë të tjerë në këtë fushë. Të gjithë nxënësit duhet të jenë aktivë, të pyesin e të përgjigjen gjatë orës së mësimi. Por shpesh ndodh që në këto detyra, nxënësit e marrin materialin e gatshëm nga interneti, pa e përpunuar atë.

Për mbarëvajtjen e procesit mësimor – edukativ duhet: 1- *Planifikim dhe strukturim*, 2- *Një klimë pozitive në klasë*, 3- *Bashkëpunimi i nxënësve me njëri-tjetër*.

Përdorimi i teknologjisë i tërheq më tepër nxënësit, i krijon lehtësi në organizim dhe u krijon mundësinë që të jenë bashkëkohorë. Gjatë orës së mësimi përdoret: *CD, internet, kompjuter, USB, tabela interaktive, video projektor* etj.

Përdorimi i teknologjisë kompjuterike sjell vetëvlerësim dhe kënaqësi, prandaj duhet të jetë pjesë e detyrave të dhëna.

Fjalë kyçe: Teknologji, mësimdhënie, edukim, bashkëpunim, mendim kritik

HULUMTIM MBI ZBATUESHMËRINË NË VLERËSIMIN E VAZHDUAR

Silvana Jaupaj & KozetaLlane

E-mail: *llanekozeta@gmail.com*

E-mail *silvanajaupaj@gmail.com*

Abstrakt: Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet vlerësim formues dhe është vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Ky lloj vlerësimi mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë. Në ndryshimet e vazhdueshme të kurrikulare vlerësimi i nxënësve ka rrjedhën e ndryshimeve të veta historike, që shpesh shoqërohen me ndryshime të instrumenteve matëse. Cdo punë meriton të vlerësohet mes treguesve të testuar më parë. Vlerësimi për të nxënë ndihmon mësuesin të planifikojë punën për të zhvilluar mësimin në mënyrë më efektive. Shpesh ky vlerësim është informal dhe nxënësit mund të mbajnë edhe vetë shënime mbi progresin e tyre. Ky lloj vlerësimi realizon më se miri bashkëpunimin mësues-nxënës dhe krijon klimë miqësore në klasë. Mes hulumtimeve në klasat e arsimit fillor në Qarkun e Vlorës do të sjellim një panoram të vlerësimeve në shkolla të ndryshme dhe japim një ndihmesë konkrete në zbatueshmërinë e realizimin e duhur të këtij vlerësimi duke pasqyruar ndryshimin kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re. Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënë (vlerësimit të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënësit e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar. Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë te nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i përmirësojë ato.

Fjalë kyçe: *vlerësimi i nxënësve, kurrikulë, vlerësim i vazhduar*

SIGURIMI I MËSIMDHËNIES CILËSORE NËPËRMJET SHËRBIMEVE KOMUNITARE

Violeta Manjani

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Email: violeta.manjani@yahoo.com

Abstrakt: Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e shërbimeve komunitare në cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë. Shërbimet komunitare në shkolla janë një nga pikat kryesore që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies. Është një dimension i rëndësishëm i reformimit të mësimdhënies dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Krijon mundësinë e vlerësimit të punës së shkollës në lidhje me bashkëpunimin shkollë-familje-komunitet dhe mbi këtë bazë, hartimin e strategjive që mbështesin ngritjen e një modeli të shkollës komunitare, përmes bashkëpunimit me të gjithë aktorët. Në varësi të temave të mësimin në bazë të aktiviteteve mësimore ky shërbim është një veprimtari konkrete e kryer nga nxënësit jashtë orarit mësimor pa shpërblim financiar në dobi të njerëzve në nevojë, komunitetit, si dhe shërbimeve sociale me shtresa të ndryshme shoqërore etj.

Synimi i këtij studimi ka si fokus forcimin e përgjegjësive të nxënësit si individ i një komuniteti. Shërbimi në komunitet si aktivitet mësimor ndihmon në arritjen e këtyre objektivave: ndërgjegjësimin e nxënësve për nevojat në komunitet, si dhe të informojë nxënësit rreth përpjekjeve për kujdesin social. Metoda e përdorur në këtë punim, është metoda sasore si dhe shqyrtimi i gjerë i literaturës. U përdorën pyetësor në disa shkolla të qytetit të Durrësit ku në fokus qëndron rëndësia e këtyre shërbimeve dhe përfitimet që kanë nxënësit gjatë zhvillimit të këtyre veprimtarive në komunitet. Rezultatet e këtij studimi nxorën në pah impaktin pozitiv nga nxënësit e shkollave. Me anë të këtij studimi, dolëm në përfundimin se shkollat kishin rol kyç në zhvillimin e veprimtarive në komunitet. Nxënësit kishin përfitime të shumta nga shërbimi në komunitet. Kjo gjë ndikonte në përmirësimin e rezultateve në mësim dhe ndikimet e veprimtarive zhvillonin shumë nxënien. Gjithashtu edhe në forcimin e marrëdhënieve të reja duke njohur realitetin, theksuar më së shumti socializimin e nxënësve.

Fjalë kyçe: shkollë, komunitet, mësimdhënie, socializim, shërbim.cilësi.

METODAT BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES DHE ROLI I MËSUESIT NË PËRDORIMIN E TYRE

Vjollca Qevani

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

E-mail: qevani.v@gmail.com

Abstrakt: Tema e këtij studimi lidhet me perceptimin e mësuesve të arsimit fillor mbi metodat bashkëkohore të mësimit në klasat e arsimit fillor. Synimi i studimit është të hulumtojë si mësuesit i perceptojnë metodat e mësimit dhe si procedojnë ato gjatë procesit mësimor. Forma kërkimore e ndjekur në këtë studim është intervista.

Metodologjia e përdorur është metoda cilësore, duke përdorur teknikat e intervistimit me anë të intervistave gjysëm të strukturuar dhe vëzhgimin në ambientet e klasave ku zhvillohej mësimi. Popullata e këtij studimi ishin mësues të arsimit fillor, të shkollave publike 9-vjeçare të klasave të para, të dyta dhe të treta, që janë në periferi të qytetit të Durrësit.

Intervista ishte planifikuar me 50 mësues, por një pjesë e madhe e tyre nuk e ofruan mbështetjen dhe gatishmërinë për t'u përfshirë në këtë studim. Kështu që kampioni i këtij studimi u bënë vetëm 29 mësues që iu përgjigjën procesit të intervistimit. Si instrument kërkimor u aplikua intervista e cila përmbante 5 pyetje të hapura me nga një nën-pyetje secila

Nga gjetjet kërkimore nuk rezultoi ndonjë marrëdhënie e fortë (e drejtpërdrejtë) midis qëndrimeve të mësuesve dhe variablave demografikë si gjini, moshë, vite pune dhe kualifikim, ndonëse nga përgjigjet e zgjeruara të mësuesve u eksploruan gjetje interesante nga terreni kërkimor, që nxisin studimet e tjera në këtë fushë.

Fjalët kyçe: mësimit tradicionale, mësimit me në qendër nxënësin, përfshirje, rezultat.

ETIKA PROFESIONALE E MËSUESIT BURIM I LARTËSIMIT TË PERFORMANCES SË MËSUESIT

Vullnet Dauti

Universiteti “AleksandërMoisiu”, Durrës

E- mail: *netidauti148@gmail.com*

Abstrakt: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka bërë përpjekje për të përcaktuar disa norma bazë etike, që rregullojnë ushtrimin e profesionit të edukatorit, mësuesit, dhe specialistëve të cilët punojnë në institucionet arsimore. Kodi i etikës së profesionit të mësuesit mbështetet në frymën e legjialacionit për arsimin në Republikën e Shqipërisë.

Kodi i etikës së mësuesit trajtohet i lidhur ngushtë me përfshirjen sa më të gjerë të prindërve, nxënësve dhe komunitetit për të ndërtuar një figurë bashkëkohore të tij.

Ky punim provon se etika në sistemin arsimor është trajtuar e lidhur ngushtësisht me përmirësimin e mësimdhënies së mësuesve të arsimit fillor në shkollat e Dibrës.

Studimi është fokusuar në qëndrimin e mësuesve ndaj profesionit dhe ndaj modeleve mësimore, në komunikimin emocional, në etikën e vlerësimit, në udhëheqjen etike të shkollës etj.

Metodologjia e punimit bazohet në biseda, pyetësorë, intervista dhe vëzhgime në dy shkolla në qytetin e Peshkopisë dhe pesë shkolla në zonat rurale të Dibrës.

Studimi arriti në përfundimin se mësuesit më efektivë në shkollë, demonstronjë një nivel më të lartë të respektimit dhe zbatimit të kodit të etikës profesionale.

Ky përfundim provohet edhe në performancën e drejtorëve efektivë.

Punimi jep edhe disa rekomandime për mësuesit, drejtuesit dhe specialistët e arsimit në DAR Dibër.

Fjalë Kyçe: *etikë profesionale, performanca e mësuesit, qëndrime etike dhe jo etike.*

LIFE LONG LEARNING

Xhensila Alla

“Aleksandër Moisiu” University, Durrës

Email: *allaxhensila5@gmail.com*

Abstract: The concept of lifelong learning has become one of the most widely discussed concepts in the field of adult education. Lifelong learning is about acquiring and updating all kinds of abilities, interests, knowledge and qualifications from the pre-school years to post retirement which promotes the development of knowledge and competences that will enable adaptation to the knowledge-based society and also valuing all forms of learning. It is the broad term for education that is conducted beyond school. Therefore it's voluntary, rather than compulsory, and is completely self-motivated – with the main goal being to improve personal or professional development.

This paper examines the scope of the field of lifelong learning, covering definitions and exploring conceptual frameworks and theories that support lifelong learning. Our world is changing around us in such a frantic pace that if we do not continue to grow and develop; we will soon be left behind. Lifelong learning is an essential challenge for inventing the future of our societies; it is a necessity rather than a possibility or a luxury to be considered. Three objectives of this paper are: first, to clarify the concept of lifelong learning; second, to characterize its different types; and third, to focus on the benefits of lifelong learning and its importance.

Key words: *lifelong learning, education, knowledge.*

SHKALLA E PARË DHE SHKALLA E DYTË SIPAS KORNIZËS KURRIKULARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Xhilda Kodra

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

E-mail: *xhilda.kodra0807@gmail.com*

Abstrakt: Ky punim ka si qëllim parësor që të shohim sesi realizohet Shkalla e parë dhe Shkalla e dytë sipas kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë. Në shkallën e parë përfshihen klasat përgatitore, klasa e I dhe klasa e II, ku në të cilën vendosen bazat për të nxënës të sistematik. Ndërsa në shkallën e dytë përfshihet klasa e III, klasa e IV dhe klasa e V, ku vendoset përforcimi I bazave në lexim, shkrim, komunikim dhe teknika në të nxënë gjithashtu edhe si bazë për zhvillim të mëtejshëm. Këto dy shkalla e ndihmon një mësues që të ketë kritere të qarta që dëshiron të arrijë në një kompetencë të caktuar si edhe kriter vlerësimi sipas pesë niveleve të arritjes së njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që demonstroi çdo nxënës. Nxënësit janë të ndryshëm dhe rrjedhimisht kanë zhvillim inteligjence të ndryshme. Në çdo orë mësimore mësuesi përcakton kompetencat që do të arrihen në çdo lëndë, ku çdo kompetencë ka të përcaktuar arritjet e nxënësve sipas niveleve në të nxënë. Në qëndër të zhvillimit të mësimdhënies vendoset nxënësi dhe bashkëpunimi I tij me të tjerët për të arritur rezultate. Kjo formë e ndihmon mësuesin të jetë i aftë të dallojë nivelin e arritjes të çdo nxënësi. Në këtë mënyrë mësuesi e ndihmon nxënësin në kapërcimin e vështirësive dhe pengesave në të nxënë dhe që të mbajë qëndrime kritike. Sipas intervistave të zhvilluara në shkollat të ndryshme u vu re që shkalla e parë dhe shkalla e dytë realizohet përgjatë gjithë vitit dhe në fund përcaktohet niveli I arritjes së nxënësit. Në përfundimin e klasës së V nxënësit fitojnë aftësi, njohuri, qëndrime, vlera të cilat përvetësohen përmes detyrave krijuese dhe mbajnë qëndrim kritik ndaj zgjidhjes së problemeve.

Fjalë kyçe: *shkalla e parë, shkalla e dytë, kornizë kurrikulare, kompetencë, mësimdhënie, rezultate.*

ROLI I MËSUESIT NË PROCESIN MËSIMOR

Xhulja Saraçi

Sidorela Saraçi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *xhulja.saraci@outlook.com*

E-mail: *sidorelasaraci@outlook.com*

Abstrakti: Në kushtet e sotme të zhvillimit të vrullshëm të shoqërisë shqiptare metodat tradicionale të mësimdhënies me në qendër mësuesin nuk mund t’i përgjigjeshin kërkesave të nxënësit. Kështu, për t’i përmbushur këto nevoja të nxënësit, mësuesi nuk qëndron më vetëm në rolin e dhënësit të informacionit. Punimi synon të trajtojë rolin e mësuesit në procesin mësimor, sicc është mësuesi në rolin udhëheqës, inkurajues, mirëkuptues, vëzhgues, bashkëpunues, orientues, lehtësues, liberal, përkujdesës, etj. Secili rol i siguron mësuesit një larmishmëri metodash të cilat e ndihmojnë atë të jetë më pranë nxënësit dhe në ndihmë të tij.

Gjithashtu, punimi paraqet sfidat dhe përfitimet e mësuesit ndaj përdorimit të metodave të reja në mësimdhënie. Do të nxjerrim në pah pasiguritë e mësuesit në mësimdhënie si pasojë e këtyre ndryshimeve, por nga ana tjetër do të shohim përfitimet që kanë mësuesit ndaj ndryshimeve të tilla. Ky punim jep një paraqitje teorike, praktike dhe analitike të rolit të mësuesit në arsim. Për të kuptuar këtë rol, është e rëndësishme të shihet edhe konteksti shoqëror, si dhe qasja e mësuesit dhe e nxënësit ndaj këtij konteksti.

Fjalët kyçe: mësuesi bashkëkohorë, metodat e reja, sfidat dhe problemet, mësimdhënie

KOMUNIKIMI MËSUES – NXËNËS - PRIND DHE TË NXËNËT EFEKTIV NË KLASË

Xhuljana Topuzi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *xhulitopuzi07@gmail.com*

Abstrakt : Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i marëdhënies dhe i komunikimit mësues-nxënës-prind. Studimi i përket tipit të një gjykimi thelbësor ashtu edhe sipërfaqësor. Studimi përdor një qasje sasiore për të mbledhur sa më shumë të dhëna dhe për të marrë të treja perceptimet. Përkushtimi ndaj kësaj teme ndihmoi në grumbullimin e të dhënave nga një numër i madh informacionesh, librash pedagogjikë dhe historikë. Vështrimi mbi çështjet historike na ndihmon ne të kujtojmë dhe rivlerësojmë marëdhënien mësues-prind-nxënës. Një marëdhënie tepër dinamike, me shumë probleme por dhe pozitivitet. Duke parë se me sa luftë dhe mundim të parët tanë kanë arritur të na japin ne atë çka ne kemi sot, na vëne përpara një përgjegjësie jo fort të thjeshtë. Hapja e shkollave të para me aq mund si edhe etja për sado pak dituri që nga më të vegjëlit e deri te të rritur, na bën ne të ndihemi si zhvlerësues dhe shpërfillës ndaj gjakut të tyre. Megjithatë koha sot ka ndryshuar, ashtu sic ka ndryshuar dhe vetë raporti mesues- prinder -nxënës. Nëse dje nxënësit qoftë me dhune, frikë apo dëshirë shpërfaqnin një respekt të thelle dhe të pacënueshëm për mësuesin, sot nuk është më kështu. Sot mësuesi duhet të luftojë që ta fitojë këtë respekt tek nxënësi. E nëse ndodh e kundërta atëherë asnjëra palë nuk i rezervohet tjetrës. Studimi u realizua në periudhën tetor-shkurt 2019, në shkollat : Haki Stermilli (fshat), Demir Gashi (qytet) të Dibrës, përkatësisht 50 mësues, 70 prindër dhe 100 nxënës. Studimi përqëndrohet në metodën sasiore për të pasur të dhëna më të qarta lidhur me përfundimin e nxjerrë. Nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga ky studim mendoj se do të shërbejnë si një fillesë e mirë, për të nxitur trekëndëshin në komunikim prindër, mësues, nxënës dhe për të përmirësuar cilësinë e shkollës. Gjithashtu të dhënat dhe gjetjet e studimit do i shërbenin institucioneve drejtuese si DAR në rritjen e cilësisë së bashkëpunimit prindër, mësues, nxënës. Duke marrë shkas edhe nga përfundimi i studimit, tashmë kam ide më të konsoliduara se vetëm nëpërmjet komunikimit, shumë shpejt ndryshimi do të vijë dhe ky do të jetë çelësi kyç i suksesit.

Fjalë kyçe: *Komunikimi bashkëpunimi mësues-prind, Komunikimi bashkëpunimi prindër-nxënës, Komunikimi bashkëpunimi prind-mësues, mësimdhënie afatgjatë*

RËNDËSIA E ELEMENTËVE PARATEKSTUALË NË ROMANIN “HANA” NGA ELVIRA DONES

Enxhi Hasa

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *booklovers_albania@outlook.com*

Abstrakt: Gjatë analizës së një vepre letrare, duhet të marrim parasysh edhe elementë të tjerë që në pamje të parë mund të duken sikur nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë dhe me karakter jashtëtekstor, por që në fakt janë elementë që krijojnë njëfarë pritshmërie dhe parashikimi të lexuesi, dukeqënëse janë ato me të cilat lexuesi përballet në prezantimin dhe njohjen e parë me një tekst.

Në teorinë letrare këto elementë njihen si elementë paratekstualë dhe cilësohen si pragu i interpretimit të veprës letrare, duke treguar gjithashtu lidhjen me tekstin.

Elementët para dhe pas tekstualë mund t'i konsiderojmë si një mbulesë shoqëruese të librit, duke përfshirë titullin, kopertinën, epitekstin, informacionin e hapjes, parathënien, shënimet, renditjen e kapitujve si edhe shumë materiale të tjera.

Në romanin “Hana” autorja është kujdesur që çdo element të ketë lidhje me tekstin në vetvete. Elementët paratekstualë arrijnë të lidhen më së miri me atë çka romani përcjell, duke dëshmuar se janë të zgjedhur me kujdes dhe se autorja i ka dhënë rëndësi, duke dashur të sjellë te lexuesi idenë e romanit që në përballjen e tij të parë me librin.

Fjalë kyçe: *Paratekst, epitekst, letërsi bashkëkohore, interpretim.*

**VEÇORITË STILISTIKE DHE GJUHËSORE NË VËLLIMET POETIKE
“NË RRUGË DOLA” DHE “HAPAT E MIA MBI ASFALT”
TË POETIT DRITËRO AGOLLI**

Irisa Lleshi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *Irisa.lleshi@hotmail.com*

Abstrakt: Objekti i këtij studimi do të jenë veçoritë stilistike dhe gjuhësore të vëllimeve poetike “Në rrugë dola” dhe “Hapat e mia në asfalt”, të poetit Dritëro Agolli. Analiza do të fokusohet tek shprehjet gjuhësore dhe ndikimi i tyre në stilin e poetit. Duke përdorur metodën përshkruese do të listoj risitë që solli Agolli në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit të XX. Përdorimi i figuracionit letrar dhe përzgjedhja e gjuhës duken mjaft qartë në këto poezi. Gjuha e pastër shqipe e cila shpesh gërshetohet me dialektin toskë e bën poetin mjaft të dashur dhe të kuptueshëm për lexuesin. Përtëritja që solli Agolli në vjershërim duke mjaft qartë në këto dy vëllime. Vargu i përdorur dhe rimat që poeti sjell janë veçori të poetit ndaj dhe kam zgjedhur ti trajtoj. Në punimin tim kam trajtuar edhe pikëlidhjet mes vëllimeve poetike dhe poezisë popullore, sa është ndikuar Agolli nga vargu popullor shqipëtar, si ka arritur të sjell një poezi aq të ngjashme dhe të ndryshme nga krijimtaria popullore.

Fjalë kyçe: *gjuha, stili, temat, veçoritë.*

TEMA E LIRISË DHE ATDHEUT NË VËLLIMET POETIKE “SHTIGJE POETIKE” DHE “POEMA DHE VJERSHA” TË AUTORIT FATOS ARAPI

Erinda Shehu

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *erindashehu@icloud.com*

Abstrakt: Atdheu dhe liria kanë qenë objekt shkrimi për shumë shkrimtarë por tashmë nën hijen e penës herë triumfuese, herë kryengritëse, herë të zhgënjyer e herë shpërthyesë të Fatos Arapit ato fitojnë një pamje të re. Në këtë punim synohet dhënia e interpretimeve specifike bazuar në temën e lirisë edhe atë të atdheut, këndvështrimi i rilidhur me nacionalen dhe ballafaqimi i botëkuptimit të kohës me karakterin kontrovers të poezisë së Arapit. Nëpërmjet analizës së teksteve poetike "Shtigje poetike" dhe "Poema dhe Vjersha", synohet identifikimi i tipareve të veçanta, gjuha e përdorur, elementët e përcaktuar, qofshin ato të mbuluara nga petku i filozofisë ose edhe ato që janë lehtësisht të evidentushme. Punimi fokusohet në poezi specifike dhe parashtrimi i një vizioni personal novativ, i cili lind nga përjetimi i realitetit e që ndërthuret me kulturën dhe historinë për të krijuar një tablo të përgjithshme, herë-herë dramatike.

Fjalët kyç: *atdhe, triumf, zhgënjim, liri, histori, realitet.*

TRADICIONALIA NË SUBJEKTIN E KOMEDISË “KATRËMBËDHJETË VJEC DHËNDËRR” TË A. Z. ÇAJUPI

Aldo Mustafa

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *aldomustafa96@gmail.com*

Abstrakt: Kërkimi shkencor në fushën e edukimit vjen si nevojë dhe kërkon përpunim, vlerësim dhe rivlerësim të materialeve të ndryshme letrare dhe kërkimore. Rimarrja e materialeve me vlera në letërsi dhe materialeve të cilave u ka munguar hulumtimi, sjell në vëmendje dhe në optikën e studiuesve veprat artistike që duhen vlerësuar më shumë. Në këtë optikë, rimarrja e komedisë së vjershëruar të poetit dhe dramaturgut Andon Zako Çajupi, kthen kërkimin shkencor drejt një zhaneri të veçantë dhe jo shumë të trajtuar në fushën e letërsisë. Elementi tradicional në këtë komedi trajtimi i dokeve, traditës, kulturës dhe gjuhës tipike tradicionale, përbën interes jo vetëm në fushën e gjuhës, letërsisë, antropologjisë por edhe në atë të trashëgimisë kulturore, pasi vepra na shërben një pamje të një periudhe ndryshe, larg të sotmes. Sjellja në kujtesë e traditës, i vendos theksin më shumë këtij elementi artistik duke i dhënë vlerat e merituar. Gjithashtu analizimi i elementeve absurd në raport me trajtimin e tyre si element komik dhe goditja e fenomeneve patriarkale dhe synimeve mikroborgjeze përbëjnë trajtimin e elementit tradicional në këndvështrim më të gjerë. Vlerësimi ideoemocional i personazheve, koncepti për ekzistencën e femrës, përbën motivet e trajtuara të komedisë nën petkun e mentalitetit tradicional.

Fjalët kyçe: *tradicionale, rimarrje, komedi, element, Çajupi.*

MARËDHËNIA EROS & THANATOS NË ROMANIN “GURËT E VETMISË” TË AUTORIT TOM KUKA

Arkid Abdullaj

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *arkid.avd@hotmail.com*

Abstrakt: Me fillimin e traditës moderniste në letërsi, individi vendoset në qendër të krijimtarisë dhe bota e brendshme e tij është lënda e parë prej së cilës vepra letrare merr ngjyra.

Jeta dhe vdekja (përkatësisht Eros dhe Thanatos) janë temat që më së shumti lëvrohen në romanin e kësaj periudhe, duke u shtrirë thuajse në çdo roman dhe duke u prekur apo lëvruar nga çdo autor.

Në këtë punim, synojmë të japim një pamje të gjërë të kësaj marëdhënie, pasi në optikën tonë, jeta dhe vdekja është e pranishme përgjatë të gjithë romanit. Do të shohim gjithashtu se si konkretizohet prezenca e Thanatosit duke u shfaqur herë si paralajmërim, e herë si tregues i fundit apo fatalitetit.

Punimi sugjeron se, Erosi dhe Thanatosi përbën lëndën kryesore të romanit dhe gjithashtu del në përfundimin se mardhëdhënia mes dy koncepteve është e lidhur ngushtë me prezencën e ndërsjelltë të tyre, që do të thotë se, sa më afër njërit prej dy poleve, aq më shumë e ndiejmë prezencën e tjetrit. Sa më i prekshëm apo i ndjeshëm të jetë njëri, aq më tepër do të kapemi pas tjetrit.

Fjalë kyçe: Letërsi shqipe, modernizëm, eros, thanatos etj.

TRAJTIMI I KONCEPTIT TË KOHËS DHE SISTEMIT SIMBOLIK NË VËLLIMIN POETIK “NEMA” TË AUTORIT MARTIN CAMAJ

Brikela Uka

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Email: *ukabrikela@outlook.com*

Abstrakt: Nëpërmjet këtij punimi synojmë të evidentojmë qartë mënyrën se si Martin Camaj, një prej autorëve më të denjë të letërsisë bashkëkohore shqipe, i bën trajtimin të elementit të kohës në krijimtarinë e tij.

Nëpërmjet analizës së poezive të vëllimit poetik “Nema” synojmë të identifikojmë mënyrën se si e trajton ai kohën, si një koncept tepër abstrakt, së bashku me elementët që udhëtojnë në kohë, duke i parë në pikëpamjen simbolike. Gjithashtu, ky punim fokusohet kryesisht te individi si udhëtar i përjetshëm drejt së ardhmes së paidentifikuar: një individ gjithmonë në përmbushje të misionit të tij.

Si rezultat i hulumtimit dhe studimit të këtij vëllimi poetik, vëmë re se tiparet e lartpërmendura e bëjnë poezinë e Martin Camajt si një nga poezitë më me vlerë të letërsisë bashkëkohore. Poezitë ngrihen mbi nivelin e lartë abstragues, mbi një ftohtësi të akullt ndjenjësore dhe mbi një rrjet tensioni të forcave absolute që veprojnë në mënyrë sugjестive mbi elementet tekstuale. Poezia e Martin Camajt shënjon një sistem tërësisht të veçantë poetik, të kultivuar lirisht sipas gjedhës së modernitetit evropian.

Fjalë kyçe: *koncepti i kohës, abstraktja, simbolet etj*

PIKËTAKIMET MES POEZISË SË DRITËRO AGOLLIT ME POEZINË POPULLORE

Dajana Gërdani

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *gerdani.dajana@gmail.com*

Abstrakt: Poezia shqiptare në gjithë rrugëtimin e saj shumëvjeçare ka mbartur mbi supë historinë e një kombi, popullin e tij, gjuhën dhe traditën me të cilat ai identifikohet.

Poezia e Dritëro Agollit lind nga kultura, përralla, realiteti, i cili përcillet me anë të një gjuhe të kuptueshme, e cila inkuadron së brendshmi të bukurën, të veshur nga natyra. Përjetimet personale arrin t’i vërë në jetë nëpërmjet vargjeve të poezisë së tij.

Shpalosja para lexuesit e një sërë elementësh të një botëkuptimi jo vetëm personal e bën Dritëro Agollin poetin më gjithëpërfshirës dhe më identifikues të letërsisë shqiptare.

Fjalë kyçe: *traditë, gjuhë, përjetim, popull, poezi.*

EKONOMIA GJUHËSORE NË VARIETETET GJUHËSORE

Edlira Zeka

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: zeka.edlira@hotmail.com

Abstrakt: Gjuha është një mjet komunikimi që u shërben njerëzve. Pra, duhet të dimë që ajo shërben për të plotësuar nevoja të ndryshme të njerëzve. Gjuha i jep njeriut edhe mundësinë që të përfshihet në një status të caktuar, mbi bazën e të cilit ai edhe vishet me një prestigj social. Në fakt, askush nuk egziston në një gjuhë të vetme, por egzistojnë një numër i madh “gjuhësh”. Kjo larmi “guhësh” brenda një gjuhe të caktuar është ajo dukuri që e shqetëson komunikimin ndërmjet njerëzve të një bashkësie shoqërore të caktuar. Studimi i konceptit të ekonomisë gjuhësore nuk është marrë rastësisht në trajtim mbështetur tek varietetet gjuhësore. Duhet parë e dalluar mirë gjuha si sistem abstrakt, gjuha si e tërë, gjuha si njësi gjithëpërfshirëse, nga realizimet e saj konkrete në të folurit e individëve dhe në lidhjet e larmisë së pafundme të realizimeve e ndryshimeve ligjërimore të njerëzve, në përputhje me faktorë të shumtë mjedisorë, shoqërorë, kulturorë dhe përgjithësisht jashtëgjuhësorë. Pra mund t na ndihmojë një paraqitje që mbështetet në idenë e qilimit, i cili është realisht i larmë e që përmban shumë ngjyra të cilat nuk kanë mbarim, por po ta shikosh nga larg ngjan si një e vetme. Këtu është edhe gjuha, si sistem unik dhe i pamjes së pathyer e tepër të larmishme të saj në të folurit konkret të njerëzve të një bashkësie shoqërore të dhënë.

Varietetet shoqërore të kodit të gjuhës janë varietete që kanë të bëjnë me përkatësinë e individit folës në grupe të caktuara shoqërore në klasa ekonomiko-shoqërore të diferencuara brenda bashkësisë që dimë si edhe në grupime të tjera të ndryshme. Duke qenë se varietetet gjuhësore janë të shumta, është pak e pamundur të bëhet një grupim i saktë i tyre, sepse edhe modalitetet që shkaktojnë lindjen e tyre janë të ndryshme dhe të larmishme. Për të ilustruar temën njëqë marrë në trajtim modalitete të rastit e komplekse, prandaj është e vështirë të caktohen e të jepen bashkësitë e përhershme të tyre.

Fjalët kyce: *gjuha, komunikimi, shoqëri, varietetet gjuhësor, ekonomi gjuhësore, bashkësi gjuhësore.*

RËNDËSIA E ELEMENTËVE PARATEKSTUALË NË ROMANIN “HANA” NGA ELVIRA DONES

Enxhi Hasa

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *booklovers_albania@outlook.com*

Abstrakt: Gjatë analizës së një vepre letrare, duhet të marrim parasysh edhe elementë të tjerë që në pamje të parë mund të duken sikur nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë dhe me karakter jashtëtekstor, por që në fakt janë elementë që krijojnë njëfarë pritshmërie dhe parashikimi të lexuesi, dukeqënëse janë ato me të cilat lexuesi përballet në prezantimin dhe njohjen e parë me një tekst.

Në teorinë letrare këto elementë njihen si elementë paratekstualë dhe cilësohen si pragu i interpretimit të veprës letrare, duke treguar gjithashtu lidhjen me tekstin.

Elementët para dhe pas tekstualë mund t'i konsiderojmë si një mbulesë shoqëruese të librit, duke përfshirë titullin, kopertinën, epitekstin, informacionin e hapjes, parathënien, shënimet, renditjen e kapitujve si edhe shumë materiale të tjera.

Në romanin “Hana” autorja është kujdesur që çdo element të ketë lidhje me tekstin në vetvete. Elementët paratekstualë arrijnë të lidhen më së miri me atë çka romani përcjell, duke dëshmuar se janë të zgjedhur me kujdes dhe se autorja i ka dhënë rëndësi, duke dashur të sjellë te lexuesi idenë e romanit që në përballjen e tij të parë me librin.

Fjalë kyçe: *Paratekst, epitekst, letërsi bashkëkohore, interpretim.*

**TEMA E LIRISË DHE ATDHEUT NË VËLLIMET POETIKE
“SHTIGJE POETIKE” DHE “POEMA DHE VJERSHA”
TË AUTORIT FATOS ARAPI**

Erinda Shehu

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *erindashehu@icloud.com*

Abstrakt: Atdheu dhe liria kanë qenë objekt shkrimi për shumë shkrimtarë por tashmë nën hijen e penës herë triumfuese, herë kryengritëse, herë të zhgënjyer e herë shpërthyesë të Fatos Arapit ato fitojnë një pamje të re. Në këtë punim synohet dhënia e interpretimeve specifike bazuar në temën e lirisë edhe atë të atdheut, këndvështrimi i rilidhur me nacionalen dhe ballafaqimi i botëkuptimit të kohës me karakterin kontrovers të poezisë së Arapit. Nëpërmjet analizës së teksteve poetike "Shtigje poetike" dhe "Poema dhe Vjersha", synohet identifikimi i tipareve të veçanta, gjuha e përdorur, elementët e përcaktuar, qofshin ato të mbuluara nga petku i filozofisë ose edhe ato që janë lehtësisht të evidentueshme. Punimi fokusohet në poezi specifike dhe parashtrimi i një vizioni personal novativ, i cili lind nga përjetimi i realitetit e që ndërthuret me kulturën dhe historinë për të krijuar një tablo të përgjithshme, herë-herë dramatike.

Fjalët kyç: *atdhe, triumf, zhgënjim, liri, histori, realitet.*

**VEÇORITË STILISTIKE DHE GJUHËSORE NË VËLLIMET POETIKE
“NË RRUGË DOLA” DHE “HAPAT E MIA MBI ASFALT”
TË POETIT DRITËRO AGOLLI**

Irisa Lleshi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: *Irisa.lleshi@hotmail.com*

Abstrakt: Objekti i këtij studimi do të jenë veçoritë stilistike dhe gjuhësore të vëllimeve poetike “Në rrugë dola” dhe “Hapat e mia në asfalt”, të poetit Dritëro Agolli. Analiza do të fokusohet tek shprehjet gjuhësore dhe ndikimi i tyre në stilin e poetit. Duke përdorur metodën përshkruese do të listoj risitë që solli Agolli në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit të XX. Përdorimi i figuracionit letrar dhe përzgjedhja e gjuhës duken mjaft qartë në këto poezi. Gjuha e pastër shqipe e cila shpesh gërshetohet me dialektin toskë e bën poetin mjaft të dashur dhe të kuptueshëm për lexuesin. Përtëritja që solli Agolli në vjershërim duke mjaft qartë në këto dy vëllime. Vargu i përdorur dhe rimat që poeti sjell janë veçori të poetit ndaj dhe kam zgjedhur ti trajtoj. Në punimin tim kam trajtuar edhe pikëlidhjet mes vëllimeve poetike dhe poezisë popullore, sa është ndikuar Agolli nga vargu popullor shqipëtar, si ka arritur të sjell një poezi aq të ngjashme dhe të ndryshme nga krijimtaria popullore.

Fjalë kyçe: *gjuha, stili, temat, veçoritë.*

MOTIVET KRYESORE NË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT

(Vëllimi Poetik "Mesditë")

Marsida Mani

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Abstrakt: Në këtë punim do të ndalemi në vëllimin poetik "Mesditë" të autorit Dritëro Agolli, duke u ndalur në motivet kryesore të këtij vëllimi.

Dritëro Agolli është ndër figurat qendrore të shkrimtareve të shekullit të kaluar dhe vazhdon të jetë embleme e qëndrueshme në letrat shqipe me krijimtarinë e tij në prozë, publicistikë e sidomos në poezi, si nga vlerat estetike e letrare, ashtu edhe nga shtrirja tematike e motiveve.

"Shumica e titujve të librave të Agollit si: "Mesditë", "Gdhihet e ngriset", edhe pse nuk e shprehin drejtëpërdrejtë, përseri janë përfutur mbi levizjen. Fjalët mesditë, kohë, mesnatë, gdhihet e ngriset, janë metafora simbolizuese të lëvizjes në kohë dhe në mendim.

Në poezitë e dashurisë së Agollit ndërthuren e bukura, vuajtja, shqetësimi dhe emocionet që vijnë si shprehje përmasash të ndryshme, si dashuria e sinqertë, shpirtërore, e përshkruar me përjetime nga më të dhimbshmet.

Poezia e tij na sjell përplasje emocionale në çaste të kundërta, të shprehura me ashpërsinë e gjuhën plot ironi.

Fjalë kyçe: *Poezia bashkëkohore, motivet, figurat, metafora*

**PIKËTAKIMET E SHQIPËRISË SË VITEVE '20 ME AKTUALITETIN
NË VEPRËN “DOKTOR GJILPËRA” ZBULOJNË RRËNJËT E
DRAMËS SË MAMURRASIT**

Neda Tarko

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *nedatarko12345@gmail.com*

Abstrakt: Letërsia pas pavarësisë emërton atë letërsi që u shkrua në Shqipëri nga viti 1912 deri në vitin 1939.

Në mesin e figurave të shquara të kësaj periudhe, spikat figura e Faik Konicës, njohur si shkrimtar, eseist, kritik, pra, një figurë shumë dimensionale.

Në këtë punim, synojmë të japim një pamje të Shqipërisë në vitet e lartpërmendura, parë kjo në optikën e autorit. Nëpërmjet përshkrimit me nota sa ironike aq edhe satirike, vihet në lojë klasa drejtuese e Shqipërisë që, mesa duket, nuk e përqaftonte shpejt të renë dhe përbuzte ndryshimin që mund të sillte klasa intelektuale.

Ky punim sjell sërish në dritë “Doktor Gjilpërën” në kontekstin social të 100- viteve më vonë, duke vënë në dukje pikëprerjet dhe pikëtakimet e dy realiteteve të largët në kohë, por jo dhe aq në perspektivë.

Fjalë kyçe: *letërsia e pavarësisë, ironia, satira, kronotopia etj*

FRAGMENTARIZIMI DHE TEKNIKA E MONTAZHIT NË ROMANIN "ULURIMA E UJKUT" I AUTORIT AG APOLLONI

Xhemile Hoxha

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

E-Mail: *xhemi.hoxha.uamd@gmail.com*

Abstrakt: Për letërsinë dhe mbi çdo periudhë letrare ka qindra hulumtime dhe punime të cilat janë parë dhe zhvilluar në dimensione të ndryshme artistike. Letërsia postmoderniste është ajo periudhë artistike e cila vazhdoi rrugëtimin e modernizmit, duke e plotësuar atë në të gjitha dimensionet artistike. Një nga tiparet e postmodernizmit është edhe fragmentarizimi dhe teknika e montazhit. Kërkimi shkencor është i ndërtuar mbi këto tipare të cilat i gjejmë në romanin "Ulurima e Ujkut".

Metodat e përdorura në këtë punim janë të shumëllojshme. Këtu mund të përmendim burime të gjëra që përfshijnë literaturë teorike mbi tiparet e postmodernizmit si dhe burime letrare të një fokusi më të ngushtë që fokusohet në çështje të ndërtimit të tekstit e për rrjedhojë, rrëfimit.

Fragmentarizimi në këtë roman është një tipar mjaft interesant sepse na e paraqet romanin në formën e një puzzle që, kur mbyll faqen e fundit të librit formohet i gjithi.

Fragmentarizimi apo copëzimi i ngjarjeve në këtë roman paraqet përjetime të narratorit, të cilat mbartin gjurmë të historisë në kohë të ndryshme. Është teknika e montazhit ajo që i bën këto zhanerë të qëndrojnë dhe të veprojnë si një unitet i vetëm dhe pa kaos, ndonëse nuk janë në një rend kronologjik. Mund të themi me bindje të plotë se autori ka arritur t'i vendosë me një mjeshtëri të rrallë artistike.

Fjalë kyçe: *letërsi shqipe, postmodernizëm, fragmentarizim, narracion, montazh etj*

ADOLESHENTËT

Bedrana Skenduli

E-mail: anaskenduli17@gmail.com

Abstrakt: Adoleshenca është një fazë e zhvillimit fizik dhe mendor e njeriut. Kuptimi i plotë i adoleshencës në shoqërinë e sotme mundësohet nga njohuritë që rrjedhin nga edukimi. Brenda të gjithave nga këto perspektiva, është e sigurtë të themi se adoleshenca është parë si një tranzicion ndërmjet varësisë dhe pavarësisë dhe qëllimi kryesor i së cilës është përgatitja e fëmijëve për moshën e rritur. Zhvillimi i adoleshencës, karakterizohet nga fillimi i pubertetit me një rritje të vrullshme masës trupore. Vërehen ndryshime në aftësinë e të menduarit abstrakt dhe multi-dimensionally, në aftësinë e përfaqësimit të strukturave shoqërore. Ndryshime të mëdha biologjike përfshijnë ndryshime në organet seksit, lartësia, pesha, dhe në masë të muskujve, si dhe ndryshime të mëdha në strukturën e trurit dhe organizimin. Përparimet njohëse përfshijnë edhe rritje në njohuri dhe në aftësinë për të menduar abstrakte dhe për arsye më të efektshme. Ligji parashikon se përgjegjësinë për fëmijët e kanë prindërit deri kur këta arrijnë moshën madhore dhe të gjithë e shprehin se kanë nevojë për këtë mburojë. Por secili do të jetë përgjegjës për vetveten. Në të vërtetë bëhet fjalë për një Bashkëpërgjegjësi. Duke patur parasysh zhvillimin e pabesueshëm që na ndodh, ne kemi nevojë për interesimin e familjarëve ndaj nesh, por kur ky interes shfaqet mundet të na tërheqë kah fëmijëria apo, përkundrazi, të na shtyjë shumë shpejt drejt moshës madhore. Në të dyja rastet ndjehesh “i bllokuar” prej kësaj vëmendjeje ndërkohë që thjesht kemi kërkuar një ndihmë. Adoleshenca është edhe një lëvizje e pasur me forcë, me pritshmëri dhe jetë: një lulëzim. Kjo forcë është shumë e rëndësishme, është vetë energjia e këtij shndërrimi. Ndoshta prandaj fjala dal është kaq e rëndësishme. Të dalësh do të thotë të braktisësh hojen e vjetër që tashmë të zë frymën, do të thotë gjithashtu të kesh edhe një lidhje dashurie. Është një pikë kyçe që kanalizon për mirë gjithë këtë lëvizje ku jemi përfshirë. Adoleshenca është gjithnjë e vështirë por, nëse prindërit dhe fëmijët kanë besim tek jeta, gjithçka shkon përherë për së mbari.

Fjalët kyçe: *Adoleshent, pubertet, përgjegjësi, edukim, forcë.*

ÇRREGULLIM BIPOLAR APO NDRYSHIM I HUMORIT

Anxhela Imeraj

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës

E-mail: anxhelaimeraaj.99@gmail.com

Abstrakt: Çrregullimi bipolar me simptomat përkatëse diagnostifikuese karakterizohet nga episode manie dhe episode depresive që shpesh shfaqen në adoleshencë. Ndryshimet e humorit janë gjendje emocionale që i japin ngjyresë botës shpirtërore dhe ndikojnë në sjelljen e çdo individi.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të qartësojë kuptimin real të këtij çrregullimi për arsye se shpesh i etiketojmë individët si të tillë vetëm për arsye të ndryshimit të humorit. Kjo prirje për të etiketuar individët me çrregullimin bipolar na drejton drejt subjektivizmit, për këtë arsye duhet që të njohim qartësisht këtë çrregullim.

Në lindjen e humoreve të ndryshme ndikojnë faktorë si:suksesi në veprimtari,gjendja shëndetësore,gjendja atmosferike etj. Humoret zgjasin me orë ,me ditë ose me javë të tëra, ku nje gjendje e mire humori gradualisht ia lë vendin një gjendjeje tjetër me humor negativ. Pikerisht këtu ndodh edhe konfuzioni me çrregullimin bipolar.Edhe çrregullimi bipolar ka ndryshime te gjendjes së humorit mirepo ndryshimi qëndron sepse ky çrregullim fillon me nje gjendje manie,euforie të lartë,një periudhë normaliteti dhe më pas një episod depresiv.Pra ndryshimi konsiston në faktin se ndryshimet e humorit jane drastike,në atë masë sa dëmtohen aftësitë e individit për të funksionuar normalisht.

Të dhënat bazë diagnostifikuese nga DSM-5 (Manuali më i fundit i diagnostifikimit të çrregullimeve mendore) ku përvecse paraqiten llojet e çrregullimeve bipolare tregohen qartësisht diagnozat diferenciale.

Si konkluzion,çrregullimi bipolar ndryshon nga ndryshimi i humorit sepse ky i fundit është pjesë e çdo individi në shoqëri.Të paturit ndryshime në ciklin emocional është pjesë përbërëse e secilit prej nesh.

Fjalë kyçe: *çrregullim bipolar, simptoma, diagnozë diferenciale, trajtime*

NDIHMESË NË PËRMIRËSIMIN E SHËNDETIT MENDOR MES STUDIMEVE TË RASTIT

Debora Mukli

E-mail: *debora.mukli@yahoo.com*

Abstrakt: Shoqëria shqiptare ka kohë që është ndërgjegjësuar për rolin që luan shëndeti mendor, krahas atij fizik në jetën e individit dhe raportet sociale të tij. Individit i socializuar është pjesë aktive e shoqërisë dhe merr pjesë në zgjidhjen e shumë problemeve shoqërore e familjare. Në punimin tonë do të sjellim një ndihmesë modeste në shqyrtimin e trajtimin e rasteve të çrregullimit somatik, kryesisht te femrat mbi moshën tridhjetë vjecare. Pas vëzhgimeve të disa rasteve mendojmë së trajtimi më efikas me terapinë kognitivë bihejviorale është mundësia më e mirë për funksionimin normal në jetën e përditshme dhe shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve e veta. Mbështetur në kriteret diganostikuese të çrregullimit të Somatizimit: keqinterpretim të ndijimeve trupore, çrregullime dismorfike lidhur me keqinterpretimin e simptomave trupore në rastet e shqyrtuara mendojmë se duhen trajtuar me prioritet femrat, të cilat simptomat somatike sjellin shkëputje domethënëse nga jeta reale. Trajtimi i rasteve të tilla sjell ndihmesën e vet në familje e shoqëri dhe për faktin se shumica e femrave të mara nën vëzhgim janë nëna e shëndëri i tyre mendor ndikon drejtpërdrejtë dhe në mirëritjen e fëmijëve.

Fjalë kyce: *shëndet mendor, çrregullim somatik, terapi.*

ÇRREGULLIMI I GJUMIT (Insomnia)

Dhimitra Milaj

Departamenti i Psikologjisë

E-mail: *dhimitramilaj@hotmail.com*

Abstrakt: Insomnia, është një çrregullim i hipotalamusit, apo qendrave të stimulimit të gjumit në tru, gjë që sjell tek disa njerëz pamundësinë për të fjetur. Zakonisht të prekurit nga ky çrregullim, kanë vështirësi në të fjetur ose zgjohen herët dhe nuk mund të flenë përsëri. Këta individë ndihen gjatë gjithë kohës të lodhur dhe të përgjumur. Është shumë e vështirë në disa raste për të diagnostikuar dikë me një çrregullim të tillë, pasi në një mënyrë apo tjetër shumica e njerëzve shfaqin simptoma që mund të jenë të ngjashme me insomninë, por që insomnia mund të mos jetë e pranishme. Të prekurit nga ky çrregullim kujtojnë gjërat me vështirësi, ndjehen shumë të lodhur gjatë ditës, dhe kanë një ndjesi gjumi gjatë gjithë kohës me përjashtim të darkës. Në disa raste pamundësia për të fjetur gjumë lidhet me stresin dhe depresionin në periudhë afatgjatë. Në rastet kur insomnia vazhdon për një kohë të gjatë, njihet me emrin *isomnia kronike*, dhe zakonisht vjen si rezultat i të menduarit të tepërt për pagjumësinë, gjë që trazon së tepërmi qendrat e gjumit në hipotalamus (zona e trurit që kontrollon veprimet tona, mes tyre edhe gjumin.)

Fjalë kyçe: *çrregullim i gjumit, shëndet mendor, stres.*

ROLI I LEXIMIT NË FORMIMIN E STUDENTËVE

Edisnajda Durro

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *Edisaduro77@hotmail.com*

Abstrakt: Ka pasur mjaft interpretime mbi rolin e leximit dhe rëndësinë e tij në formimin e individit, jo vetëm universitar. Leximi krahas kënaqësisë estetike ka dhe dobi në formimin qytetar e profesional. Shpesh pohohet se nuk është e mjaftueshme koha e leximit, apo sasia e për zgjedhur nga studentët për t’i ndihmuar ata të ndërtojnë e argumentojmë teza të ndryshme. Kemi hetuar studentë të degëve të ndryshme në fakultetet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës përmes një pyetësi ku mateshin: koha e leximit / sasia në orë, shpejtësia e leximit, numri i faqeve ditore, mujore, lloji i literaturës, zgjedhja, burimi. Nëpërmjet një pyetësi analizojmë fillimisht llojin e burimeve që ndihmojnë studentët dhe sipas pritshmërisë studentë të gjuhës e letërsisë (Fakulteti i Edukimit) lexojnë letërsi artistike, autorë që përfshihen në sylabuset e kurseve përkatëse, shprehur në përqindje. Nuk jemi marrë me emra të vecantë autorësh, apo klasifikimesh të llojeve; letërsi e huaj, apo e traditës duke dashur të hulumtojmë vetëm në leximin si proces dhe ndikimin e tij në formimin e përgjithshëm të individit dhe aftësinë komunikuese të tij.

Fjalë kyce: *formim qytetar, formim gjuhësor, proces i leximit.*

NJOHURITË E TË RINJVE TË MOSHËS 20-30 VJEÇ NË SËMUNDJET NEUROLOGJIKE

Enkela Dhima

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës

E-mail: *enkela.eni@gmail.com*

Abstrakti: Historikisht, promovimi i shëndetit ka qenë i lidhur ngushtë me parandalimin e sëmundjeve. Sëmundjet neurologjike prekin qindra miliona njerëz në botë e megjithatë njerëzit kanë mungesë informacioni në lidhje me këto sëmundje. Fakti që për këtë temë në vendin tonë nuk flitet shumë, bën shtysë studimin për nivelin e informacionit që zotërojnë individët e moshës së rritur të hershme në vend. Disa nga qëllimet kryesore të këtij studimi ishin të konstatuarit se sa njerëz janë në dijeni lidhur me këto sëmundje si edhe rritja e nivelit të ndërgjegjësimit mbi shëndetin, që prek këdo pa dallime. Metoda e përzgjedhur është ajo konvencionale joprobabilitare, ku nëpërmjet zgjedhjes rastësore janë intervistuar 60 persona të ndryshëm brenda moshës 20-30 vjeç. Nga përgjigjet, 43 prej të intervistuarve ishin femra dhe 17 meshkuj, kryesisht të rinj të moshës 20 dhe 22 vjeçare. Njohuritë lidhur me ekzistencën e sëmundjeve ishin më të larta tek femrat , (76% e të informuarve) dhe ato më të pakta të tyre lidhur me këto sëmundje , ishin ato për insultin cerebral, ku një përqindje prej 15% ishte në dijeni rreth tij. Rreth 85 % e të pyeturve konstatuan se vuanin nga një sëmundje e tillë neurologjike dhe 70% e tyre gjithashtu shprehën se shkak për këto pasoja ishin njëkohësisht gjenetika, kequshqyerja dhe traumat fizike. Gati 38 % e personave shprehën se më të rrezikuar janë mosha e tretë. Ndër shkaqet që ata listonin si shkak të sëmundjeve ishin celulari, ushqimi, stresi, kequshqyerja, ndjekur nga mungesa e aktivitetit fizik , jeta sedentare , ushqimet e shpejta dhe pijet alkoolike e energjike. Të dhënat janë paraqitur nëpërmjet metodave statistikore. Në përfundim, sugjeroj gjithashtu nxitjen për marrjen e informacionit të duhur nga çdo grupmoshë dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë kyçe që ka mbarëvajtja e shëndetit.

Fjalë kyçe: *informacion, sëmundje neurologjike, shëndet.*

RËNDESIDIA E NXITJES SË MENDIMIT KRITIK TË NXËNËSIT TË SHKOLLAVE FILLORE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE. (Rasti studimor i shkollës ‘‘Pinepolli Piro’’ në Fier)

Evelina Delvina

E-mail: *evelinadelvina1@gmail.com*

Abstrakt: Ndër studiues të ndryshëm, sa herë që në konsideratë merret modeli arsimor fillor i Lindjes, dy ndër problematikat thelbësore të vërejtura janë mungesa e rrugëve kreative drejt ushtrimit shkollor për zgjidhje problemesh dhe, më kryesori në bindjen tonë, mungesa e sprovave që nxisin të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve shkollore nga nxënësit. Ky punim, më së shumti, duke e konsideruar si një sfidë të shekullit bashkëkohës mësimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore, do të ndalet e thellohet pikërisht këtu.

Nëpërmjet një kërkimi të miksuar, sasior dhe cilësor, do të paraqesim në dritën e një trajtесе teorike mësimin e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore të nxënësve sipas një studimi të ndërmarrë nga British Council dhe qeveria britanike, rëndësinë dhe hapat e ndërtimit të një strategjie të tillë si edhe, në anën tjetër, do të paraqesim gjetje prej të dhënave sasiore të mbledhura nga anketat e një shkolle fillore në qytetin e Fierit, « Pinellopi Piro » në katër nivele : drejtues, mësimdhënës, prindër dhe nxënës, ku fokusin kryesor e kanë këta të fundit.

Nisur edhe nga studimi i referuar më sipër, që do të përbëjë bazën e të dhënave teorike, në boshtin kryesor të trajtesës tonë do të jenë konteksti i mësimin kritik dhe zgjidhjes së problemeve, përshtatja e koncepteve komplekse me përvojat e nxënësve, ndërtimi i strategjive të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve si dhe pesha e ushtrimit praktik të vazhdueshëm të nxënësit, duke bërë më pas, në një hap të dytë, përmes anketave në shërbim të rastit studimor, vëzhgimin e rastit në fjalë.

Të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve është një ndër sfidat e shekullit XXI, që ndikon në brezat e ardhshëm. Ushtrimi i mendimit kritik në brezat e nxënësve të shkollave fillore nxit breza të rinjsh me bazament të shëndetshëm për studime më të thelluara.

Fjalët kyçe: *mendim kritik, zgjidhje problemesh, konteksti i mësimin, përshtatja e koncepteve komplekse, strategjitë e punës dhe ushtrimi praktik*

PAPËRPUTHSHMËRIA MIDIS PËRSHKRIMIT TË PUNËS DHE PRITSHMËRIVE NDAJ PUNËS, LIDHUR ME MOTIVIMIN E INFERMIERËVE NË SPITALET PUBLIKE (Durrësit dhe Beratit)

Matilda Kalemaj (Lamllari)

E-mail: matilda.kalemaj@gmail.com

Abstrakt: Qëllimi kryesor i këtij studimi është të përshkruajmë dhe identifikojmë nivelin e përgjithshëm dhe marrëdhënien e motivimit me papërputhshmërinë në punë, tek infermierët që punojnë me kohë të plotë në spitalet publike në Shqipëri. Të identifikojmë nëse ekzistojnë diferenca statistikisht të rëndësishme midis motivimit, papërputhshmërisë dhe të dhënave demografike.

Ky studim është realizuar në dy qytete, në Spitalin Rajonal të Durrësit dhe në Spitalin Rajonal të Beratit. Kampioni i marrë në studim është 250 punonjës infermierë që punojnë me kohë të plotë, nga të cilët 150 punonjës infermierë janë nga Spitali i Durrësit dhe 100 punonjës infermierë nga Spitali i Beratit. Janë përdorur dy instrumenta të cilët masin: *a*) shkallën e motivimit të punonjësve sipas *Brandy-it (2008)* dhe *b*) shkallën e papërputhshmërisë në punë sipas *Barbouletos (2011)* që mat ndryshimin midis përshkrimit formal të punës dhe pritshmërive reale të një pozicioni pune.

Rezultatet e studimit treguan se: ekzistojnë diferenca statistikisht të rëndësishme midis motivimit me gjininë dhe eksperiencën në punë. Infermieret femra janë më të motivuara për të punuar ($p=.028$) se infermierët meshkuj, infermierët me më pak eksperiencë janë më të motivuar për të punuar ($p=.000$) se ata që kanë më shumë eksperiencë. Gjithashtu ekzistojnë diferenca statistikisht të rëndësishme midis papërputhshmërisë në punë dhe gjinisë, infermieret femra shfaqin nivel më të lartë papërputhshmërie midis përshkrimit formal të punës dhe pritshmërive reale të pozicionit ($p=.000$) se sa infermierët meshkuj. Së fundmi ekziston një marrëdhënie negative e rëndësishme midis papërputhshmërisë në punë dhe motivimit të infermierëve ($r=-.455$, $p=.000$), sa më i lartë të jetë niveli i papërputhshmërisë midis përshkrimit formal të punës dhe pritshmërive reale të pozicionit në punë, aq më i ulët do jetë motivimi i infermierëve në punë.

Fjalë kyçe: *infermierë, përshkrimi i punës, papërputhshmëria në vendin e punës, motivim, motivim i brendshëm dhe motivimi i jashtëm.*

BULLIZMI NË SHKOLLA, NJË FENOMEN I FSHEHUR

Migena Idrizaj

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës

Email: *migenaidrizaj@yahoo.com*

Abstrakt: Bullizmi është një fenomen i ri në kontekstin e studimit por i vjetër në kontekstin e ekzistencës. Bullizmi në shkollë është zakonisht një problem i fshehur. Stafit i mësuesve, përgjithësisht nuk janë në dijeni se sa i përhapur është ky fenomen në shkollën e tyre dhe mund të mos e njohin shkallën e seriozitetit të incidentit. Në të shumtën e rasteve, të dy, si personi që ushtron bullizëm, po ashtu dhe viktimat kanë tendencën ta mbajnë të fshehur nga të rriturit zënkën ndërmjet tyre. Përceptimi i masës së seriozitetit mbi zënkën ndryshon në një masë të madhe nga një mësues në tjetër. Nga një studim rezulton se 7 % e studenteve ushtrojnë dhunë dhe ndoshta 10-20 % mund të jenë viktimat kronike të ngacmimeve të ndryshme.

Fëmijët janë një burim shprese për të gjithë komunitetet. Ndaj, siguria dhe mirëqenia e tyre, janë elementi kyç i së ardhmes. Megjithatë, fëmijët janë të pambrojtur ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit në të gjitha shoqëritë. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i lirë nga dhuna, shfrytëzimi e të ketë qasje në arsim dhe ushqim, për të arritur potencialin e tij të plotë. Shkolla mund të ofrojë një strehë të sigurtë për ta, ku të jenë në gjendje të mësojnë e të zhvillohen. Punonjësit e shkollës, dhe të tjerë të përfshirë në aktivitetet e shkollës, duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në sigurimin e fëmijëve të vërejtur apo të dyshuar, të cilët mund të jenë të dhunuar apo shfrytëzuar, se duhet t'i referohen një specialisti të mbrojtjes.

Fjalë kyçe: *bullizëm, agresorë, viktimë, shfrytëzim, dhunë.*

PROÇESI I TË LEXUARIT TE NXËNËSIT NË SISTEMIN 9-VJEÇAR

Mirela Pashollari

E-mail : *alessio.pashollari@gmail.com*

Abstrakt: Proçesi i të lexuarit është shumë i rëndësishëm në edukimin e nxënësve. Kur ne si mësues u mësojmë fëmijëve që në moshë të vogël që të lexojnë, ne u mundësojmë atyre një dritare nga ku mund të shohin dhe të njohin botën që na rrethon.. Një nxënës-lexues i mirë sot, do të jetë një njeri i suksesshëm nesër.

Përmes këtij abstrakti si mësuese e lëndës së letërsisë në shkollën 9-vjeçare do të përpiqem të argumentoj se të lexuarit është proçes i rëndësishëm për nxënësit në shkollë, që duhet edukuar që në moshat e vogla dhe që duhet të vazhdojë për gjatë gjithë jetës. E rëndësishme për ne si mësues është t’u mësojmë nxënësve jo vetëm të lexojnë, por edhe se si të lexojnë, si të mendojnë dhe më pas të diskutojnë për atë që lexojnë.

Ky studim është mbështetur në kërkimin sasior, të realizuar me anë të pyetësorëve të ndryshëm të realizuar me nxënës të moshave 8-14 vjec, me prindër të këtyre nxënësve , si edhe me mësues të profilit. Gjithashtu janë realizuar edhe intervista me nxënës e mësues të cilët janë përgjegjës për bibliotekën e shkollës në dy shkolla 9-vjeçare: “100 Vjetori i Pavarësisë” Zhupan dhe “5 Dëshmorët “ Patos-fshat në rrethin e Fierit. Këto pyetësorë dhe intervista synojnë të vënë në dukje se sa lexojnë nxënësit, çfarë u pëlqen të lexojnë, si mundet që ne mësuesit t’i ndihmojmë sa më mirë në këtë proçes, sa ata diskutojnë me njëri-tjetrin për librat etj.

Nga ky studim doli se nxënësit megjithëse e kuptojnë rëndësinë që ka leximi në formimin e tyre, përsëri lexojnë shumë pak ose aspak (vajzat më shumë, djemtë shumë pak). Gjithashtu mësuesit, jo vetëm ata që janë të profilit gjuhë –letërsi, por edhe cdo mësues tjetër, kanë një rol të rëndësishëm në nxitjen e nxënësve për lexim. Po kështu edhe prindërit, të cilët që në moshat e hershme duhet t’i familjarizojnë fëmijët me librin. Nxënësit duhet të ndërëgjegjësohen se vetëm duke lexuar pasurojnë njohuritë e tyre në fusha e drejtime të ndryshme në varësi të tematikës së librit, aftësohen të eksplorojnë, të japin zgjidhje për probleme dhe situata të ndryshme, të zhvillojnë aftësinë e të shprehurit dhe të të folurit në publik, të të shkruarit saktë dhe bukur.

Rekomandime: Të planifikohen veprimtari të ndryshme javore, mujore, projekte që nxisin nxënësit për të lexuar. Bibliotekat e shkollave të bëhen sa më funksionale, të pasurohen me tituj librash të rinj për të tërhequr sa më shumë fëmijë në anëtarësim. Të forcohet sa më shumë bashkëpunimi me prindërit, që edhe ata të nxisin dhe të edukojnë fëmijët të lexojnë sa më shumë.

Fjalë kyçe: *lexim, nxënës, edukim, shkollë, prind, libër, formim.*

STRESI I PROVIMEVE TEK STUDENTËT E UNIVERSITETIT

Sindi Dhima

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *sindi.dhima@gmail.com*

Abstrakti: Stresi akademik mund të konceptohet si një ndërveprim ndërmjet stresorëve mjedisorë, aftësive konjitive të studentit dhe përgjigjies psikologjike dhe fiziologjike ndaj stresorëve akademikë. Ky stres është mjaft i përhapur midis vendeve, kulturave dhe grupeve etnike të ndryshme. Çdo student përpiqet të arrijë rezultate sa më të larta akademike për të fituar krenarinë familjare dhe respektin social. Dhe si rezultat i kësaj, vjen një presion relativisht i lartë mbi supet e tyre duke i bërë të mos t’i kalojnë si duhet vitet akademike dhe duke i kthyer këto vite në një vështirësi dhe lodhje të madhe. Sigurisht, duhet të theksohet se një farë sasive stresi duhet për të përmbushur në kohë dhe në mënyrë sa më të mirë detyra të caktuara, por sasia e tepërt bëhet shumë e dëmshme. Sipas një studimi të zhvilluar nga “Global Journal of Multidisciplinary Studies” në vitin 2014, stresi intensiv para dhe gjatë provimit ka pasoja mbi shëndetin mendor dhe simptomat somatike. Siç theksohet në raportin e Banerjee’s(2001), çdo vit rreth 25.000 studentë në grupmoshat nga 18 deri në 20 vjeç bëjnë vetëvrasje gjatë muajit të provimit. Gjithashtu është vënë re se për shkak të stresit të lartë të provimit, studentët shpenzonin më pak kohë në shoqëri dhe në angazhime sociale gjatë kohës së lirë. Një studim tjetër të zhvilluar nga “Health Psychol Open” në vitin 2015, theksohet se nivelet e stresit mund të përshkallëzohen në përmasa të konsiderueshme në disa nxënës. Hulumtimet e mëparshme, sugjerojnë një normë mesatare të prevelancës prej 10% deri në 35% të studentëve të kolegjit që përjetojnë stres nga ankthi i provimeve. Megjithatë, jo të gjithë nxënësit përjetojnë ankthin me të njëjtën ashpërsi. Në “Studimin Social të Bashkimit Studentor të Gjermanisë”, u vlerësua se rreth 15 deri në 20% e studentëve u dëmtuan nga nervat për shkak të stresit të provimit, në një shkallë “mesatare” dhe të “lartë”.

Fjalë kyçe : *stres, provim , studentë, presion.*

ROLI I DREJTUESIT TË SHKOLLËS DHE NDIKIMI I TIJ NË

REZULTATET AKADEMIKE

Taulant Sula

E-mail: *taulantsula94@gmail.com*

Abstrakti: Shkollat Shqiptare kanë një traditë disa dhjetra-vjeçare. Që nga shkollat e para, deri në ditët e sotme, shkollat janë përballur me mjaft sfida . Këto sfida kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rezultatet dhe ecurinë e shkollave. Jo pak herë këto sfida kanë qenë aq të vështira, sa zgjidhja duhej bërë me gjakun e pastër të bijve të këtij populli. Më vonë deri në ditët e sotme të vitit 2017 kemi shumë probleme me kushtet e shkollave, mjetet logjistike, dhe deri në transportin e stafit pedagogjik e nxënësve në shkolla nëpër rrugë të cilat nuk plotësojnë asnjë kriter për tu quajtur rrugë. Në këto sfida peshën më të madhe e kanë patur dhe e kanë udhëheqësit e shkollave të cilët kanë në dorë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e këtij vendi. Për meritën dhe për gabimet e tyre, arsimit në Shqipëri ndodhet në këtë gjendje, që disa i thurin elozhe duke e krahasuar me vendet e Europës Perendimore por edhe më në perëndim , me SHBA-në. Por ka edhe të tjerë që mendojnë se shkolla Shqiptare, ka perënduar edhe është duke u përpëlitur , duke dhënë shpirt ose më saktë duke ja bllokuar frymën me eksperimente edhe pseudo-reforma të cilat kanë patur vetëm qëllime klienteliste për të pasuruar një grup njerëzish me vlera monetare edhe jo një Shtet të tërë me dije. Ku akoma nuk është zhdukur kjo farë, jam i bindur se ka shpresë që arsimit do të shkojë aty ku i takon një shteti demokratik edhe të pavarur. Këtë punë duhet dhe mund ta bëjnë drejtuesit e institucioneve të arsimit duke filluar nga drejtori i një kopshti ose çerdheje e duke kaluar tek institucionet që prodhojnë mësimdhënës, tek Ministria e Arsimit dhe e Sporteve e deri tek Presidenti dhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë. Ka shumë njerëz që kanë aftësitë për të drejtuar këto institucione dhe ta dërgojnë Arsimin aty ku i takon. Ky studim që unë kam përgatitur do t'i vlejë sadopak të gjithë drejtuesve aktuaë dhe atyre që kanë dëshirë të vijnë më vonë në Arsim, njëri prej të cilëve jam edhe unë . Kjo është edhe një ndër arsytet se përse zgjedha këtë temë. Ky studim është përgatitur duke studiuar e përzgjedhur, studime bashkëkohore Shqiptare dhe të huaja por edhe duke bashkëbiseduar me njerëz që punojnë apo kanë punuar në Arsim. Në këtë studim është përdorur një pyetësor i përgatitur dhe është aplikuar për herë të parë nga unë.

Fjalët kyçe: *shkollat shqiptare, arsimit, sfida, drejtues, institucione*

BULLIZMI, FENOMEN I PËRHAPUR NË INSTITUCIONET ARSIMORE

Vikena Kadiu

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

E-mail: *vikenakadiu12@gmail.com*

Abstrakt: Talljet, fyerjet dhe ofendimet janë të pranishme kudo nëpër ambiente të shkollave gjatë pushimit por jo vetëm. Bullizmi është një fenomen sa i hershëm aq edhe bashkëkohor. Të bullohesh nga të tjerët është një luftë psikologjike sa me veten po aq edhe me të tjerët. Në këtë punim është paraqitur në mënyrë teorike bullizmi dhe roli i tij në shoqëri dhe këndvështrimi i mësuesëve rreth këti fenomeni apo situatave lidhur me këtë fenomen.

Olweus (1987) e ka përcaktuar bullizmin, si "një fenomen që ndodh kur një individ, i paaftë të mbrojë veten, ekspozohet në mënyrë të përsëritur dhe për një periudhë të gjatë kohe ndaj dëmtimit të qëllimshëm nga një ose disa të tjerë, në mënyrë direkte ose indirekte". Pra, bullizmi shfaqet në formën e agresionit fizik ose psikologjik. Ndodh që fillon të kërkojë në internet apo të flasësh me pedagogë se si mund të gjejmë forma të ndryshme për ta pakësuar këtë fenomen, se si t'ju shpjegojmë nxënësve që ashtu si nuk na pëlqen të biem "viktima" të këtij fenomeni ashtu edhe nuk duhet pra, të bëjmë "viktima. Njerëz të ndryshëm dhunojnë për arsye të ndryshme dhe disa dhunojnë më shumë se të tjerët.

Fjalë kyçe: *Bullizmi, dhunë, forcë, uni, frikë, kënaqësi, agresivitet, bullizmi verbal, bullizmi social, bullizmi fizik.*

VËSHTRIM KRITIK MBI ROMANIN “SHPELLA E PIRATËVE” E SHKRIMTARIT PETRO MARKO

Besarta Dakaj

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

E-mail: *besartadakaj@hotmail.com*

Abstrakt: Puna krijuese e autorit Petro Marko shënon pikën kulmore me romanin “Shpella e Piratëve” i cili meriton vend të veçantë në letërsinë tonë për fëmijë. Një roman i llojit fantastiko-aventuror, pasi zhvillohet në dy rrafshë: real dhe fantastik. Me anë të gërshetimit të ngjarjeve reale të kohës së sotme, të peripecive të shumta të heronjve, të situatave të papritura e befasuese, të veprimeve të hiperbolizuara që kanë të bëjnë sa me të kaluarën, aq edhe me të sotmen, romani u transmeton të vegjëlve mesazhe aktuale me vlera edukative dhe njohëse. Ky roman i edukon të vegjlit me virtytet e shquara të të parëve, me ndjenjën e krenarisë për të kaluarën e lavdishme të popullit tonë. Ai i nxit fëmijët për të kryer vepra të mira, për të qenë të guximshëm, trima, të vendosur e të shkathët në jetë. Në përputhje me frymën e përgjithshme të veprës dhe me kërkesat specifike të llojit të romanit aventuror, gjatë shtjellimit të ngjarjeve të subjektit, autori përdor dendur mjete karakteristike për këtë lloj letrar: intrigën, aventurën, të papriturën, enigmatiken etj., me anën e të cilave krijohet efekti artistik i duhur tek të vegjlit dhe vihet në lëvizje imagjinata e tyre. Me këtë frymë, me anë të hiperbolizimeve të thjeshta, krahasimeve të fuqishme, rrëfimit karakteristik si në përralla, gjuhës së pasur me fjalë të rralla etj., bëhet individualizimi i personazheve historike dhe ngjyrimi i gjallë i ngjarjeve dhe i mjediseve fantastike.

Fjalët kyçe: *letërsi për fëmijë, hiperbola, roman aventuror, intriga, fantastikja.*

NJË ANALIZË MBI EKVIVALENTIMIN E KOHËVE “ANGLISHT - SHQIP”

Edlira Shala (Karaj)

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: *shalaedlira@yahoo.it*

Abstrakt: Qëllimi i kësaj pune kërkimore është gjetja e ndryshimeve dhe ngjashmërive midis kohëve të foljes në anglisht dhe shqip. Ekuivalenca do të jetë pjesë e punës kërkimore ku do të tregohen ndryshimet gramatike, më së shumti të kohës së foljes dhe përdorimi i saj në të dyja gjuhët; anglisht dhe shqip. Nga një pikëpamje praktike, qëllimi im është të lehtësoj procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për sa i përket kohëve të foljes. Kjo do të na mundësonte të gjithë informacionin e duhur rreth formës, përdorimit dhe modalitetit. Me punën time kërkimore do të dëshiroja të jepja kontributin tim në profesionin e ardhshëm si mësuese, ku dëshiroj të jem sa më e qartë të jetë e mundur. Ndryshimet midis gjuhës angleze dhe shqipe janë të pashmangshme duke qenë dy gjuhë të ndryshme; anglishtja gjuhë tipike analitike dhe shqipja gjuhë tipike sintetike. Gjuha angleze në krahasim me gjuhën shqipe ka një përdorim të gjerë të shprehjeve në kohët në vazhdim. Duke marrë në shqyrtim të gjitha këto studimi im synon të theksojë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes dy gjuhëve anglisht dhe shqip.

Fjalët kyçe: *kohë folje , ekuivalencë, folje ndihmëse kam/jam, e tashme, e shkuar, e ardhme.*

NDIKIMI I PËRDORIMIT TË SMARTFONËVE, NË SUKSESIN E NXËNËSVE TË KLASAVE TË NËNTA

Elion Kollçaku

Universiteti i Tiranës

E-mail: *elionnkollcaku@gmail.com*

Abstrakt: Ky hulumtim ka të bëjë me ndikimin e “telefonëve të mençur” (smartphone), tek nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, nga klasa e gjashtë deri në klasë të nëntë, dhe rezultatet e suksesit përfundimtar. Hulumtimi është i fokusuar vetëm në qytetin e Prishtinës. Janë përfshirë 21 shkolla të mesme të ulëta, ku 19 prej tyre janë shkolla në qytet, ndërsa tri të tjera janë në fshatra. Pra, do të jenë të përfshira në hulumtim një e treta e shkollave të komunës.

Shkollat në të cilat është zhvilluar hulumtimi janë: “Faik Konica”, “Elena Gjika”, “Qamil Batalli-Model”, “Xhemail Mustafa”, “Dardania”, “Gjergj Fishta”, “Ismail Qemali”, “Nazmi Gafurri”, “Emin Duraku”, “7 Marsi”, “Mitrush Kuteli”, “Asim Vokshi”, “Meto Bajraktari”, “Naim Frashëri”, “Shkëndija”, “Xhavit Ahmeti”, “Pavarësia”, “Zenel Hajdini” (të gjitha këto në qytet), dhe nga fshatrat “Ganimete Tërbeshi”, “Avni Rrustemi” dhe “Isa Boletini”. Pjesë e të anketuarve do të jenë vetëm nxënësit e klasave të nënta. Hulumtimi po realizohet me qëllim që nga i cili të dalë një rezultat në lidhje me rënien e suksesit nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë, duke tentuar ta gjejë shkaktarin kryesor. Përqendrimi do të jetë tek “telefonat e mençur” (nga ang. “smartphone”), duke hipotetizuar se është shkaktari kryesor që sukcesi po iu bie.

Telefonat e mençur janë pjesë e përditshmërisë së njerëzve, sepse përmbajnë shumë mundësi brenda një ekrani. Në përgjithësi, një smartphone do të bazohet në një sistem operativ që lejon atë të përfshijë aplikacionet, ku mund të hulumtohet për gjithçka.

iPhone i Apple funksionon përmes iOS, dhe smartphone BlackBerry përmes BlackBerry OS. Pajisjet e tjera përmes Android OS të Google, webOS të HP dhe Windows Phone të Microsoft. Secili mundëson kyçjen në aplikacione si: Facebook, Google, Instagram, Twitter, Snapchat, Whatsapp, etj. “Telefonat e mençur” i përdorin jo vetëm moshat madhore (mbi 18 vjeç), por në masë të madhe edhe nga fëmijët. Atyre, përdorimi i “telefonave të mençur” mund t’i ndihmojë shumë në hulumtime për nxënie. Mirëpo, në të shumtën e rasteve keqpërdoret, pasi shpenzojnë kohë të madhe në rrjete sociale, lojëra dhe elemente të tjera dytësore. Përdorimi i tepërt vetëm sa ndikon negativisht tek ata, dhe mund t’i çorientojë për mësim, zhvillim të jetës normale, duke ua kufizuar mundësitë, drejt një jete më tepër virtuale.

Fjalët kyçe: *rënie sukcesi, smartphone, shkolla fillore, prishtinë, shkaqet.*

DIALEKTET DHE NËNDIALEKTET E SHQIPES (Çështje Fonetike)

Ermira Mehmeti

Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë

E-mail: *ermira.mehmeti12@hotmail.com*

Abstrakt: Në këtë punim janë trajtuar çështjet fonetike midis dialekteve dhe nëndialekteve të gjuhës shqipe. Kjo temë është mjaft e gjerë, mirëpo jam munduar të paraqes, përmes këtij punimi, disa nga veçoritë kryesore fonetike për dialektet dhe nëndialektet e shqipes.

Gjatë hulumtimit të këtyre çështjeve u pa se gjuha shqipe ka mjaft dallime fonetike në dialektet e saj. Dy janë dialektet kryesore, gegërishtja dhe toskërishtja, këto ndahen në nëndialekte e grupe të folmesh, të cilat kanë mjaft veçori fonetike, mirëpo jo aq dallime sa shqiptarët të mos kuptohen mes tyre nëse përdorin dialekte të ndryshme. Këto dy dialekte janë baza e gjuhës standarde shqipe.

Fjalët kyçe: *dialekt, nëndialekt, e folme, hulumtim, gjuha shqipe.*

BULLIZMI NË SHKOLLA NJË FENOMEN I FSHEHUR

Migena Idrizaj

migenaidrizaj@yahoo.com

Abstrakt: Bullizmi është një fenomen i ri në kontekstin e studimit, por i vjetër në kontekstin e ekzistencës. Bullizmi në shkollë është zakonisht një problem i fshehur. Stafi i mësuesve, përgjithësisht nuk janë në dijeni se sa i përhapur është ky fenomen në shkollën e tyre dhe mund të mos e njohin shkallën e seriozitetit të incidentit. Në të shumtën e rasteve, të dy, si personi që ushtron bullizëm, po ashtu dhe viktima kanë tendencën ta mbajnë të fshehur nga të rriturit zënkën ndërmjet tyre. Perceptimi i masës së seriozitetit mbi zënkën ndryshon nga një mësues në një tjetër. Një studim na rezulton se 7% e nxënësve ushtrojnë dhunë dhe ndoshta 10-20 % mund të jenë viktima kronike të ngacmimeve të ndryshme. Fëmijët janë një burim shprese për të gjithë komunitetet. Ndaj, siguria dhe mirëqenia e tyre, janë elementi kyç i së ardhmes. Megjithatë, fëmijët janë të pambrojtur ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit në të gjitha shoqëritë. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i lirë nga dhuna, shfrytëzimi e të ketë qasje në arsim dhe ushqim, për të arritur potencialin e tij të plotë. Shkolla mund të ofrojë një strehë të sigurtë për ta, ku të jenë në gjendje të mësojnë e të zhvillohen. Punonjësit e shkollës, dhe të tjerë të përfshirë në aktivitetet e shkollës, duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në sigurimin e fëmijëve, të cilët mund të jenë të dhunuar apo shfrytëzuar, se duhet t'i referohen një specialisti.

Fjalët kyçe: *bullizëm, agresorë ,viktimë, shfrytëzim, dhunë.*

DIVORCI, NDIKIMI I TIJ NË ZHVILLIMIN E FËMIJËS

Rudina Mema (Vrioni)

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

Email: *memarudina36@gmail.com*

Abstrakt: Ky studim rasti synon të evidentojë shkaqet dhe pasojat që ka divorci në zhvillimin tërësor të fëmijës. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi psikologjik dhe zhvillimi tërësor i fëmijës së marrë në studim. Divorci është një ndryshim i madh në jetën e fëmijës dhe me këto ndryshime, ata duhet të mësohen gradualisht.

Dy vitet e para pas divorcit duket se janë vitet më të vështira si për vajzat edhe për djemtë. Fëmijët mund të kenë probleme në shkollë, madje edhe e braktisin atë, humbin apo shtojnë jashtëzakonisht shumë në peshë, sic është edhe rasti i djalit të studiuar. Disa femijë reagojnë duke u bërë më të pjekur, më të kujdesshëm e më të aftë për veten (Amato, 2006; Amato, Loomis & Booth, 1995).

Prindërve, mësuesve, edukatorëve iu duhet të minimizojnë stresin e përshkallëzimin e situatës në të cilën fëmija ndodhet. Këtu, një rol të rëndësishëm luan dhe gjinia e fëmijës, kultura, ligji, morali, kujdestaria e njërit prind, formimi psikologjik i fëmijës. Duke vijuar më tej, për realizimin e këtij vlerësimi psikologjik është përdorur vëzhgimi global i fëmijës në të gjitha fushat e zhvillimit, si në: zhvillimin motor; zhvillimin mendor; zhvillimin gjuhësor; zhvillimin social-emocional; zhvillimin moral. Gjetjet e studimit na rezultojnë se, fëmija shfaq problematika të dukshme në të gjitha fushat e zhvillimit. Divorci, një fenomen i pashmangshëm i shoqërisë, lë gjurmë të thella dhe shfaqet pengues për zhvillimin global të fëmijës. Rekomandimet e dhëna, paraqiten shumë të vlefshme për të gjithë mësuesin, të cilët në klasat e tyre do të kenë nxënës të së njëjtës problematikë.

Fjalët kyçe: *divorc, prindër, zhvillim mendor, zhvillim gjuhësor, zhvillim moral, zhvillim social-emocional, zhvillim fizik.*

NAFTA NË SHQËRI DHE FORMIMI I SAJ

Anila Piperi

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

E-mail: anilapiperi@yahoo.com

Abstrakti: Nafta është një lëng viskoz në ngjyrë nga kafe e errët deri në të zezë, e cila përbëhet nga hidrokarbure e elemente të tjerë si Squfur, Azot, clorure etj. Nafta është formuar nga procesi i diagjenizimit të mbetjeve organike të organizmave e mikroorganizmave të ndryshëm, të cilët pas mbarimit të ciklit të tyre jetësor depozitoheshin në fundet e detrave, ku përgjat miljona viteve rrisnin trashësinë e tyre nga disa metra deri në disa kilometra. Rritja e trashësisë sillte rritje të presionit e cila nga ana tjetër shoqërohej me rritje të temperaturës. Presioni dhe temperaturat e larta, krijuan kushtet që llumrat me përmbajtje të lëndës organike të ndryshonin natyrën e përbërjen e saj kimike, ky proces quhet procesi i diagjenizimit, gjat të cilit lënda organike të ndryshojë, e të formonte një masë xhelatinose si dyll të quajtur Kerogen, e cila nën efektin e rritjes së temperaturave e presioneve u transformua në një lëng të trash e viskoz e cila është quajtur naftë. Gjatë procesit të Diagjenizimit, përveç formimit të naftës llumrat e ndryshëm jo organik u kompaktuesuan duke formuar struktura solide e me pore në të cilët u depozitua uji, nafta, gazi e përbërës të tjerë.

Përcaktimi i vendndodhjes së naftës është i vështirë të përcaktohet, e për këtë gjeologët kanë përpunuar e krijuar paisje e metoda të ndryshme shkencore, të cilat i ndihmojnë ata të përcaktojnë këto vendndodhje, si metoda e rilevimit gjeologjik, gjeokimia, Petrografia, metoda të ndryshme gjeofizike (Sizmika, Gravimetria, fotografimet satelitore etj). Pas përcaktimit të vendndodhjes të Rezervuarit Naftëmbajtes, shpohen pusët për nxjerrjen e naftës nga nëntoka. Për shpimin e puseve përdoren sonda shpimi, e cila është një teknologji e veçante.

Në shqipëri kërkimet për zbulimin e naftës kanë filluar që në fillimet e shekullit 20, ku Italianët shpuan pusin e parë në Drashovicë në vitin 1918, në thellësinë 101.6 metra dhe nxorën naftë. Në vitin 1927 u zbulua nga Italianët Vendburimi i Kuçovës. Pas çlirimit u zbuluan disa vendburime të tjera naftëmbajtëse si Ai i Patos-Marinëz, Visokë, Sheqishte, Ballsh Hekal, Cakran-Mollaj, Visokë, Pekisht, Amonicë, Gorisht Kocul, Karbunarë, Pekisht-Murriz dhe ai i Gazkondesatit në Delvinë, vendburimet e gazit Divjakë, Kryevidh, Ballaj, Povelçë, Panaja e Frakull. Kompania Hollandeze Shell ka zbuluar naftë në pusin Shpiragu-2 i cili sipas të dhenave është një vendburim me rezerva të mëdha naftë.

Me naftën e prodhuar në vend plotësohen rreth 40% e nevojave për konsum të hidrikarbureve në Shqipëri.

Fjalët kyçe: *nafta, procesi i diagjenizimit, diferencim gravitativ, rilevim gjeologjik, gjeokimi, petrografi, gjeolog, sizmikë, rezervuar naftëmbajtës, vendburim naftë, vendburim gazi.*